



# Vlerësimi i Ndikimit Gjnor

## i Procesit të Zvogëlimit të Barrës Administrative

### 2022-2025



Ky dokument është hartuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian (BE) dhe Ministrisë Federale për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ), përmes veprimit të bashkëfinancuar për “Zvogëlimin e Barrës Administrative”, të zbatuar nga *Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH* si pjesë e Modulit të Bashkëpunimit Teknik të BMZ-së “Mbështetja për Proceset e Reformave të Integritimit në BE në Kosovë”. Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument janë të kontraktorit dhe nuk pasqyrojnë në asnjë mënyrë apo formë qëndrimin zyrtar të Bashkimit Evropian, Gjermanisë dhe GIZ-it.

DRAFT

## Përmbajtja

Shkurtesat.....	iv
Përmbledhje ekzekutive.....	1
Metodologjia.....	3
Gjetjet.....	5
1. Sa mirë përputhet RAP, në veçanti ligjet, politikat dhe programet që ndërlidhen me ZBA-në, me standardet e BE-së për barazi gjinore dhe rregullim më të mirë, LBGJ dhe Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative? Sa të përgjegjshme gjinore janë ato? .....	5
2. Cilat janë rolet e grave dhe burra të ndryshëm nga palët e interesit në administratën publike dhe në qasjen në shërbime?.....	15
3. Në çfarë mase kanë marrë pjesë gratë dhe burrat e ndryshëm në ZBA dhe në trajnimet që ndërlidhen me ZBA-në? .....	16
4. Cilat janë përvojat e grave dhe burrave të ndryshëm me barrën administrative dhe ZBA-në? .....	20
Konkluzioni.....	29
Rekomandimet.....	30
Për PPZBA-në e ardhshme dhe Planin e Veprimit.....	30
Për modelin dhe listat e kontrollit .....	32
Për materialet për ndërtimin e kapaciteteve .....	32
Për ZPS në kuadër të ZKM-së .....	33
Për Zyrën Kombëtare të Auditimit .....	33
Shtojcat.....	34
Shtojca 1. Metodologjia .....	34
Shtojca 2. Analiza gjinore e programeve të Kosovës për zvogëlimin e barrës administrative .....	34
Shtojca 3. Përmbledhja e kornizave ligjore dhe të politikave relevante për barazi gjinore dhe reformën e administratës publike në Kosovë .....	40
Shtojca 4. Përmbledhje e analizës së koncept dokumenteve dhe akteve ligjore.....	43
Shtojca 5. Treguesit e propozuar .....	72
Shtojca 6. Analizë e shpejtë e palëve të interesit.....	75
Shtojca 7. Plani i integritimit .....	76
Shtojca 8. Listat e kontrollit dhe kriteret e përgjegjshme gjinore për vlerësimin e iniciativave të ZBA-së .....	77
Shtojca 9. Lista e kontrollit: Trajtimi i çështjeve të barrës administrative gjatë hartimit të koncept dokumenteve dhe dokumenteve strategjike .....	78
Shtojca 10. Lista e kontrollit të legjislacionit për dizajnim dhe digjitalizim të shërbimeve ..	78
Shtojca 11. Procedurat Standarde të Veprimit për integrim në platformën eKosova .....	78
Shtojca 12. Rasti studimor: Sfidat e mbetura për mjedisin mundësues .....	79
Shtojca 13. Përdorimi i shërbimeve të eKosova sipas gjinisë .....	80
Bibliografia .....	94

## SHKURTESAT

PPZBA	Programi për Parandalimin dhe Zvogëlimin e Barrës Administrative
ZBA	Zvogëlimi i Barrës Administrative
ABGJ	Agjencia për Barazi Gjinore
UA	Udhëzimi Administrativ
BMZ	Ministria Federale për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
OSHC	Organizata e Shoqërisë Civile
IEBGJE	Instituti Evropian për Barazi Gjinore
BE	Bashkimi Evropian
PVBGJ	Plani i Veprimit për Barazi Gjinore
VNBGJ	Vlerësimi i Ndikimit të Barazisë Gjinore (i ABGJ)
ZBGJ	Zyrtari për Barazi Gjinore
VNGJ	Vlerësimi i Ndikimit Gjinor
GIZ	<i>Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit</i>
BPGJ	Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
IJK	Intervistat me informatorët kryesor
IKAP	Instituti i Kosovës për Administratë Publike
RrGK	Rrjeti i Grave të Kosovës
LBGJ	Ligji për Barazi Gjinore
OBZHE	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
ZKM	Zyra e Kryeministrit
RAP	Reforma në Administratën Publik
SRAP	Strategjia e Reformës së Administratës Publike
PFM	Menaxhimi i financave publike
SOP	Procedurat Standarde të Veprimit
ZPS	Zyra për Planifikim Strategjik
TeR	Termet e Referencës

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në kuadër të projektit të GIZ-it “Mbështetja për Proceset e Reformave të Integritimit në BE në Kosovë”, i zbatuar me Zyrën e Kryeministrit (ZKM), përkatësisht Zyrën për Planifikim Strategjik (ZPS), RrGK u ngarkua me kryerjen e një Vlerësimi të Ndikimit Gjinator (VNGJ) lidhur me Zvogëlimin e Barrës Administrative (ZBA). Ai synonte të ndërtohej mbi mësimet e nxjerra nga programet e mëparshme të ZBA-së për të siguruar që barazia gjinore të integrohet në mënyrë sistematike në planet e ardhshme të veprimit, programet dhe aktivitetet në kuadër të Programit për Parandalimin dhe Zvogëlimin e Barrës Administrative (PPZBA) 2025-2028, duke i bërë ato më gjithëpërfshirëse dhe më të përgjegjshme ndaj nevojave të të gjithë qytetarëve. Ai gjithashtu synon të vendosë një shembull të praktikës më të mirë për institucionet mbi mënyrën se si të kryhet një analizë gjinore ex-post e programeve qeveritare që nuk e kanë barazinë gjinore si objektivi kryesor të përgjithshëm, drejt shfrytëzimit të analizës së ndikimit gjinor për të informuar programim më të mirë nëpër sektorë. VNGJ përdori metoda të përziera, duke përfshirë analizën e përmbajtjes, një anketë online me 247 qytetarë, një anketë me 203 zyrtarë dhe 33 Intervista me informatorët kryesorë (IIK). VNGJ përfshiu një qasje holistike për identifikimin e barrierave që ndikojnë tek grat dhe burrat e ndryshëm. Adresimi i barrierave të mbetura të identifikuar përmes VNGJ-së kërkon veprim të koordinuar ndërmjet institucioneve, duke përfshirë rishikimin dhe ndryshimin e ligjeve, politikave dhe praktikave përkatëse të ofrimit të shërbimeve. Megjithatë procesi i ZBA-së koordinohet nga ZPS në kuadër të ZKM-së, zbatimi i tij efektiv varet nga angazhimi i të gjitha institucioneve përgjegjëse për rregullimin dhe menaxhimin e shërbimeve publike. Prandaj, gjetjet dhe rekomandimet nuk i adresohen vetëm ZPS-së në kuadër të ZKM-së, por të gjitha institucioneve përkatëse përgjegjëse për rregullimin dhe ofrimin e shërbimeve publike në fushat përkatëse.

ZPS ka nxitur progres drejt avancimit të barazisë gjinore lidhur me ZBA-në. Kur filluan reformat e ZBA-së në vitin 2022, PPZBA 2022-2027 ishte kryesisht neutral ndaj gjinisë, duke iu referuar vetëm caktimit të prioritetëve të shërbimeve që përdoren më shumë nga gratë; ai nuk ofronte objektiva, veprime apo tregues të ndarë sipas gjinisë për të ndjekur nëse reformat përfitojnë gratë dhe burrat. PPZBA i përmirësuar 2025-2028 njeh boshllëqet (p.sh., pjesëmarrjen e ulët të grave në trajnime), angazhohet për analizimin e demografisë së përdoruesve dhe prezanton tregues të ndarë sipas gjinisë për shërbimet e thjeshtuara/digjitalizuara. Ndërkohë, disa nga objektivat e tij mund të kishin integruar më mirë vëmendjen për avancimin e barazisë gjinore në ZBA dhe treguesit mund të kishin pasqyruar më mirë zvogëlimin e barrës për grat dhe burrat e ndryshëm.

Një rishikim i koncept dokumenteve dhe akteve ligjore të ndërlidhura me ZBA-në, duke përdorur qasjen e Vlerësimit të Ndikimit të Barazisë Gjinore (VNBGJ) të ABGJ-së, gjeti se ndërsa disa prej tyre e njohin përfshirjen ose diversitetin e përdoruesve në terma të përgjithshëm, pak prej tyre analizojnë në mënyrë sistematike ndikimet e diferencuara tek gratë dhe burrat, përfshijnë të dhëna të ndara sipas gjinisë, përcaktojnë rezultate të matshme të barazisë gjinore apo përdorin gjuhë të ndjeshme gjinore. Institucionet përgjegjëse për zhvillimin e këtyre dokumenteve kanë nevojë për udhëzime më të qarta, mbështetje dhe sigurim të cilësisë për të përmbushur obligimet e tyre sipas Ligjit për Barazi Gjinore (LBGJ).

Masat e thjeshtimit dhe digjitalizimit kanë reduktuar qartë barrën për gratë dhe burrat dhe kanë pasur ndikime pozitive. Disa barrierat paraprake vazhdojnë të mbeten për përdoruesit që ende duhet të dorëzojnë dokumente fizike, të përsërisin hapa ose të shfletojnë procese hibride online–fizike. Këto sfida të mbetura kontribuojnë në kohë, udhëtim, kosto dhe diskriminim, veçanërisht për përdoruesit me më pak burime, më pak kohë, role kujdesi, aftësi të kufizuara digjitale dhe/ose kufizime në lëvizshmëri, veçanërisht gratë, personat me aftësi të kufizuara, pakicat etnike dhe të moshuarit.

Qasjet e konceptimit të përqendruar te përdoruesi janë zbatuar gjithnjë e më shumë në zhvillimin dhe reformimin e shërbimeve publike, duke përfshirë edhe përmes angazhimit të drejtpërdrejtë me përdoruesit përfundimtarë gjatë fazës së konceptimit. Disa shërbime janë zhvilluar bazuar në konsultimet me grupet përkatëse të përdoruesve dhe palët e interesit, siç

janë studentët e juridikut dhe kandidatët për provimin e jurisprudencës, auto-shkollat dhe instruktorët, gjeodetët e licencuar dhe kompanitë gjeodezike, si dhe përmes vlerësimeve më të gjera të nevojave të përdoruesve të realizuara nëpër shërbime. Përveç kësaj, shërbimet e ngjarjeve jetësore, siç janë shërbimet e lindjes, janë zhvilluar përmes hulumtimeve të synuara, konsultimeve, dizajnit dhe testimit që përfshijnë gratë si përdoruese kryesore, për të kuptuar më mirë nevojat e tyre dhe barrierat e mundshme në qasjen në shërbime. Këto qasje përfaqësojnë një ndryshim të rëndësishëm drejt dizajnit më të orientuar nga përdoruesi dhe kanë kontribuar në bërjen e shërbimeve më të qasshme dhe më të përgjegjshme ndaj nevojave të përdoruesve. Megjithatë, analiza gjinore ndërsektoriale nuk zbatohet gjithmonë në mënyrë sistematike në të gjitha shërbimet gjatë dizajnit, rishikimit dhe monitorimit të reformave. Kjo paraqet rrezik që disa reforma mund të mos identifikojnë dhe adresojnë në mënyrë të mjaftueshme barrierat që ndikojnë tek gra dhe burra të ndryshëm. Angazhimi i Agjencisë për Barazi Gjinore (ABGJ), Zyrtarëve për Barazi Gjinore (ZBGJ) dhe ekspertëve gjinorë nuk është institucionalizuar në mënyrë të qëndrueshme në dizajnimin, rishikimin dhe monitorimin e reformave.

Ekzistojnë mundësi për përmirësimin e mbledhjes, shpërndarjes, publikimit dhe monitorimit sistematik të të dhënave të ndara sipas gjinisë me qasje ndërsektoriale përmes sistemeve ndërvepruese, në mënyrë që të maten më mirë ndikimet e ZBA-së tek gra dhe burra të ndryshëm.

Ndërtimi i kapaciteteve lidhur me ZBA-në dhe Reformën në Administratën Publike (RAP) ka integruar në mënyrë jokonsistente analizën e përgjegjshme gjinore. Jo të gjitha trajnimet kanë integruar në mënyrë sistematike konsideratat gjinore apo kanë ofruar mjete praktike për zyrtarët për të vlerësuar dhe adresuar barrierat e diferencuara në qasje. Ndërkohë, falë përpjekjeve të përbashkëta, pjesëmarrja e barabartë e grave dhe burrave në trajnime është përmirësuar. Disa sfida vazhdojnë të mbeten lidhur me udhëtimin, orarin dhe kujdesin për fëmijët. Ndërsa si gratë ashtu edhe burrat kanë tendencë t'i konsiderojnë trajnimet të dobishme, burrat kanë raportuar përdorim më të madh të njohurive, ndoshta për shkak të prirjes së tyre për të qenë në pozita vendimmarrëse. Forcimi i përmbajtjes së trajnimeve të përgjegjshme gjinore mund të mbështesë zbatimin më të qëndrueshëm të reformave gjithëpërfshirëse.

## METODOLOGJIA

Ky seksion përmbledh metodologjinë e përdorur.<sup>1</sup> Ai është hartuar në përputhje me [udhëzimet](#) e Institutit Evropian për Barazi Gjinore (IEBGJE), [Politikën Feministe të Zhvillimit për Zhvillim të Qëndrueshëm të BMZ-së](#), Planin e Tretë të Veprimit të Politikave për Barazi Gjinore 2023-2027, Ligjin për Barazi Gjinore (LBGJ), [Manualin e Vlerësimit të Ndikimit Gjinor të ABGJ-së](#), si dhe Termat e Referencës (TeR). Ai ka përdorur kriteret e Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OBZHE) për vlerësimet e ndikimit, duke përfshirë relevancën, koherencën, efektivitetin, efikasitetin, ndikimin dhe qëndrueshmërinë. Metodologjia gjithashtu është informuar nga ["Korniza e Analizës Gjinore"](#) e Universitetit Johns Hopkins dhe Modeli i Transformimit Digjital Gjithëpërfshirës dhe të Përgjegjshëm Gjinor i RrGK-së.<sup>2</sup> Duke përdorur këto korniza, ajo ka përfshirë shqyrtimin e dallimeve në të drejta, përfaqësim, qasje, burime, praktika, norma dhe fuqi ndërmjet grave dhe burrave të ndryshëm në lidhje me ZBA-në. VNGJ ka përfshirë analizë ndërsektoriale, e cila nënkupton shqyrtimin e mënyrës se si gjinia mund të ndërveprojë me rrethana të tjera socio-demografike për të mundësuar ose penguar qasjen dhe përdorimin nga gra dhe burra të ndryshëm. Duke reflektuar këtë, në këtë raport përdoret termi **"të ndryshëm"**, i cili duhet të kuptohet si referencë për gratë dhe burrat e moshave, përkatësive etnike, vendndodhjeve gjeografike (rurale/urbane), statuseve ekonomike dhe aftësive të ndryshme (me ose pa aftësi të kufizuara).<sup>3</sup> Analizimi i qartë i këtyre nevojave të ndryshme të përdoruesve mund të ndihmojë në sigurimin që masat e thjeshtimit dhe digjitalizimit të dizajnohen për t'i përmbushur nevojat e tyre. Pyetjet kryesore kërkimore përfshinin:

1. **Koherenca:** Sa mirë përputhet RAP, në veçanti ligjet, politikat dhe programet që lidhen me ZBA-në, me standardet e BE-së për barazi gjinore dhe rregullim më të mirë, LBGJ dhe Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative?<sup>4</sup> Sa të përgjegjshme gjinore janë ato? Nën-pyetjet lidhur me **relevancën, efektivitetin dhe ndikimin:** Si mund të jetë PPZBA 2025-2028 më i përgjegjshëm gjinor, duke dhënë informacion për planin e veprimit për ZBA për vitin 2026?
2. **Relevanca:** Cilat janë rolet e grave dhe burrave të ndryshëm nga palët e interesit në administratën publike dhe në qasjen në shërbime?
3. **Efektiviteti:** Në çfarë mase kanë marrë pjesë gratë dhe burrat e ndryshëm në ZBA dhe në trajnimet që ndërlidhën me ZBA-në? Cili ka qenë ndikimi i trajnimeve nga perspektiva gjinore?
4. **Efektiviteti:** Cilat janë përvojat e grave dhe burrave të ndryshëm me barrën administrative dhe ZBA-në në lidhje me pjesëmarrjen, qasjen, përdorimin, burimet, normat dhe vlerat, të drejtat dhe kompetencat? Kjo u përqendrua në ndryshimet në përvoja pas prezantimit të reformave të ZBA-së, kryesisht nga viti 2022 deri më sot.
5. **Ndikimi:** Cili ka qenë ndikimi i reformave të ZBA-së për gratë dhe burrat e ndryshëm?

Pyetjet kanë udhëhequr mbledhjen dhe analizën e të dhënave. Metodologjia përfshiu metoda të përziera, duke përfshirë: rishikimin dokumentar; analizën gjinore të përmbajtjes së PPZBA 2022-2027 dhe 2025-2028, metodologjive të ZBA-së (Modeli Standard i Kostos, AS-IS/TO-BE, Lista e Kontrollit për Gatishmëri Digjitale), pesë dokumenteve konceptuale dhe 15 akteve ligjore,<sup>5</sup> një anketë online me 203 zyrtarë (48% gra) nga 1,004 zyrtarë të trajnuar në mjetet e

Shih Shtojcën 1 për metodologjinë e plotë.

<sup>2</sup> Ky model gjithëpërfshirës shpjegohet në RrGK, [Barazia Gjinore: Në qendër të TI-së...dhe më përtej: Analiza gjinore e digjitalizimit në Kosovë](#) (Prishtinë: RrGK, 2024, fq. 23-33).

<sup>3</sup> Kjo terminologji është në përputhje me [Manualin e Vlerësimit të Ndikimit Gjinor](#) të ABGJ-së.

<sup>4</sup> Pyetja origjinale kërkimore përfshinte PVBGJ-në III të BE-së. Megjithatë, ajo është hequr pasi është një dokument pune i stafit të Komisionit Evropian (KE), të cilin Qeveria e Kosovës nuk është e obliguar ta zbatojë. Megjithatë, ai ndikon në financimin e reformave nga BE-ja, të cilat inkurajojnë RAP të përgjegjshme gjinore dhe BPGJ.

<sup>5</sup> Këto janë propozuar nga ZPS në kuadër të ZKM-së si më të dobishmet për qëllimet e tyre, të përzgjedhura nga një popullatë (listë) prej 85 aktesh ligjore dhe 218 politikash që ZPS i ka rishikuar nga viti 2023 deri në vitin 2025.


ZBA-së; një anketë online me 247 qytetarë (75% gra); dhe IIK me 34 zyrtarë, ekspertë, partnerë zhvillimorë dhe përfaqësues të OSHC-ve (65% gra), të përzgjedhur duke përdorur mostrimin me variacion (p.sh., OSHC që u shërbejnë grave rurale, personave me aftësi të kufizuara dhe pakicave etnike).<sup>6</sup> Janë zbatuar standardet etike për hulumtime me subjekte njerëzore.

Analiza gjinore (e përmbajtjes) e dokumenteve ligjore dhe të politikave, si dhe e listave të kontrollit, është kryer duke përdorur Shkallën “Semafori” të Transformimit Gjinor (Figura 1). IIK-të janë analizuar në mënyrë cilësore, duke përdorur kodimin në referencë me pyetjet kërkimore. Anketat janë analizuar në mënyrë kuantitative dhe kualitative.

Një kufizim kyç ishte përdorimi i mostrimit të përshtatshëm për anketat online për shkak të kufizimeve financiare. Si rezultat, gjetjet e anketave nuk janë statistikisht përfaqësuese. Prandaj, të gjitha gjetjet e anketave në këtë dokument duhet të trajtohen si indikative dhe jo përfaqësuese për popullatën. Vlen të theksohet se burrat janë të nën-përfaqësuar, pavarësisht përpjekjeve të shumta për të promovuar anketën tek burrat. Nënmostrat sipas përkatësisë etnike, moshës, vendndodhjes rurale/urbane, komunës dhe aftësisë së kufizuar janë shumë të vogla për analiza kuptimplota. Për të adresuar këtë kufizim, VNGJ synoi të përfshijë sa më shumë variacion të mundshëm në lidhje me pyetjet kërkimore përmes mostrimit me variacion të IIK-ve dhe duke u bazuar në hulumtime të tjera. Vlen të theksohet se ky VNGJ është përqendruar tek përdoruesit individualë. ZBA zbatohet si për qytetarët ashtu edhe për bizneset dhe efektet e saj mund të përjetohen ndryshe ndërmjet këtyre grupeve; megjithatë, ky dallim nuk është trajtuar në këtë VNGJ.

Për të siguruar vlefshmërinë, është aplikuar triangulimi i metodave, burimeve dhe studiuesve me ekspertizë të ndryshme. Rishikimi nga kolegët i draftit të VNGJ-së dhe një punëtori validuese me 41 palë të interesit (36 gra, 5 burra) kanë synuar më tej të rrisin vlefshmërinë.

Figura 1. Shkalla “Semafori” e transformimit gjinor



<sup>6</sup> Studimet e mëparshme të ndërlidhura me ZBA-në të rishikuara nga RrGK-së janë mbështetur kryesisht në burime dytësore dhe IIK. Pak prej tyre kanë përfshirë të dhëna kuantitative apo të dhëna administrative të ndara sipas gjinisë. Metoda të tilla mund të anojnë të dhënat drejt pjesëmarrësve të hulumtimit më të lidhur digjitalisht, urbanë dhe me arsim të lartë; gratë rurale, përdoruesit më të moshuar, personat me aftësi të kufizuara dhe pakicat mund të jenë të nën-përfaqësuar. Provat mund të evidentojnë probleme, por të jenë të pamjaftueshme për të matur barrën, ndikimet e diferencuara dhe progresin. Ky VNGJ përdori metoda të përziera dhe analizë ndërsektoriale për të adresuar këto çështje.

# GJETJET

Gjetjet paraqiten sipas renditjes së secilës pyetje kërkimore dhe nënpyetjeje.

## 1. Sa mirë përputhet RAP, në veçanti ligjet, politikat dhe programet që ndërlidhen me ZBA-në, me standardet e BE-së për barazi gjinore dhe rregullim më të mirë, LBGJ dhe Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative? Sa të përgjegjshme gjinore janë ato?

Korniza e BE-së për Rregullim më të Mirë synon të sigurojë që ligjet dhe politikat të bazohen në dëshmi, të jenë transparente, proporcionale dhe efektive, duke minimizuar njëkohësisht barrën e panevojshme administrative për qytetarët dhe bizneset. Ajo zbatohet gjatë gjithë ciklit të politikëbërjes, duke filluar nga proceset e vendosjes së agjendës deri te vlerësimi.<sup>7</sup> Më tej, konsolidimi ligjor dhe institucional i këtyre parimeve pasqyrohet në Marrëveshjen Ndërinstitucionale për Hartim më të Mirë të Legjislacionit, e cila angazhon institucionet e BE-së për legjislacion me cilësi të lartë të bazuar në vlerësimin e ndikimit, proporcionalitetin, transparencën dhe mekanizmat e vlerësimit.<sup>8</sup>

Zbatimi i këtyre kërkesave në [Strategjinë e Reformës së Administratës Publike 2022-2027 \(SRAP\)](#) të Kosovës zbulon boshllëqe në përputhje me obligimet për integrimin gjinor. Megjithëse Strategjia përputhet formalisht me objektivat e integritit në BE dhe përfshin mjete për vlerësimin e ndikimit rregullator, trajtimi i barazisë mbetet kryesisht deklarativ dhe jo operacional. Ajo nuk vlerëson në mënyrë sistematike se si reformat mund të ndikojnë tek individët që nisen nga pozita të pabarabarta gjinore dhe/ose socio-ekonomike. Asnjë VNGJ i strukturuar nuk është i integruar brenda politikës dhe dokumenti është neutral ndaj gjinisë. Mungesa e të dhënave bazë të ndara sipas gjinisë dhe e treguesve të matshëm për barazi gjinore nuk është në përputhje me LBGJ. Megjithëse ekzistojnë mekanizma për monitorimin e performancës, ato nuk integrojnë Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjinor (BPGJ) apo vlerësimin e ndikimit rishpërndarës në përputhje me kornizën e barazisë të Mjeteve të BE-së për Rregullim më të Mirë. Forcimi i përputhshmërisë do të kërkonte institucionalizimin e VNBGGJ-së, përfshirjen e rezultateve të matshme të barazisë, integrimin e treguesve të ndarë sipas gjinisë dhe sigurimin që konsideratat e barazisë të adresohen gjatë zbatimit të SRAP-it. Aktet ligjore dhe dokumentet konceptuale të analizuar në shtojcat 2-4 tregojnë sfida të ngjashme.

### 1.1. Si mund të jenë PPZBA-të më të përgjegjshme gjinore?

Një rishikim i [PPZBA 2022-2027](#) dhe Planit të tij të Veprimit për periudhën 2022-2024 sugjeron një qasje kryesisht **neutrale ndaj gjinisë**.<sup>9</sup> Seksioni "Prioritetet" përmban një deklaratë të përgjithshme se "prioritet do t'u jepet atyre shërbimeve që, bazuar në analizë, rezultojnë se përdoren më shumë nga gratë dhe grupet e cënueshme". Megjithatë, ai nuk përfshin objektiva, veprime apo tregues për të matur progresin drejt arritjes së qëllimeve të barazisë gjinore apo për të ndjekur të dhënat e ndara sipas gjinisë. Programi nuk i përmend në mënyrë eksplicite gratë dhe burrat e ndryshëm, megjithëse ky VNGJ sugjeron se ata mund të përballen me pengesa shtesë në përdorimin e shërbimeve të digjitalizuara, të cilat kërkojnë adresim. BPGJ nuk zbatohet; rrjedhimisht, burimet nuk alokohen qartë për avancimin e barazisë gjinore në lidhje me ZBA-në, gjë që gjithashtu e vështirëson gjurmimin e shpenzimeve.

<sup>7</sup> Korniza e BE-së për Rregullim më të Mirë buron nga: parimet e Traktatit të BE-së (proporcionaliteti, subsidiariteti, barazia); Karta e të Drejtave Themelore të BE-së; Marrëveshja Ndërinstitucionale e vitit 2016 për Hartim më të Mirë të Legjislacionit; Udhëzimet e KE-së për Rregullim më të Mirë; dhe parimet më të gjera të qeverisjes së BE-së. Këto zotime elaborohen në [Udhëzimet dhe Mjetet e KE-së për Rregullim më të Mirë](#), veçanërisht në Seksionin 3.3 ("Barazia"), i cili identifikon barazinë dhe objektivat sociale si baza legjitime për ndërhyrje në politika (gjithashtu, Parlamenti Evropian, Këshilli i Bashkimit Evropian dhe KE, [Marrëveshja Ndërinstitucionale për Hartim më të Mirë të Legjislacionit](#), GZ L 123, 2016).

<sup>8</sup> Gazeta Zyrtare L 123, 12 maj 2016.

<sup>9</sup> Ju lutem shihni analizën e plotë të këtyre dokumenteve në Shtojcën 2, për shkak të kufizimeve të hapësirës.

[PPZBA 2025-2028](#) është më i ndjeshëm ndaj gjinisë, por jo mjaftueshëm i përgjegjshëm gjinor. Ai përfshin njëfarë analize gjinore lidhur me pabarazinë në pjesëmarrjen e grave në trajnimet që lidhen me ZBA-në. Ai nxjerr në pah rëndësinë e përgjithshme të një qasjeje të përqendruar te përdoruesi, e cila përfshin analizën e demografisë, përfshirë gjininë, gjatë zhvillimit të politikave. Megjithatë, objektivat dhe veprimet nuk synojnë qartë avancimin e barazisë gjinore. Mungesa e objektivave të qarta drejt barazisë gjinore mund të pengojë monitorimin e progresit. Dy tregues që përmendin gjininë janë: (1) “Numri i shërbimeve të thjeshtuara në nivel qendror, të ndara sipas gjinisë dhe grupeve të cënueshme”; dhe (2) “Numri i shërbimeve të digjitalizuara duke përdorur metodologjinë e ZBA-së, të ndara sipas gjinisë dhe grupeve të cënueshme”. Megjithatë, bazat fillestare dhe objektivat ndërmjetëse nuk kërkojnë të dhëna të ndara sipas gjinisë dhe nuk janë vendosur objektiva të qarta, gjë që mund të pengojë monitorimin. Po ashtu, dokumenti nuk përmban analizë gjinore ndërsektoriale në lidhje me gratë me aftësi të kufizuara, të moshuarat apo ato nga pakicat. Këto grupe trajtohen së bashku si “të cënueshme”. Ky formulim është problematik, pasi gratë si kategori e tërë nuk përbëjnë në vetvete një grup të cënueshëm (apo të margjinalizuar); ato përfaqësojnë gjysmën e popullsisë dhe ekzistojnë dallime ndërmjet grave, të cilat nuk merren parasysh apo nuk maten qartë.

Pjesëmarrësit në hulumtim në mënyrë të ngjashme kanë prirje t’i përshkruajnë reformat e RAP-it dhe ZBA-së si kryesisht neutrale ndaj gjinisë në dizajn dhe zbatim. Pjesëmarrësit kanë vërejtur se konsideratat gjinore rrallë integrohen në fazat e hartimit të ligjeve apo të dizajnit të programeve dhe se reformat zakonisht trajtohen si procese teknike të thjeshtimit që ndikojnë në mënyrë të barabartë tek të gjithë qytetarët. Disa kanë theksuar se analizat e mëparshme të ZBA-së dhe të dhënat administrative janë zhvilluar pa konsiderata gjinore dhe se treguesit e ndarë sipas gjinisë dhe mekanizmat e monitorimit mbeten të kufizuar në praktikë, pavarësisht kërkesave ligjore ekzistuese. Si rezultat, ndikimet potencialisht të ndryshme që lidhen me kufizimet kohore, përgjegjësitë e kujdesit, ekspozimin sektorial ndaj shërbimeve publike dhe qasjen digjitale janë marrë parasysh në mënyrë jokonsistente në dizajnimin e reformave. Të anketuarit kanë vërejtur se perspektiva gjinore ka marrë më shumë vëmendje në vitet e fundit, veçanërisht në iniciativat e digjitalizimit të mbështetura nga jashtë, qasjet e dizajnit të përqendruar te përdoruesi dhe ushtrimet kërkimore. Megjithatë, ekzistojnë mundësi për institucionalizimin më të mirë të integritit gjinor në ZBA, në përputhje me kërkesat e LBGJ-së. Palët e interesit gjithashtu kanë theksuar se ZBGJ-të nuk përfshihen në mënyrë sistematike në dizajnimin e politikave. Ndërsa ABGJ rregullisht paraqet kontribute lidhur me analizën gjinore dhe VNGJ-të, ato shpesh përfshihen minimalisht ose shpërfillen. Kjo mund të kufizojë integrimin e konsideratave gjinore në fazat e hershme të proceseve të reformës.

Prandaj, reformat e ZBA-së mund të jenë më të përgjegjshme gjinore duke siguruar që versionet e ardhshme të PPZBA-së të bazohen në analizë gjinore ndërsektoriale, që një analizë e tillë të kërkohet për çdo reformë, që të vendosen objektiva të qarta për barazi gjinore si pjesë e ZBA-së brenda PPZBA-së, që të përcaktohen tregues, baza fillestare dhe objektiva të ndara sipas gjinisë për monitorimin e progresit; si dhe që të zbatohet BPGJ. Përfshirja më e madhe e ABGJ-së, ZBGJ-ve dhe ekspertëve të gjinisë mund të mbështesë këto procese. Gjetjet sugjerojnë se përmirësimi i përgjegjshmërisë gjinore të programeve aktuale dhe të ardhshme të ZBA-së do të kërkonte vazhdimin e qasjeve të dizajnit të përqendruar te përdoruesi, të cilat përfshijnë në mënyrë më sistematike analizën gjinore ndërsektoriale. Ky raport përmban rekomandime shtesë dhe specifike për PPZBA-në e ardhshme në seksionet vijuese, përfshirë rekomandimet.

## 1.2. Ndikimi: Cilat reforma të ZBA-së kanë qenë më të suksesshmet në adresimin e pabarazive gjinore deri më sot?

Siç parashihet në PPZBA-të, Qeveria ka synuar të prioritetizojë digjitalizimin e procedurave administrative që përfitojnë gra dhe burra të ndryshëm dhe, në disa raste, në mënyrë specifike gratë.<sup>10</sup> Digjitalizimi i procedurave administrative ka pasur ndikime pozitive për gratë dhe burrat. Pjesëmarrësit në hulumtim kanë vërejtur se shërbimet online zvogëlojnë nevojën për vizita të përsëritura fizike në institucione, gjë që mund të jetë veçanërisht e dobishme për gratë që përballen me kufizime më të mëdha kohore për shkak të përgjegjësisë të kujdesit apo fleksibilitetit të kufizuar për udhëtim. Procedurat e thjeshtuara gjithashtu kanë reduktuar ekspozimin ndaj ndërveprimeve diskrecionale ballë për ballë, të cilat disa palë të interesit i kanë lidhur me paragjykitime sociale, trajtim të pabarabartë dhe/ose diskriminim.

Disa iniciativa të synuara kanë adresuar pabarazitë gjinore, duke kontribuar në ndikime pozitive. Shërbimet e ngjarjeve jetësore, veçanërisht ato që lidhen me regjistrimin e lindjes dhe përfitimet e ndërlidhura, kanë thjeshtuar hapat administrativë për prindërit e rinj dhe kanë reduktuar nevojën për dorëzime të shumfishta të të dhënave personale gjatë periudhave kur gratë ndërveprojnë shpesh me institucionet publike (shih kutinë). Gratë janë synuar në mënyrë specifike në dizajnimin e këtyre shërbimeve. Si pilot në dy spitale në Gjilan dhe Ferizaj, tani lindjet mund të regjistrohen drejtpërdrejt nga profesionistët shëndetësorë në dhomën e spitalit dhe aplikimet për shtesat për fëmijë dhe nëna përpunohen automatikisht, duke eliminuar nevojën që nënat të udhëtojnë ose të paraqesin vetë kërkesat.<sup>11</sup> Ekzistojnë plane për ta zgjeruar këtë praktikë të mirë. Faqja informuese në eKosova e dedikuar për ngjarjen jetësore të lindjes është dizajnuar për të synuar gratë, duke siguruar që ato të kenë qasje të hershme në informacione thelbësore mbi shtatzëninë, lindjen dhe kujdesin për fëmijët. Këto masa lehtësojnë në mënyrë aktive qasjen e grave në shërbime dhe mbështetje gjatë fazave kritike të jetës. Në të ardhmen, Qeveria planifikon të ndërlidhë shërbimet me përfitimet qeveritare për pushimin e lehonisë, ndër të tjera shërbimet që do të mbështesin nënat.

“ Gratë kanë më pak kohë, kështu që përmes digjitalizimit të proceseve, ne po kursejmë atë pak

“ Normat gjinore dhe marrëdhëniet e fuqisë në shërbimet ballë për ballë (përfshirë ngacmimin ose komentet e papërshtatshme nga zyrtarët meshkuj) i dekurajojnë gratë nga

<sup>10</sup> Diskutimet e RrGK-së me ZPS në kuadër të ZKM-së. Për një listë të disa, por jo të gjitha, shërbimeve të digjitalizuara dhe mënyrën se si ato janë përdorur nga gratë dhe burrat, shih Shtojcën 13.

<sup>11</sup> Koment i GIZ-it për projektraportin.

## **Praktika e mirë:** Shërbimet e ngjarjeve jetësore

Një qasje e bazuar në ngjarje jetësore për ofrimin e shërbimeve publike organizon shërbimet qeveritare rreth situatave reale që përjetojnë qytetarët, si lindja e një fëmije, zhvendosja në një adresë të re apo fillimi i një biznesi, në vend që të organizohen rreth strukturës së brendshme të institucioneve publike. Në vend që të orientohen veçmas nëpër agjenci të ndryshme, qytetarët kanë qasje në një pikë të vetme hyrëse ku procedurat e ndërlidhura grupohen në një rrjedhë të koordinuar për përdoruesin. Ky model promovohet gjerësisht në kornizat ndërkombëtare të qeverisjes digjitale si një mënyrë për të zvogëluar barrën administrative, për të thjeshtuar procedurat dhe për të përmirësuar përvojën e përdoruesit.

Në Kosovë, kjo qasje po prezantohet përmes platformës eKosova si pjesë e iniciativave më të gjera të RAP-it dhe qeverisjes digjitale. Strategjia e Qeverisjes Elektronike 2023–2027 dhe PPZBA 2022–2027 theksojnë një zhvendosje drejt shërbimeve të përqendruara te qytetari, ku administrata publike i përgjigjet “ngjarjeve jetësore” dhe jo mandateve institucionale. Në këtë kontekst, eKosova funksionon si portal me një “një dritare të vetme” përmes të cilit qytetarët mund të qasen në shërbime nga institucione të shumta në një vend. Një shembull praktik i zbatuar tashmë është ngjarja jetësore **“Lindja e fëmijës”**, e cila integron disa procedura administrative në një proces të vetëm. Përmes këtij shërbimi, prindërit mund të regjistrojnë një të porsalindur në regjistrin civil dhe të iniciojnë procedura të ndërlidhura, siç janë regjistrimi shëndetësor dhe aplikimet për përfitime të caktuara, përmes një rrjedhe të koordinuar, në vend që të dorëzojnë kërkesa të veçanta në institucione të ndryshme. Kjo iniciativë ka shërbyer si një pilot fillestar për testimin e mënyrës se si shërbimet ndërinstitucionale mund të thjeshtohen përmes integritimit digjital.

Duke u bazuar në këtë përvojë, Qeveria aktualisht është duke zgjeruar modelin e ngjarjeve jetësore. Ngjarje të reja të integruara jetësore në zhvillim përfshijnë **“Vdekja e një të afërmi”**, **“Zhvendosja / Ndryshimi i adresës”** dhe **“Fillimi i një biznesi”**. Këto ngjarje jetësore janë në thelb ndërinstitucionale dhe kërkojnë koordinim ndërmjet regjistrave dhe agjencive të shumta. Për shembull, një ngjarje jetësore si “ndryshimi i adresës” mund të përfshijë përditësime në regjistrat e gjendjes civile, administratën tatimore, regjistrat komunal dhe shërbimet tjera publike. Zhvillimi i shërbimeve të ngjarjeve jetësore kërkon gjithashtu **riinxhinierimin e proceseve administrative ndërmjet institucioneve**, përcaktimin e rrugëtimit të qytetarëve, analizimin e legjislativës përkatës dhe sigurimin e ndërveprueshmërisë ndërmjet bazave të të dhënave qeveritare. Në praktikë, kjo përfshin analizimin e procedurave ekzistuese administrative (“AS-IS”), dizajnimin e proceseve të thjeshtuara të ardhshme (“TO-BE”) dhe përcaktimin e arkitekturës teknike të nevojshme për shkëmbimin e të dhënave dhe ofrimin e automatizuar të shërbimeve. Nga perspektiva gjinore dhe e përfshirjes, shërbimet e ngjarjeve jetësore krijojnë gjithashtu mundësi për të dizajnuar shërbime publike që reflektojnë më mirë përvojat reale të qytetarëve. Për shembull, ngjarjet si lindja, përgjegjësitë e kujdesit apo qasja në përfitime sociale shpesh përfshijnë ndërveprime të shumta administrative që prekin në mënyrë disproporcionale gratë. Prandaj, dizajnimi i shërbimeve rreth këtyre ngjarjeve jetësore mund të kontribuojë në zvogëlimin e barrierave administrative dhe përmirësimin e qasjes në të drejta dhe shërbime, me kusht që gra dhe burra të ndryshëm të konsultohen gjatë dizajnit dhe zbatimit të shërbimeve.

Përveç kësaj, pjesëmarrësit në hulumtim kanë vërejtur se digjitalizimi i procedurave profesionale, si procesi i aplikimit për provimin e jurisprudencës, ka reduktuar hapat administrativë dhe kërkesat për dokumentacion, duke pasur efekte pozitive për aplikantët (një shpërndarje relativisht e balancuar prej 48% gra dhe 52% burra).<sup>12</sup> Komunitat janë duke

<sup>12</sup> Të dhëna të Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit të ofruara për RrGK-në, 2021-2026 (shkurt).

replikuar dhe zgjeruar praktikën e mirë të Suharekës për ofrimin e stimujve për gratë për regjistrimin e pronës, duke sjellë potencialisht ndikime më të gjera për qasjen më të barabartë të grave në pronë. Si rezultat i masave të planifikuara në kuadër të [PPZBA 2025-2028](#), pjesëmarrja e grave në trajnimet për ZBA është rritur (shih më [poshtë](#)). Digjitalizimi në vazhdim i sistemit të granteve dhe subvencioneve të ABGJ-së do të ketë ndikime pozitive në qasjen e grave në financimin qeveritar. Një praktikë tjetër e mirë në zhvillim është krijimi i një sistemi digjital për menaxhimin e granteve brenda Ministrisë së Kulturës, i dizajnuar për të përmirësuar transparencën dhe standardizimin në ndarjen e fondeve publike.<sup>13</sup> Ky sistem, aktualisht në zhvillim dhe që pritet të lansohet në vitin 2026, mundëson mbledhjen e të dhënave të ndara sipas gjinisë për aplikantët dhe përfituesit dhe lejon integrimin e kriterëve dhe treguesve specifikë për të mbështetur vendimmarrjen për financim të përgjegjshëm gjinor dhe potencialisht afirmativ.<sup>14</sup> Pasi të bëhet funksional dhe të lidhet me eKosova, ai mund të përmirësojë monitorimin se kush përfiton nga financimi publik dhe të ndihmojë në sigurimin që objektivat e barazisë gjinore të reflektohen në mënyrë aktive në ndarjen e fondeve.

### 1.3. Ndikimi: Ku nuk kanë arritur të adresojnë në mënyrë të mjaftueshme pabarazitë gjinore në barrën administrativë?

Pavarësisht progresit, gjetjet nga intervistat tregojnë për sfida të mbetura, veçanërisht në zbatimin e parimit “vetëm një herë” dhe ndërveprueshmërisë, të cilat mund të kufizojnë progresin në adresimin e pabarazive gjinore. Përdoruesit shpesh ende duhet të dorëzojnë dokumente në formë fizike ose të ofrojnë informacione që tashmë janë të disponueshme në sistemet administrative. Personat me aftësi të kufizuara kanë përkrahur se duhet të bëjnë vizita të shumta për të konfirmuar informacione që tashmë janë të regjistruara në formë elektronike, duke rritur barrën në kohë, udhëtim dhe qasje. Disa gra me aftësi të kufizuara kanë raportuar përjetim të trajtimit diskriminues gjatë këtyre ndërveprimeve për shkak të gjinisë së tyre, aftësisë së kufizuar dhe moshës së supozuar (shih [Shtojcën 12](#)). Palët e interesit kanë theksuar në mënyrë të përsëritur se shumë procedura janë vetëm pjesërisht të digjitalizuara, duke kërkuar si dorëzim online ashtu edhe verifikim fizik pasues, gjë që redukton përfitimet e synuara të efikasitetit. Vlen të theksohet se disa shërbime duhet të mbeten fizike për shkak të konsideratave të sigurisë dhe se digjitalizimi është një proces gradual dhe kërkon burime, i cili kërkon kohë për t’u zbatuar. Megjithatë, duke marrë parasysh këto kufizime, digjitalizimi i pjesshëm mund të kontribuojë në vazhdimin e barrierave dhe pabarazive në qasjen në shërbime. Ndërsa sfidat që lidhen me digjitalizimin e pjesshëm të shërbimeve prekin të gjithë përdoruesit, ky VNGJ sugjeron se barrierat përkatëse mund të ndërveprojnë me pabarazitë ekzistuese gjinore, duke përfshirë dallimet në disponueshmërinë e kohës, qasjen në transport, burimet financiare, përgjegjësitë e kujdesit dhe/ose normat gjinore që kufizojnë lëvizjen, duke krijuar barriera shtesë për gratë, veçanërisht për gratë me aftësi të kufizuara.

Reformat nuk kanë adresuar në mënyrë të qëndrueshme pabarazitë e identifikuar gjatë zbatimit ose analizës së përdoruesve.<sup>15</sup> Pjesëmarrësit në hulumtim kanë theksuar vazhdimisht se nevojat e grave me aftësi të kufizuara, në zonat rurale dhe nga komunitetet pakicë mbeten të adresuara në mënyrë të pamjaftueshme. Ata kanë theksuar nevojën për konsultime më të rregullta me organizatat e grave, përdoruesit e shërbimeve dhe ekspertët e barazisë gjinore, si dhe për monitorim sistematik të përdorimit të shërbimeve nga mekanizmat e barazisë gjinore për të identifikuar, raportuar dhe adresuar barrierat e qasjes që lidhen me gjininë. Përveç kësaj, ekspertët e intervistuar të përfshirë në dizajnimin e shërbimeve kanë vërejtur se sistemet administrative nuk ndjekin në mënyrë sistematike rrugëtimin e përdoruesve, kohën e përfundimit, kërkesat për asistencë apo pikat e dështimit në përdorimin

“ Edhe kur dokumente dhe të dhëna të caktuara ekzistojnë online, zyrtarët vazhdojnë t’i kërkojnë ato në formë fizike për shkak të mungesës së besimit në sistem.

<sup>15</sup> Intervistat e RrGK-së, janar dhe shkurt 2026.

e shërbimeve. Mekanizmat e ankesave, ndërveprimet me shërbimin ndihmës dhe kërkesat për mbështetje fizike shpesh nuk regjistrohen apo analizohen në mënyrë digjitale, gjë që kufizon kapacitetin institucional për të identifikuar barrierat e përsëritura të qasjes që prekin grupe të caktuara të përdoruesve. Pa monitorim të rregullt të funksionimit të procedurave në praktikë, përfshirë përvojat e diferencuara sipas gjinisë, problemet në zbatim mund të vazhdojnë edhe aty ku janë ndërmarrë masa për thjeshtim.

#### **1.4. Cilët tregues të ndarë sipas gjinisë mund të përfshihen në PPZBA-të e ardhshme për të ndjekur më mirë perceptimin e barrës dhe ndikimin me kalimin e kohës?**

PPZBA-të e ardhshme duhet të përfshijnë disa tregues të detyrueshëm të ndarë sipas gjinisë që kapin se kush i përdor shërbimet e digjitalizuara/të thjeshtuara ose jo (dhe pse jo), kush i përfundon ato ose i braktis proceset (dhe pse), sa kohë dhe udhëtim kërkohet, kënaqësinë e përdoruesve, nëse procedurat mbeten hibride, kostot (përfshirë transportin dhe asistencën me pagesë), varësinë nga mbështetja, ankesat dhe zbatimin e parimit “vetëm një herë”. Në përputhje me qasjen e BE-së për cilësinë e shërbimeve, mund të përfshihen treguesit vijues: rezultati i kënaqshmërisë së përdoruesve pas përfundimit, i ndarë sipas gjinisë; numri i ankesave për 1,000 aplikime, i ndarë sipas gjinisë; përqindja e ankesave të zgjidhura brenda afatit të synuar dhe kategoritë kryesore të ankesave, të ndara sipas gjinisë, përfshirë vonesat, udhëzimet e paqarta, gabimet e sistemit, trajtimin diskriminues dhe kërkesat e përsëritura për dokumente.<sup>16</sup> Të gjithë treguesit që përfshijnë përdoruesit duhet të ndahen së paku sipas gjinisë dhe moshës dhe, kur është e mundur, sipas komunës, vendbanimit rural/urban, statusit të aftësisë së kufizuar dhe përkatësisë etnike. Pa këta tregues, reformat rrezikojnë të raportojnë rezultate të përgjithshme, duke lënë të pamatura pabarazitë në barrën administrative. Treguesit specifikë të propozuar gjenden në [Shtojcën 5](#).

#### **1.5. Si mund ta përmirësojë ZKM përgjegjshmërinë gjinore të koncept dokumenteve dhe akteve ligjore që ndërlidhen me ZBA-në?**

Të gjitha koncept dokumentet duhet të zbatojnë ZBA-në në ndërlidhje me instrumente të ndryshme të vlerësimit të ndikimit rregullator, duke përfshirë vlerësimet sociale dhe gjinore, ndër të tjera. Rishikimi i këtij VNGJ mbi koncept dokumentet dhe projektaktet ligjore në sektorë të ndryshëm ka treguar se konsideratat për barazi gjinore mbeten të *institucionalizuara* në mënyrë të pamjaftueshme brenda politikëbërjes për ZBA dhe proceseve të reformës rregullatore.<sup>17</sup> LBGJ vendos obligime të qarta për të gjitha institucionet për të zbatuar integrimin gjinor (bazuar në analizë gjinore), për të siguruar gjuhë të ndjeshme gjinore, për të mbledhur dhe raportuar të dhëna të ndara sipas gjinisë në Agjencinë e Statistikave të Kosovës (ASK) dhe për të përdorur masa afirmative. Megjithatë, këto standarde nuk janë zbatuar në mënyrë të *qëndrueshme* në dokumentet e rishikuara. Pavarësisht kërkesave ligjore, grupet punuese përgjegjëse për hartimin e koncept dokumenteve kanë tendencë të mos përfshijnë konsultim të mjaftueshëm me ZBGJ-të, gjë që mund të ndikojë në përgjegjshmërinë gjinore të ligjeve dhe politikave, duke përfshirë aspektet që ndërlidhen me ZBA-në.

Vlerësimet e Ndikimit të Barazisë Gjinore (VNBGJ) nuk janë kryer në mënyrë sistematike për koncept dokumentet e rishikuara në këtë VNGJ, pavarësisht udhëzimeve në Manualin për Hartimin e Koncept Dokumenteve. Analizat ndërsektoriale që përfshijnë gjininë dhe moshën, përkatësinë etnike, vendbanimin rural/urban, aftësinë e kufizuar, përgjegjësitë e kujdesit dhe statusin socio-ekonomik janë kryer rrallë. Mosidentifikimi i dallimeve gjinore ndërsektoriale në fazat e hershme mund të dëmtojë dizajnimin e masave të përgjegjshme gjinore.

<sup>16</sup> Varësia nga mbështetja është në përputhje me qasjen e BE-së për cilësinë e shërbimeve. Shih, për shembull, Rregulloren Zbatuese të KE-së 2020/1121 të 29 korrikut 2020 për mbledhjen dhe ndarjen e statistikave dhe komenteve të përdoruesve mbi shërbimet e portës së vetme digjitale, në përputhje me Rregulloren e BE-së 2018/1724 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit.

<sup>17</sup> Për më shumë detaje, shih [Shtojcën 4](#).

Sigurimi i zbatimit të këtyre kërkesave për barazi gjinore në legjislacionin që lidhet me ZBA-në shkon përtej mandatit të ZPS-së në kuadër të ZKM-së. Megjithatë, ZKM mund të inkurajojë institucionet përgjegjëse që të përmbushin obligimet e tyre ligjore për VNBGJ dhe të sigurojnë që ABGJ t'i rishikojë ato për sigurim të cilësisë, për shembull përmes mbështetjes së ndryshimit të listave të kontrollit dhe SOP-ve (shtojcat 9-11) për të ofruar udhëzime më të qarta.

Kriteret e pranueshmërisë dhe licencimit në sektorë të ndryshëm përmbajnë kushte që, ndonëse formalisht neutrale ndaj gjinisë, mund të krijojnë barriera indirekte. Kërkesat për përvojë të pandërprerë profesionale, sistemet strikte vjetore për rinovimin e licencave dhe rregullat e pezullimit që nuk njohin në mënyrë eksplicite pushimin e lehonisë mund të ndikojnë në mënyrë disproporcionale tek gratë për shkak të pabarazive ekzistuese gjinore të lidhura me rolet e kujdesit, duke ndikuar në pjesëmarrjen e tyre të barabartë në tregun e punës. Po ashtu, njohja e kufizuar e angazhimit me honorar të grave në tregun e punës mund të dëmtojë profesionistët të cilat, për shkak të përgjegjësive të kujdesit, nuk mund të angazhohen plotësisht në karrierën e tyre. Ndalimet rigorozë për riaplikim në rast të dokumentacionit të paplotë ose gabimeve teknike mund t'i përkeqësojnë këto barriera. Këto karakteristika strukturore tregojnë një vlerësim të pamjaftueshëm të mënyrës se si kërkesat rregullatore ndërveprojnë me modelet gjinore të punësimit dhe përgjegjësive të kujdesit, duke krijuar potencialisht barriera shtesë për gratë.

Digjitalizimi, ndonëse është në qendër të përpjekjeve për thjeshtim, ngre gjithashtu shqetësime lidhur me përfshirjen. Kalimi drejt aplikimeve online dhe proceseve digjitale nuk shoqërohet në mënyrë të qëndrueshme me alternativa të mjaftueshme fizike të asistuar, që ofrojnë mbështetje të udhëzuar, orar të zgjatur të shërbimeve apo udhëzime të qarta për procedurat në rast të aplikimeve elektronike të paplota. Për shembull, noterizimi online dhe mekanizmat e ndërveprueshmërisë nuk parashihen në mënyrë të njëtrajtshme në legjislacion, ndonëse këto mund të lehtësojnë qasjen. Transformimi digjital pa masa mbrojtëse për përfshirje mund të thellojë përjashtimin në vend që të zvogëlojë barrën administrative, veçanërisht në situata të analfabetizimit digjital, mungesës së lëvizshmërisë, varfërisë kohore, përjashtimit etnik dhe distancës gjeografike, të cilat mund të prekin më shumë gratë sesa burrat. Ndryshimet ligjore për të mundësuar noterizimin online do të reduktonin ndjeshëm barrën

Pa kërkuar të dhëna të ndara sipas gjinisë, masa mbrojtëse për qasje digjitale (p.sh., alternativa fizike), si dhe pa integruar konsideratat gjinore në manualet kryesore (Manuali i Thjeshtimit, Manuali i Vlerësimit të Ndikimit Digjital, Manuali i Planifikimit Strategjik), barazia gjinore mund të mbetet e funksionalizuar në mënyrë të pamjaftueshme. Mbledhja dhe publikimi i të dhënave të ndara sipas gjinisë nuk kryhen në mënyrë sistematike përmes sistemeve ndërvepruese, si p.sh. mundësimi i raportimit automatik dhe në kohë reale në ASK. Pa të dhëna në kohë reale, institucionet nuk kanë dëshmi për të monitoruar ndikimet e diferencuara sipas gjinisë, gjë që dobëson vlerësimet e politikave dhe llogaridhënien. Paralelisht, gjuha e ndjeshme gjinore përdoret në mënyrë jokonsistente në hartimin e legjislacionit, duke përforcuar normat gjinore dhe duke mos u përputhur me standardet e përfshirjes të parashikuara në LBGJ.

Në përgjithësi, analiza sugjeron se konsideratat për barazi gjinore në politikëbërjen e ZBA-së janë të fragmentuara dhe aplikohen në mënyrë ad hoc, në vend që të jenë të integruara strukturalisht në dizajnin rregullator, kornizat e qeverisjes, proceset e transformimit digjital dhe sistemet e monitorimit. Duke integruar në mënyrë sistematike kriteret gjinore në udhëzime, lista të kontrollit dhe në të gjitha proceset, politikëbërja e ZBA-së dhe proceset e reformës rregullatore mund të harmonizohen me LBGJ dhe të bëhen më të përgjegjshme gjinore. Kjo përfshin vendosjen e udhëzimeve dhe listave të kontrollit që kërkojnë VNBGJ, sigurimin që ato të kryhen si duhet dhe të japin informacion për ligjet/politikat, detyrimin për mbledhjen e të dhënave ndërsektoriale të ndara sipas gjinisë dhe përdorimin e gjuhës së ndjeshme gjinore, inkurajimin e përfshirjes së ZBGJ-ve në proceset e hartimit dhe vlerësimin e mënyrës se si reformat mund të ndikojnë ndryshe tek gratë dhe burrat, si dhe parashikimin e opsioneve si fizike ashtu edhe online. Megjithëse këto nuk janë vetëm në kompetencën e

ZPS-së në kuadër të ZKM-së, ato janë obligative për të gjitha institucionet sipas LBGJ-së. Prandaj, ZPS në kuadër të ZKM-së mund të propozojë përfshirjen e këtyre konsideratave në lista e kontrollit, udhëzime dhe trajnime për institucionet e tjera, si dhe të rishikojë projektligjet dhe politikat për të siguruar që këto çështje janë marrë parasysh, në konsultim me ABGJ-në.

#### 1.6. Sa të përgjegjshme gjinore janë metodologjitë e ZBA-së dhe si mund të bëhen më të përgjegjshme gjinore?

Ky seksion përmban një rishikim të shpejtë të metodologjive të ZBA-së për të vlerësuar përgjegjshmërinë e tyre gjinore, duke përfshirë Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) të përdorura për eKosova, Modelin e Kostos Standarde, AS-IS/TO-BE, Listën e Kontrollit për Gatishmëri Digjitale dhe lista të tjera të kontrollit.

#### *Procedurat Standarde të Veprimit për Integrim në platformën eKosova*

PSV që rregullon integrimin e shërbimeve në platformën eKosova fokusohet në hapat teknikë, proceduralë dhe institucionalë të nevojshëm për integrimin e shërbimeve digjitale. PSV përcakton rolet dhe përgjegjësitë për institucionet, përshkruan fazat e integritit të shërbimeve (kërkesa, analiza dhe vlerësimi, vendimmarrja, zhvillimi teknik, testimi dhe publikimi) dhe definon standardet për ndërveprueshmërinë, sigurinë dhe disponueshmërinë e shërbimeve. PSV përfshin referenca të përgjithshme për qasjen dhe përdorimin e shërbimeve për kategori të ndryshme të përdoruesve; ai parasheh mundësinë për analizimin e përdorimit të shërbimeve sipas gjinisë dhe karakteristikave të tjera. Megjithatë, konsideratat gjinore nuk operacionalizohen në mënyrë sistematike brenda kësaj procedure. PSV nuk kërkon analizë të strukturuar gjinore gjatë dizajnit të shërbimeve. Po ashtu, ai nuk ofron udhëzime të qarta për vlerësimin se si procedurat administrative apo shërbimet digjitale mund të ndikojnë ndryshe tek gratë dhe burrat e ndryshëm. Për të forcuar përgjegjshmërinë gjinore të SOP-së, propozohen disa përmirësime. Këto përfshijnë mbledhjen dhe analizimin sistematik të të dhënave të përdoruesve të ndara sipas gjinisë dhe karakteristikave të tjera relevante gjatë propozimit të shërbimeve për digjitalizim, përfshirjen e drejtpërdrejtë të ZBGJ-ve gjatë fazës së analizës së shërbimeve për të identifikuar barrierat e mundshme në qasje dhe sigurimin që dizajni dhe testimi i shërbimeve të marrin parasysh përvojat e grave dhe burrave të ndryshëm. Përveç kësaj, mekanizmat e monitorimit mund të përdoren më sistematikisht për të analizuar modelet e përdorimit të shërbimeve sipas gjinisë dhe për të identifikuar pabarazitë e mundshme në qasje apo përdorim. Këto përshtatje do të mbështesnin një konsiderim më të qëndrueshëm të barazisë gjinore në dizajnimin, integrimin dhe monitorimin e shërbimeve publike digjitale brenda platformës eKosova.

#### *Modeli Standard i Kostos*

Ky model synon të masë barrën administrative të krijuar nga ligjet dhe rregulloret, duke u fokusuar në kohën, kostot dhe burimet që bizneset shpenzojnë për të përmbushur kërkesat e detyrueshme për informacion. Ai është kryesisht një mjet diagnostikues dhe monitorues për të identifikuar se ku thjeshtimi ose digjitalizimi mund të zvogëlojë barrët.<sup>18</sup> Metodologjia është tërësisht **neutrale ndaj gjinisë** në dizajn. Ajo nuk përmend gratë, burrat apo grupe të ndryshme shoqërore. Po ashtu, ajo nuk njeh që barrët administrative mund të kenë efekte të pabarabarta, për shembull, tek bizneset e udhëhequra nga gratë, ndërmarrjet e vogla familjare apo personat me përgjegjësi kujdesi që kanë më pak kohë për përmbushjen e kërkesave. Nuk propozohet apo kërkohet mbledhja e të dhënave të ndara sipas gjinisë. Konsultimet (p.sh., grupet e fokusit, intervistat) nuk janë të dizajnuara për të siguruar pjesëmarrjen e grave dhe burrave të ndryshëm, gjë që mund të kontribuojë në identifikimin e dallimeve të mundshme gjinore.

Për të forcuar përgjegjshmërinë gjinore të Modelit të Kostos Standarde, zbatimet e ardhshme të metodologjisë mund të përfshijnë elemente të Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinor

<sup>18</sup> Republika e Kosovës, Qeveria, [Modeli Standard i Kostos: Doracak për Matjen e Barrës Administrative](#) [Modeli Standard i Kostos: Një Udhëzues për Matjen e Barrës Administrative], 2023.

(BPGJ). Kjo mund të përfshijë përshtatjen e llogaritjeve ekzistuese të kostos për të evidentuar më mirë kostot e diferencuara sipas gjinisë që përballen nga përdorues të ndryshëm, si ato që lidhen me përgjegjësitë e kujdesit, varësinë nga ndërmjetësit ose transportin.<sup>19</sup> Zbatimi i modelit i informuar nga BPGJ do të mbështeste gjithashtu mbledhjen dhe analizën e të dhënave të ndara sipas gjinisë, si dhe konsultime të synuara me bizneset e udhëhequra nga gratë dhe gra e burra të ndryshëm për të vlerësuar nëse masat e thjeshtimit reduktojnë barrën administrative për përdorues të ndryshëm.

## SIÇ ËSHTË / SI DUHET TË JETË

Metodologjia SIÇ ËSHTË / SI DUHET TË JETË është kryesisht një mjet për proceset dhe efikasitetin. Qëllimi i saj fillestar është të analizojë gjendjen aktuale të ofrimit të shërbimeve, të përcaktojë gjendjen e dëshiruar të ardhshme dhe të zbatojë ndryshime për të thjeshtuar, digjitalizuar dhe përputhur shërbimet me kërkesat ligjore.<sup>20</sup> Në këtë kuptim, metodologjia nuk është dizajnuar për të adresuar pabarazitë strukturore apo për të qenë në mënyrë të natyrshme e përgjegjshme gjinore; përkundrazi, fokusi i saj është në efikasitet, përmirësimin e proceseve dhe përputhshmërinë me standardet e ofrimit të shërbimeve. Megjithatë, duke qenë se barrët administrative nuk përjetojnë njësoj nga të gjithë, modeli SIÇ ËSHTË / SI DUHET TË JETË ofron mundësi të rëndësishme për integrimin e konsideratave gjinore. Metodologjia tashmë kërkon tregues të ndarë sipas gjinisë dhe grupeve të cënueshme, për shembull raportimin e numrit të shërbimeve të thjeshtuara dhe të digjitalizuara për gratë, burrat dhe kategoritë e pafavorizuara. Kjo mundëson monitorimin nëse reformat po arrijnë grupe të ndryshme të popullsisë. Megjithatë, analiza SIÇ ËSHTË nuk kërkon në mënyrë eksplicite analizë gjinore ndërsektoriale të ndikimit, ndonëse një analizë e tillë është e nevojshme për identifikimin e pabarazive dhe ndikimeve të mundshme në përputhje me kërkesat e LBGJ-së. Për shembull, një analizë e tillë mund të identifikojë dallime në mënyrën se si procedurat administrative përjetojnë nga gra dhe burra të ndryshëm, përfshirë kufizimet e lidhura me gjininë që burojnë nga normat gjinore dhe pabarazitë e fuqisë, disponueshmëria e kohës, lëvizshmëria, qasja në mjetet digjitale dhe/ose shkathtësitë digjitale. Megjithëse konsultimet me përdoruesit kanë synuar të përfshijnë kategori të ndryshme, ato nuk kanë siguruar gjithmonë në *mënyrë sistematike* pjesëmarrjen e grave dhe burrave të ndryshëm, kështu që problemet e përcaktuara në fillim mund të pasqyrojnë vetëm përvoja të pjeshme të përdoruesve. Kjo mund të pengojë identifikimin e hapave të nevojshëm për të përmirësuar qasjen për gra dhe burra të ndryshëm.

Faza SIÇ DUHET TË JETË vazhdon këtë model. Ndërsa vizioni për thjeshtim, përputhje me legjislacionin dhe digjitalizim është qendror, përfshirja e gjinisë kufizohet në monitorimin e rezultateve. Kjo siguron të dhëna mbi atë se kush përfiton, por nuk e formëson domosdoshmërisht dizajnin e shërbimeve të reja në mënyra që adresojnë pabarazitë ekzistuese. . Pa vendime të tilla të synuara, pabarazitë strukturore rrezikojnë të vazhdojnë nën sipërfaqen e përmirësimeve të efikasitetit.

Në praktikë, faza e zbatimit, përfshirë zhvillimin dhe testimin e shërbimeve, ka përfshirë konsultime me gra dhe burra të ndryshëm, të cilat kanë informuar dizajnimin e shërbimeve.<sup>21</sup> Megjithatë, metodologjia nuk kërkon në mënyrë eksplicite konsultime dhe teste me një listë të përcaktuar të përdoruesve të ndryshëm (p.sh., sipas moshës, përkatësisë etnike, aftësisë së kufizuar, vendndodhjes). Si rezultat, disa grupe mund të mbeten të papërfshira. Vendosja e një liste të kontrollit të standardizuar për konsultime dhe testim mund të ndihmojë në sigurimin që gra dhe burra të ndryshëm dhe relevantë të konsultohen gjithmonë si pjesë e një praktike të institucionalizuar. Stafi përgjegjës për zbatimin mund të mos ketë trajnim të mjaftueshëm për të identifikuar dhe zbutur paragjykimet gjinore në ofrimin e shërbimeve.<sup>22</sup> Si

<sup>19</sup> Këto janë menduar të shërbejnë si shembuj. Analiza të mëtejshme gjinore do të nevojiteshin në lidhje me shërbime specifike.

<sup>20</sup> [PPZBA 2025-2028](#), fq. 15.

<sup>21</sup> Intervistat e RrGK-së me ZPS në kuadër të ZKM-së.

<sup>22</sup> Intervistat e RrGK-së, 2026.

rezultat, reformat mund të përmbushin objektivat e efikasitetit duke lënë të paprekura pabarazitë themelore.

Në përgjithësi, metodologjia SIÇ ËSHTË / SI DUHET TË JETË mund të përshkruhet si e ndjeshme ndaj gjinisë, pasi mundëson njëfarë monitorimi të ndarë sipas gjinisë. Megjithatë, ajo nuk është plotësisht e përgjegjshme gjinore, sepse nuk integron qartë konsideratat gjinore në analizën e problemit, konsultimet me përdoruesit apo dizajnimin e shërbimeve. Megjithatë, logjika e saj e përqendruar te përdoruesi krijon potencial të madh për integrimin e qëllimshëm të gjinisë. Duke zgjeruar analizën SIÇ ËSHTË për të mbledhur të dhëna të ndara sipas gjinisë dhe për të përfshirë organizatat e grave, duke integruar objektiva të përgjegjshme gjinore në vizionin SIÇ DUHET TË JETË dhe duke siguruar pjesëmarrje gjithëpërfshirëse në testim dhe monitorim, metodologjia mund të evoluojë në një mjet që jo vetëm përmirëson efikasitetin, por gjithashtu redukton pabarazitë në mënyrën se si gratë dhe burrat përjetojnë procedurat administrative. Në këtë mënyrë, një model i dizajnuar për efikasitet e procesit mund të shërbejë njëkohësisht si një levë për barazi kur gjinia integrohet në mënyrë sistematike në zbatimin e tij.

### **Lista e Kontrollit për Gatishmëri Digjital**

Lista e Kontrollit për Gatishmëri Digjitale përshkruan konsideratat kryesore për hartimin dhe vlerësimin e legjislacionit që lidhet me dizajnimin dhe digjitalizimin e shërbimeve publike.<sup>23</sup> Ajo udhëzon zyrtarët të sigurojnë që ligjet mundësojnë komunikimin elektronik, automatizimin, ndërveprueshmërinë dhe inovacionin, duke shmangur njëkohësisht pengesat ligjore si dokumentet e detyrueshme fizike apo procedurat që kërkojnë praninë fizike. Lista e kontrollit promovon dizajnimin e shërbimeve të përqendruara te përdoruesi duke inkurajuar thjeshtimin, eliminimin e hapave të panevojshëm dhe përdorimin më të gjerë të zgjidhjeve digjitale. Nga **perspektiva gjinore**, ky mjet është plotësisht **neutral ndaj gjinisë**. Ai i referohet “përdoruesve” në terma të përgjithshëm, por nuk dallon se si digjitalizimi mund të ndikojë ndryshe tek gratë dhe burrat. Po ashtu, nuk kërkon vlerësimin e barrierave specifike që përballen nga gratë, popullatat rurale apo grupet e marginalizuara në qasjen në shërbime digjitale. Çështje kyçe si qasja e pabarabartë në teknologji, nivelet më të ulëta të shkathtësive digjitale tek gratë dhe barra gjinore e kërkesave administrative nuk merren në konsideratë.

### **Lista e kontrollit për adresimin e barrës administrative në koncept dokumentet dhe dokumentet strategjike dhe lista të kontrollit për legjislacionin mbi dizajnimin e shërbimeve dhe digjitalizimin**

Këto dy lista të kontrollit ekzistuese të përdorura në proceset e ZBA-së dhe digjitalizimit të shërbimeve në Kosovë janë rishikuar nga perspektiva gjinore.<sup>24</sup> Rishikimi synoi të inkurajojë institucionet të marrin parasysh se si barra administrative dhe shërbimet digjitale ndikojnë ndryshe tek gra dhe burra të ndryshëm, me qëllim që reformat e ZBA-së dhe digjitalizimit të adresojnë nevoja të ndryshme. Rishikimi gjeti se të dyja listat e kontrollit, të cilat shërbejnë si mjete udhëzuese, janë kryesisht neutrale ndaj gjinisë. Institucioneve nuk u kërkohet të shqyrtojnë se si procedurat administrative dhe shërbimet publike ndikojnë ndryshe tek gratë dhe burrat. Po ashtu, ato nuk kërkojnë analizë gjinore dhe të dhëna të ndara sipas gjinisë lidhur me përdoruesit e shërbimeve apo shqyrtimin e barrierave që përballen nga gratë, veçanërisht ato në zonat rurale, me aftësi të kufizuara apo nga grupet etnike minoritare. Futja e elementeve të tilla do t'i harmonizonte listat e kontrollit me obligimet për barazi gjinore sipas LBGJ-së dhe pritjet e BE-së që barazia gjinore të merret parasysh në të gjitha proceset e RAP-it dhe digjitalizimit.

RrGK ka propozuar rishikime me ndryshime të shënuara për integrimin e analizës gjinore dhe të dhënave të ndara sipas gjinisë në këto dy lista të kontrollit. Listat e kontrollit tani reflektojnë më mirë obligimet për barazi gjinore dhe ofrojnë udhëzime praktike për institucionet

<sup>23</sup> PPZBA 2025-2028, Shtojca 2.

<sup>24</sup> Vlen të theksohet se këto lista të kontrollit shërbejnë gjithashtu si “model” për të mbështetur ministritë dhe agjencitë në integrimin sistematik të gjinisë në ZBA (shih shtojcat 9 dhe 10).

që të marrin parasysh se si reformat e ZBA-së dhe digjitalizimit mund të ndikojnë tek gra dhe burra të ndryshëm.

Rishikimet e propozuara gjithashtu kërkojnë përmirësimin e mbledhjes së të dhënave në përputhje me kërkesat e LBGJ-së. LBGJ kërkon që të gjitha të dhënat të ndahen sipas gjinisë dhe të raportohen në Agjencinë e Statistikave të Kosovës (ASK). Megjithatë, në praktikë, të dhënat më shpesh mbledhen sipas seksit biologjik dhe terminologjia jokonsistente kontribuon në boshllëqe dhe mospërputhje. Për konsistencë me LBGJ-në, këtu përdoret termi “gjini”. Intervistat tregojnë se mbledhja dhe përdorimi sistematik i të dhënave të ndara sipas gjinisë në sistemet që lidhen me ZBA-në mbetet i kufizuar. Mbledhja e të dhënave të përdoruesve sipas seksit, moshës, vendbanimit apo karakteristikave të tjera nuk është praktikë standarde dhe sistemet administrative në përgjithësi nuk gjurmojnë se kush i përdor shërbimet, normat e përfundimit, pikat e dështimit apo rrugëtimin e përdoruesve. Kjo kufizon analizën gjinore dhe identifikimin e barrierave në qasje. Edhe kur platformat si eKosova përfshijnë fusha bazë për gjininë, të dhënat shpesh janë të pamjaftueshme për analiza kuptimplota, duke munguar informacione për përdorimin e kohës, nevojat për mbështetje, dallimet rajonale apo nëse përdoruesit i përfundojnë aplikimet në mënyrë të pavarur. Të dhënat institucionale gjithashtu nuk raportohen rregullisht në ASK, siç kërkohet, dhe të dhënat e hapura të disponueshme nuk janë në mënyrë të qëndrueshme të ndara sipas gjinisë. Mekanizmat e ankesave dhe kërkesat për asistencë rrallë digjitalizohen apo analizohen, duke kufizuar më tej njohuritë mbi barrierat që lidhen me gjininë. Ndërsa disa iniciativa të mbështetura nga donatorët dhe disa institucione prodhojnë të dhëna të ndara sipas gjinisë, këto mbeten praktika të izoluar dhe jo të integruara sistematikisht në të gjitha sistemet e ZBA-së.

Në përgjithësi, dëshmitë sugjerojnë se, ndonëse ekziston kapacitet teknik për të gjeneruar të dhëna të ndara sipas gjinisë në disa fusha, mbledhja rutinore, ndërveprueshmëria ndërmjet institucioneve dhe analiza e rregullt e këtyre të dhënave mbeten të pazhvilluara. Forcimi i evidentimit automatike të të dhënave në platformat digjitale, përmirësimi i ndërveprueshmërisë (si p.sh. shkëmbimi i të dhënave në kohë reale me ASK-në), sigurimi i variablave të njëtrajtshëm ndërmjet ministrive, digjitalizimi i regjistrave të ankesave dhe kërkesave për asistencë, si dhe analiza sistematike e modeleve të përdorimit të shërbimeve sipas gjinisë dhe karakteristikave të tjera do të ishin hapa të domosdoshëm për të harmonizuar më mirë sistemet e të dhënave të ZBA-së me kërkesat e LBGJ-së.

## **2. Cilat janë rolet e grave dhe burra të ndryshëm nga palët e interesit në administratën publike dhe në qasjen në shërbime?**

Ky seksion shqyrton rolet e grave dhe burrave të ndryshëm në administratën publike, përkatësisht të zyrtarëve të angazhuar në ZBA dhe të personave që qasen në shërbime. Shtojca 6 përmbledh këto role.

### **2.1. Rolet gjinore në administratën publike**

Të dhënat administrative në dispozicion tregojnë se gratë mbeten të nënpërfaqësuar në pozitat e larta vendimmarrëse në të gjithë qeverinë dhe administratën publike.<sup>25</sup> Si rrjedhojë, burrat kanë më shumë gjasa të jenë pjesë e grupeve punuese dhe komisioneve në ministri dhe institucione të ndryshme që merren me hartimin e legjislacionit, politikave dhe programeve, duke përfshirë ato që lidhen me RAP dhe ZBA. Ky çekuilibër mund të ndikojë në atë se përvojat dhe prioritetet e kujt pasqyrohen në dizajnimin e reformave. ZBGJ-të kanë mandat të mbështesin integrimin e barazisë gjinore në politikat institucionale dhe mund të kontribuojnë në VNBGJ gjatë proceseve të hartimit. Megjithatë, gjetjet nga intervistat sugjerojnë se ZBGJ-të nuk përfshihen në mënyrë sistematike në fazat e hershme të dizajnit të reformave që lidhen me ZBA-në dhe pjesëmarrja e tyre varet kryesisht nga praktikat institucionale dhe jo nga një kërkesë formale. Për më tepër, disa prej tyre nuk kanë kapacitete

<sup>25</sup> UN Women, [Kosovo Gender Country Profile](#), 2024

të mjaftueshme në kuptimin e digjitalizimit për të ofruar këshilla kuptimplota.<sup>26</sup> ABGJ ka rol këshillues dhe të sigurimit të cilësisë në rishikimin e legjislacionit dhe propozimeve të politikave. Në praktikë, palët e interesit kanë vërejtur se ABGJ shpesh konsultohet vonë në proces, gjë që kufizon ndikimin e saj në dizajnimin e programeve. Po ashtu, rekomandimet e saj jo gjithmonë zbatohen.

Në tërësi, gjetjet sugjerojnë se pa përfshirje sistematike të analizës gjinore, mekanizmave të barazisë gjinore dhe praktikave të qëndrueshme të zbatimit, reformat administrative rrezikojnë të riprodhojnë pabarazitë ekzistuese në vend që t'i reduktojnë ato.

## Rolet gjinore në qasjen në shërbime

Rolet gjinore ndikojnë në mënyrën se si gratë dhe burrat ndërveprojnë me institucionet publike, duke ndikuar në atë se kush menaxhon detyrat administrative, kush ka kohë për t'u angazhuar me procedurat dhe kush ka qasje në shërbimet publike. Meqenëse këto dinamika trajtohen më gjerësisht në seksionet vijuese, ato përmbledhen këtu. Intervistat tregojnë se gratë dhe burrat ndërveprojnë ndryshe me shërbimet publike për shkak të pabarazive në përgjegjësitë e kujdesit, kufizimeve kohore, qasjes digjitale dhe modeleve të ndërveprimit administrativ. Gratë janë përshkruar si më shpesh të angazhuara me shërbime që lidhen me administrimin familjar, shëndetësinë, arsimin dhe mbrojtjen sociale, duke rritur ekspozimin e tyre ndaj procedurave administrative. Procedurat që kërkojnë udhëtim, kohë pritjeje apo vizita të përsëritura mund të paraqesin barriera më të mëdha për gratë, veçanërisht për ato në zonat rurale, me aftësi të kufizuara, nga komunitetet minoritare apo me përgjegjësi kujdesi. Qasja dhe besimi digjital ndikojnë gjithashtu në përdorimin e shërbimit. Disa pjesëmarrës në hulumtim kanë vërejtur se gratë mund të mbështeten më shumë tek anëtarët e familjes apo ndërmjetësit për të përfunduar procedurat online; në disa familje, burrat kanë më shumë gjasa të merren me dokumentacionin zyrtar. Këto dallime sugjerojnë se barra administrative përjetohet në mënyrë të pabarabartë në praktikë dhe duhet të merret parasysh në dizajnimin e shërbimeve dhe masat e thjeshtimit.



**Rolet gjinore dhe përgjegjësitë e kujdesit kufizojnë kohën dhe mundësinë e grave për të pasur qasje në shërbime,**

### 3. Në çfarë mase kanë marrë pjesë gratë dhe burrat e ndryshëm në ZBA dhe në trajnimet që ndërlidhën me ZBA-në?

Përfshirja në trajnimet për ZBA zakonisht bazohet në rolin dhe funksionin institucional të individëve. Njësitë më të përfshira në RAP, ZBA apo digjitalizim kanë pasur tendencë të kenë më shumë punonjës burra, gjë që mund të ndikojë në balancën gjinore të pjesëmarrësve në trajnime. Disa pjesëmarrës në anketë sugjeruan që duhet të përfshihen pjesëmarrës shtesë dhe/ose të ndryshëm, duke përfshirë vendimmarrësit dhe potencialisht të gjithë stafin. Kështu që, në vitin 2023, 39% e pjesëmarrësve në trajnimet për ZBA ishin gra. Megjithatë, kjo përqindje u rrit në 45% në vitin 2024 falë veprimeve të ndërmarra në mënyrë të qëllimshme në kuadër të PPZBA 2025-2028.<sup>27</sup>

#### 3.1. Cilat pabarazi gjinore kanë ndikuar në pjesëmarrjen e pabarabartë të zyrtarëve në ZBA?

Nga 203 pjesëmarrës në trajnimet për ZBA që morën pjesë në anketën online (98 gra dhe 102 burra), shumica (80%) e kanë konsideruar pjesëmarrjen të lehtë ose shumë të lehtë; vetëm 1% e kanë konsideruar të vështirë. Nuk janë vërejtur dallime të rëndësishme sipas gjinisë. Për ata që nuk ndoqën të gjithë trajnimin, një përqindje më e lartë e grave (14%) krahasuar me burrat (5%) u përballën me vështirësi në sigurimin e kujdesit për fëmijët. Ndërkohë, më shumë burra deklaruan se distanca nga shtëpia (20%) dhe kohëzgjatja e

<sup>26</sup> Po aty.

<sup>27</sup> ZPS në kuadër të ZKM-së, "Lista e zyrtarëve të trajnuar për ZBA (të dhënat)", 2025.

trajnimin (35%) ishin arsye për ndërprerjen e trajnimit. Kjo mund të lidhet me faktin se më shumë pjesëmarrës burra (29%) sesa gra (17%) në anketë ishin nga zonat rurale. Ndërkohë, për më pak se një të tretën e grave dhe burrave që u përballën me sfida në ndjekjen e trajnimit, sfidat kryesore përfshinin mungesën nga puna dhe kostot e udhëtimit. Kështu që, gratë dhe burrat nuk duket se përballen me sfida thelbësisht të ndryshme në pjesëmarrjen në trajnim. Të dy grupet theksuan se organizimi i trajnimeve më afër vendit të punës/shtëpisë, subvencionimi i kostove të udhëtimit, ofrimi i kurseve online dhe ofrimi i trajnimeve në gjuhën e tyre amtare do të lehtësonin pjesëmarrjen në të ardhmen. Ndërsa disa pjesëmarrës preferuan përfundimin e trajnimit në mënyrë të vazhdueshme, të tjerë kërkuan që trajnimet të shpërndahen në disa sesione më të shkurtra dhe jo në ditë të plota të njëpasnjëshme.



**Kur trajnimi mbahet larg vendit të punës, atëherë udhëtimi bëhet një sfidë!**

### 3.2. Cili ka qenë ndikimi i këtyre trajnimeve nga perspektiva gjinore?

Shumica e grave (89%) dhe burrave (95%) e kanë konsideruar trajnimin të dobishëm; një përqindje pak më e lartë e grave (8%) krahasuar me burrat (5%) nuk e kanë konsideruar të dobishëm. Ndërsa pjesëmarrësit në përgjithësi ishin të kënaqur me përmbajtjen e trajnimit, disa kanë theksuar se ajo mund të përmirësohet përmes më shumë shembujve praktikë dhe ushtrimeve interaktive (veçanërisht të lidhura me Kosovën, legjislacionin ekzistues, punën dhe sektorët e tyre). Një pjesëmarrës kërkoi më shumë informata mbi lehtësimin e barrës financiare (p.sh., konfirmimi i pagesës dhe njoftimi për përmbardim; lehtësimi i borxhit), ndërsa një tjetër kërkoi që materialet të ndahen pas trajnimit.

Ndërkohë, për sa i përket ndikimit, më shumë burra raportuan se përdorin më shpesh në punën e tyre njohuritë e fituara krahasuar me gratë (Tabela 1). Kjo mund të shpjegohet pjesërisht me faktin se burrat kanë më shumë gjasa të punojnë në pozita vendimmarrëse, ku kanë më shumë mundësi për të zbatuar njohuritë e tyre.

Frekuenca	Gra	Burra
Asnjëherë	3%	0%
Rrallë	15%	12%
Ndonjëherë, çdo muaj	25%	22%
Shpesh, çdo javë	32%	25%
Shumë shpesh, çdo ditë	25%	41%

### 3.3. Analiza gjinore e materialeve për ndërtimin e kapaciteteve

Ky seksion shqyrton materialet për ndërtimin e kapaciteteve të përdorura në procesin e reformës së ZBA-së, duke përfshirë prezantimet e trajnimeve, modulet për hartimin e legjislacionit, materialet për të menduarit krijues dhe udhëzimet për vlerësimin e ndikimit rregullator, disa prej të cilave ofrohen përmes Institutit të Kosovës për Administratë Publike (IKAP). Qëllimi i këtij rishikimi ishte të vlerësojë në çfarë mase këto materiale kanë integruar perspektivën gjinore dhe kanë pajisur zyrtarët publikë me mjete për të identifikuar dhe adresuar barrierat e diferencuara në qasje në procedurat administrative, shërbimet digjitale dhe reformat rregullatore. Analiza u fokusua nëse barazia gjinore referohet në këto materiale dhe nëse metodologjitë dhe ushtrimet praktike ofrojnë mjete për operacionalizimin e vendimmarrjes së përgjegjshme gjinore në praktikë.

#### **Analiza gjinore e trajnimit dhe ushtrimeve të IKAP-it për ZBA**

Prezantimi paraqet parimet themelore procedurale të dizajnuara për të përmirësuar qasjen në administratë dhe për të reduktuar barrën e panevojshme, duke përfshirë transparencën, joformalitetin, efikasitetin, asistencën administrative, dorëzimin gojor të kërkesave, të drejtat gjuhësore, komunikimin elektronik dhe parimin “vetëm një herë”. Shumë nga këto dispozita janë shumë relevante për të siguruar qasje të barabartë në shërbimet publike. Për shembull, dispozitat që lejojnë dorëzimin verbal të kërkesave, përjashtimin nga

tarifat për ata që nuk kanë burime financiare, apo komunikimin në gjuhën amtare mund të jenë veçanërisht të rëndësishme për individët që përballen me barriera strukturore në qasje. Megjithatë, prezantimi i trajton këto parime strikt si standarde teknike administrative dhe nuk i lidh ato me konsiderata të barazisë apo qasjes. Nuk ka diskutim nëse gratë dhe burrat e ndryshëm mund të përballen me pengesa të ndryshme gjatë ndjekjes së procedurave administrative.

Ushtrimet praktike janë të dizajnuara për të trajnuar pjesëmarrësit në identifikimin e barrës administrative dhe propozimin e masave të thjeshtimit. Skenari i parë trajton procesin e regjistrimit si i papunë dhe marrjen e një certifikate, duke theksuar çështje si referimi i pasaktë ndërmjet institucioneve, vizitat e përsëritura fizike, dorëzimi fizik i dokumenteve, komunikimi i vonuar dhe joefikasitetet procedurale. Skenari i dytë fokusohet në procesin e aplikimit për leje taksie, duke përfshirë kërkesa të shumta dokumentare, dorëzim të detyrueshëm fizik të dokumenteve, një afat të gjatë për përpunim dhe tarifa administrative. Të dy ushtrimet janë efektive për t'u mësuar pjesëmarrësve të identifikojnë joefikasitetet procedurale dhe të harmonizojnë proceset administrative me parimet e thjeshtimit administrativ. Megjithatë, skenarët janë formuluar në terma neutralë dhe nuk i nxisin pjesëmarrësit të marrin parasysh nëse barra administrative mund të përjetohet ndryshe nga gra dhe burra të ndryshëm. Ushtrimet fokusohen në identifikimin dhe reduktimin e joefikasiteteve procedurale, që është objektivi i tyre kryesor. Ato nuk inkurajojnë në mënyrë eksplicite reflektimin mbi mënyrën se si vizitat e përsëritura, afatet e gjata, kërkesat për dokumentacion apo tarifat administrative mund të ndikojnë në mënyrë disproporcionale tek individët me përgjegjësi kujdesi, lëvizshmëri të kufizuar, burime financiare të kufizuara apo qasje të kufizuar në mjete digjitale. Po ashtu, ato nuk nxisin shqyrtimin nëse sektorë apo procedura të caktuara mund të reflektojnë pabarazi ekzistuese gjinore. Ndërsa mjetet e ZBA-së aplikohen në mënyrë të njëtrajtshme, integrimi i reflektimeve të tilla në trajnim do të ishte në përputhje me qasjet e integritit gjinor dhe do të mund të forconte identifikimin e barrierave të diferencuara në qasje.

### ***Analiza gjinore e modulit të trajnimit për hartimin e legjislacionit për ZBA***

Moduli i trajnimit për hartimin e legjislacionit, i zhvilluar në kuadër të Programit për Parandalimin dhe ZBA për ndërtimin e kapaciteteve, fokusohet në forcimin e aftësisë së zyrtarëve për të hartuar legjislacion primar dhe sekondar në mënyra që minimizojnë barrën administrative, thjeshtojnë procedurat dhe mbështesin digjitalizimin e shërbimeve. Materialet theksojnë testimin e proporcionalitetit, eliminimin e dokumenteve të panevojshme, shmangien e rregullimit të dyfishtë, gatishmërinë institucionale për shkëmbimin digjital të të dhënave dhe rregulla të qarta procedurale. Trajnimi gjithashtu thekson konsultimin me palët e interesit dhe analizën e nevojave të përdoruesve gjatë zhvillimit të legjislacionit, gjë që në mënyrë konceptuale mbështet dizajnimin gjithëpërfshirës dhe të orientuar drejt përdoruesit të shërbimeve.

Ky modul përfshin referenca eksplicite për barazinë gjinore dhe përfshirjen. Ai udhëzon hartuesit të përdorin gjuhë të përgjegjshme gjinore, të reflektojnë mbi kontekstin më të gjerë gjinor në Kosovë gjatë përgatitjes së legjislacionit, të konsultojnë gratë dhe grupet e marginalizuara gjatë proceseve të digjitalizimit dhe të zbatojnë parimet e BPGJ-së. Po ashtu, ai njuh se shërbimet digjitale nuk duhet të trajtohen si neutrale ndaj gjinisë dhe vë në pah se gratë mund të kenë nevoja të ndryshme për shkak të roleve sociale dhe pabarazive strukturore. Këto elemente tregojnë një vetëdijesim se dizajni i legjislacionit dhe reformat e digjitalizimit mund të ndikojnë ndryshe tek gratë dhe burrat e ndryshëm dhe se konsultimi dhe analiza gjithëpërfshirëse duhet të informojnë procesin e hartimit. Megjithëse konsideratat gjinore përmenden në mënyrë eksplicite, ato nuk operacionalizohen brenda mjeteve analitike të përdorura në trajnim. Testet e proporcionalitetit, ushtrimet për reduktimin e dokumenteve, udhëzimet për përcaktimin e tarifave dhe metodat e ridizajnit procedural nuk përfshijnë pyetje apo tregues për ndikimin gjinor, ndonëse këto mund të integrohen. Ushtrimet praktike fokusohen në rishkrimin e dispozitave ligjore për ZBA, por nuk kërkojnë nga pjesëmarrësit të

vlerësojnë nëse barrët ndikojnë ndryshe tek gratë dhe burrat apo nëse thjeshtimet e propozuara përmirësojnë qasjen e barabartë.

### ***Analiza gjinore e manualit të trajnimit për të menduarit krijues për përmirësimin e shërbimeve***

Ky manual paraqet një metodologji të strukturuar për përmirësimin e shërbimeve publike përmes qasjeve të përqendruara te përdoruesi, duke përfshirë intervistat e empatisë, identifikimin dhe pozicionimin e palëve të interesit, zhvillimin e profileve të përdoruesve, analizën e rrugëtimit të përdoruesit, gjenerimin e ideve, zhvillimin e prototipit dhe testimin. Metodologjia thekson kuptimin e përvojave të përdoruesve dhe identifikimin e barrierave procedurale para dizajnit të zgjidhjeve. Nga pikëpamja konceptuale, kjo qasje është në përputhje me politikëbërjen e përgjegjshme gjinore, pasi kërkon analizimin e mënyrës se si funksionojnë shërbimet në praktikë për përdorues të ndryshëm dhe inkurajon angazhimin e drejtpërdrejtë me përfituesit e shërbimeve. Megjithatë, manuali nuk ofron udhëzime për integrimin e konsideratave gjinore apo të përfshirjes sociale gjatë zbatimit të tij. Për shembull, faza e empatisë nuk i nxit pjesëmarrësit të marrin parasysh rolet gjinore, përgjegjësitë e kujdesit apo qasjen e pabarabartë në burime. Ushtrimet e identifikimit dhe pozicionimit të palëve të interesit dhe zhvillimin e profileve të përdoruesve nuk kërkojnë analizë të grave dhe burrave të ndryshëm, ndërsa përcaktimi i rrugëtimit të përdoruesit nuk përfshin identifikimin e barrierave të ndryshme në qasje. Po ashtu, faza e testimit nuk kërkon mbledhjen e reagimeve nga gratë dhe burrat e ndryshëm apo analizimin e rezultateve sipas gjinisë apo karakteristikave të tjera demografike (ndonëse kjo është bërë herë pas here në praktikë). Në përgjithësi, megjithëse trajnimi forcon kapacitetet për reforma të shërbimeve pjesëmarrëse dhe të përqendruara te përdoruesi, ai nuk e konkretizon në mënyrë sistematike vëmendjen ndaj avancimit të barazisë gjinore në metodologjinë e tij. Manuali nuk përfshin udhëzime analitike të ndjeshme gjinore, profile gjithëpërfshirëse të përdoruesve apo udhëzime për të siguruar që shërbimet e ridizajnuara adresojnë barrierat strukturore në qasje. Si rezultat, pjesëmarrësit trajnohen për të dizajnuar shërbime më efikase, por jo domosdoshmërisht më të barabarta apo të përgjegjshme gjinore.

### ***Analiza gjinore e prezantimit të trajnimit për vlerësimin e ndikimit rregullator***

Ky prezantim i njeh zyrtarët me metodologjinë për vlerësimin e ndikimeve ekonomike, sociale, mjedisore, gjinore dhe ndërsektoriale të legjislationit të propozuar dhe procedurave administrative. Ai shpjegon se si të përcaktohet problemi i politikës, të identifikohen palët e interesit, të krahasohen opsionet rregullatore, të vlerësohen kostot administrative duke përdorur Modelin Standard të Kostos dhe të vlerësohet digjitalizimi si një mjet për PZBA. Trajnimi përfshin ushtrime mbi procedurat e licencimit dhe kërkesat administrative, duke inkurajuar pjesëmarrësit të analizojnë se si procedurat ndikojnë te qytetarët dhe bizneset dhe të vlerësojnë zgjidhjet e politikave.

Prezantimi përfshin gjininë ndër kategoritë e ndikimit që duhet të vlerësohen gjatë analizës rregullatore. Seksioni për digjitalizimin i nxit pjesëmarrësit të marrin parasysh karakteristikat demografike të përdoruesve dhe se si zgjidhjet e propozuara digjitale mund të ndikojnë në grupet e ndryshme, duke përfshirë gratë. Trajnimi përfshin pyetje diskutimi mbi shërbimet digjitale që mund të përfitojnë veçanërisht gratë ose grupet e marginalizuara. Ai njeh rreziqet që lidhen me ndarjen digjitale, qasjen e paqëndrueshme dhe nivelet e ndryshme të aftësive digjitale. Këto elemente tregojnë se reformat administrative dhe digjitalizimi mund të mos ndikojnë në mënyrë të barabartë te të gjithë përdoruesit.

Megjithëse konsideratat gjinore janë të përfshira në kornizën analitike, trajnimi nuk ofron mjete ose udhëzime metodologjike për kryerjen e analizës së ndikimit gjinor. VNBJGJ e ABGJ-së nuk përfshihet si pjesë e trajnimit. Ushtrimet për modelimin e kostos, detyrat për përcaktimin e procedurave dhe krahasimet e opsioneve rregullatore fokusohen kryesisht në kohën administrative, tarifat, dokumentacionin dhe proceset institucionale, gjë që është në përputhje me qëllimin e trajnimit për ZBA dhe fokusin e tij në thjeshtimin procedural. Si rezultat, zyrtarët nxiten të njohin ndikimet gjinore, por nuk pajisen me metoda konkrete për t'i matur

apo adresuar ato brenda procesit të vlerësimit rregullator. Megjithëse kjo mund të jetë përtej fushëveprimit të synuar të trajnimit, përfshirja e metodave dhe shembujve të tillë mund të mbështesë identifikimin e mundësive për përmirësimin e përvojës së përdoruesve.

#### 4. Cilat janë përvojat e grave dhe burrave të ndryshëm me barrën administrative dhe ZBA-në?<sup>28</sup>

##### 4.1. Në çfarë mase gratë dhe burrat e ndryshëm kanë marrë pjesë në dizajnimin e shërbimeve më të mira publike për zvogëlimin e barrës administrative?

Gratë kanë qenë të nënperfaqësuar në proceset e bashkë-dizajnit, duke ngritur pyetje mbi gjithëpërfshirjen e qeverisjes digjitale.<sup>29</sup> Historikisht, gratë janë përfshirë kryesisht si përdoruese përfundimtare që japin komente pas lansimit të shërbimeve, dhe jo si pjesëmarrëse në bashkë-dizajnim, testim të përdoruesve apo procese vendimmarrëse. Gratë qytetare, zyrtaret, ZBGJ-të dhe ekspertët gjinorë nuk janë angazhuar në mënyrë sistematike në dizajnimin e shërbimeve të eKosova-s.<sup>30</sup> Një studim i vitit 2024 gjeti se, megjithëse ekzistojnë mekanizma formalë konsultimi, ata mbeten kryesisht proceduralë, me pak dëshmi që reagimet e përdoruesve ndikojnë në reformat.<sup>31</sup> Vlerësimet e nevojave të rishikuara ishin jokonsistente, duke u mbështetur kryesisht në anketa të brendshme; gjurmimi i kënaqshmërisë ishte i dobët; qasjet e bashkë-dizajnit mungonin; dhe shërbimet rrallë strukturoheshin rreth ngjarjeve jetësore siç rekomandohet nga standardet ndërkombëtare. Studimi arriti në përfundimin se Kosova ka bazë ligjore dhe rregullatore për dizajnimin pjesëmarrës të shërbimeve, por zbatimi kuptimplotë dhe gjithëpërfshirës ende mungon, veçanërisht për grupet e cenueshme.

Pjesëmarrësit në hulumtim kanë vënë në pah se organizatat e grave, përdoruesit ruralë, personat me aftësi të kufizuara dhe grupet tjera përfshihen ndonjëherë, por jo në mënyrë të qëndrueshme, në fazat e dizajnit ose testimit të shërbimeve. Po ashtu, ZBGJ-të apo ekspertët e gjinisë nuk përfshihen në mënyrë sistematike në grupet punuese apo proceset e konsultimit. Mungesa e të dhënave të drejtpërdrejta nga përdoruesit përfundimtarë lidhur me barrierat e diferencuara në qasje e zvogëlon kapacitetin e reformave për të parashikuar dhe adresuar pabarazitë në barrën administrative në praktikë.



**Duhet të flisni me njerëzit që përdorin shërbimin. Faza e dizajnit është më e rëndësishmja.**

##### 4.2. Relevanca: Deri në çfarë mase rreth 20 shërbime digjitale dhe procedura të thjeshtuara i kanë adresuar në mënyrë adekuate nevojat specifike të grave?

Kjo ka marrë parasysh qasjen dhe përdorimin e platformës eKosova, duke u fokusuar në shërbimet e digjitalizuara brenda procesit të ZBA-së; si dhe disponueshmërinë dhe qasshmërinë e shërbimeve relevante për gratë, siç janë ngjarja jetësore e lindjes së fëmijës, provimi i jurisprudencës dhe profesionet e lira juridike, ndër të tjera. Vlen të theksohet se përpjekjet për thjeshtim janë të kufizuara nga korniza ligjore dhe kërkesat institucionale.

<sup>28</sup> Ky seksion gjithashtu i përgjigjet pyetjeve: cili ka qenë efektiviteti dhe ndikimi i reformave të ZBA-së në aftësinë e grave për të pasur qasje në shërbime? Në çfarë mase kursimet e raportuara të kostove reflektojnë reduktimet reale në kohë dhe barrë ekonomike për gratë dhe grupet e marginalizuara? Në çfarë shkalle masat e thjeshtimit si platforma eKosova dhe parimi “vetëm një herë” kanë reduktuar barrën e ndërlidhur me ZBA-në për gratë dhe burrat e ndryshëm?


<sup>29</sup> Blerta Thaqi, [Women Accessibility to e-Kosova](#), 2024.

<sup>30</sup> Po aty dhe intervistat e RrGK-së, 2026.

<sup>31</sup> *Sylë Sefaj, Përfshirja e përdoruesve në ofrimin e shërbimeve publike, 2024.* Sefaj ka aplikuar një kornizë të strukturuar monitorimi në katër shërbime me ndikim të lartë: gjendja civile, regjistrimi i automjeteve, mirëqenia sociale/pensionet dhe punësimi. Metodologjia ka kombinuar rishikimin dokumentar të kornizës ligjore dhe rregullatore me anketa institucionale dhe konsultime, duke vlerësuar gjashtë dimensionet: konsultimin dhe gjithëpërfshirjen, vlerësimin e nevojave, mekanizmat e reagimit, gjurmimin e kënaqshmërisë, bashkë-dizajnimin dhe strukturimin sipas ngjarjeve jetësore.

Prandaj, sigurimi që shërbimet janë relevante për nevojat e grave mund të kërkojë reforma ligjore jashtë mandatit të ZPS-së në kuadër të ZKM-së. Për më tepër, vlerësimi i saktë i shkallës në të cilën reformat kanë përmbushur nevojat e grave do të kërkonte një anketë përfaqësuese të ekonomive familjare për të pyetur gratë dhe burrat lidhur me masën në të cilën shërbimet kanë përmbushur nevojat e tyre. Kjo pjesë përdor të dhëna cilësore dhe rrjedhimisht ka kufizime në përgjigjen ndaj kësaj pyetjeje.

Pjesëmarrësit theksuan se procedurat e thjeshtuara dhe veçanërisht platforma eKosova janë relevante për shumë gra (dhe burra). Thjeshtimi ka përmirësuar qasjen në procedurat administrative për përdoruesit që janë në gjendje të shfletojnë në mënyrë të pavarur sistemet digjitale, veçanërisht duke reduktuar hapat administrativë, vizitat e përsëritura institucionale, kërkesat për udhëtim, kohën e pritjes dhe dorëzimin e dokumenteve. Shërbimet e lidhura me ngjarjet jetësore, duke përfshirë regjistrimin e lindjes dhe procedurat përkatëse, u theksuan si veçanërisht të dobishme në thjeshtimin e proceseve administrative gjatë periudhave me ndërveprim të lartë me institucionet publike. Në mënyrë të ngjashme, digjitalizimi i procedurave profesionale, si aplikimet për provimin e jurisprudencës apo profesionet e lira juridike, ka reduktuar kërkesat për dokumentacion dhe hapat proceduralë. Ndër shërbimet e digjitalizuara deri më tani, një përqindje më e madhe e burrave të anketuar përmes këtij VNGJ deklaruan se certifikatat janë shërbimi më i dobishëm. Një përqindje e madhe e grave u pajtuan, duke përmendur gjithashtu shërbimet që lidhen me familjen, fëmijët dhe përfitimet e lehonisë, si dhe regjistrimin civil si veçanërisht të dobishme (Grafiku 1). Kjo jep një indikacion se cilat shërbime mund të kenë qenë më relevante për gratë dhe burrat.



Ndërkohë, palët e interesit theksuan se qasja dhe përdorimi efektiv i shërbimeve digjitale ndryshon ndjeshëm varësisht nga gjinia, aftësitë digjitale, moshën, nivelin e arsimit, përkatësitë etnike, aftësitë e kufizuara dhe disponueshmëria e mbështetjes teknike. Disa përdorues i përfundojnë procedurat në mënyrë të pavarur online, ndërsa të tjerë mbështeten në anëtarët e familjes ose në ndihmën institucionale. Disa individë, përfshirë të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara, jetojnë vetëm dhe kanë mbështetje të kufizuara ose fare nga familja. Pa monitorim sistematik të përdorimit të shërbimeve sipas gjinisë, rajonit apo profilit të përdoruesit, vlerësimi nëse shërbimet pasqyrojnë në mënyrë adekuate nevojat e grave mbetet sfidues.

Në përgjithësi, dëshmitë sugjerojnë se, ndonëse iniciativat e digjitalizimit kanë kontribuar në përmirësimin e efikasitetit procedural, ato nuk kanë përfshirë në mënyrë sistematike analizën gjinore ndërsektoriale të rrugëve administrative të grave, kufizimeve kohore, përgjegjësisë të kujdesit apo ekspozimit sektorial ndaj shërbimeve publike. Prandaj, shërbimet digjitale mund të mos jenë gjithmonë relevante për nevojat specifike të grave.


#### 4.3. Si i qasen dhe i përdorin gratë dhe burrat e ndryshëm mjetet e ZBA-së, siç janë eKosova, lejet, licencat dhe dokumentacioni?

Në përgjithësi, përdorimi i internetit në Kosovë është pothuajse universal, me 99.3% të grave, 98.6% të burrave dhe 99% të popullsisë të ndërlidhur.<sup>32</sup> Qasja është në masë dërrmuese e bazuar në pajisje mobile: 95% e grave dhe 96% e burrave mbështeten në telefonat e mençur për t'u lidhur me internetin në shtëpi.<sup>33</sup> Këto shifra sugjerojnë se Kosova në masë të madhe e ka tejkaluar hendekun e qasjes digjitale në nivel të lidhshmërisë. Megjithatë, hulumtimet sugjerojnë se lidhshmëria e lartë nuk është përkthyer në qasje të barabartë në shërbimet elektronike. Një studim i vitit 2024 ka konstatuar se, megjithëse të anketuarit kanë tendencë të raportojnë nivel të lartë të besimit në aftësitë digjitale dhe qasje në telefonat e mençur, shërbimet e eKosova nuk ishin njësoj të qasshme: gratë hasën në paqëndrueshmëri teknike,<sup>34</sup> udhëzime të paqarta dhe kategorizim jo intuitiv të shërbimeve thelbësore siç janë shtesat për fëmijë apo pensionet për aftësi të kufizuara.<sup>35</sup>

Megjithëse nuk janë përfaqësues për popullatën e përgjithshme, gratë dhe burrat e anketuar përmes këtij VNGJ kishin tendencë ta konsideronin eKosova-n të lehtë për përdorim (Grafiku 2). Ndërkohë, intervistat sugjeruan se kategori të caktuara ende përballen me sfida (shih më poshtë). Pjesëmarrësit në anketë gjithashtu kishin tendencë të pajtoheshin se eKosova dhe platformat e tjera online ua kanë lehtësuar jetën (Grafiku 3).

Ndërkohë, si gratë ashtu edhe burrat kanë mungesë njohurish se disa shërbime janë të disponueshme në mënyrë elektronike. Megjithëse të dhënat nuk janë statistikisht të rëndësishme apo përfaqësuese për popullatën, ato sugjerojnë se gratë kishin më shumë njohuri se burrat për disponueshmërinë e shumicës së shërbimeve online, përveç shërbimeve të biznesit dhe dokumenteve civile (Grafiku 4).

Gratë dhe burrat raportuan se përballen me disa sfida në qasjen në shërbime, veçanërisht kostot e larta dhe orari i papërshtatshëm i punës, duke pasur parasysh pamundësinë e tyre për të lënë mënjane punën për t'u qasur në shërbime (Grafiku 5). Një përqindje më e lartë e burrave sesa grave deklaruan se distancat e gjata për të udhëtuar për shërbime (31%) dhe kohët e gjata të pritjes (46%) paraqesin sfida, ndoshta për shkak se burrat historikisht kanë qenë më të prirë se gratë të përdorin shërbime me prezencë fizike (shih më poshtë). Ndërkohë, një përqindje më e lartë e grave sesa burrave deklaruan se procedurat e paqarta (29%), diskriminimi (23%) dhe kujdesi për fëmijë (15%) paraqesin sfida.



<sup>32</sup> RrGK, *Barazia Gjinore: Në qendër të TI-së...dhe më përtej: Analiza gjinore e digjitalizimit në Kosovë*, 2024.

<sup>33</sup> Po aty.



<sup>34</sup> Këto përfshinin mosfunksionimin e sistemit, ndërprerjen e platformës, kohën e gjata të ngarkimit, dështimet në dorëzim dhe gabimet gjatë hyrjes në sistem ose ngarkimit të dokumenteve.

<sup>35</sup> Blertha Thaqi, *Women Accessibility to e-Kosova*, 2024. Studimi ka aplikuar metoda të përziera, duke kombinuar një anketë online me 76 gra me përgatitje të ndryshme me intervista dhe literaturë dytësore.

Në disa raste, pjesëmarrësit në anketë kanë ndaluar përdorimin e një shërbimi online para përfundimit të tij. Arsyet kryesore përfshinin se shërbimi ishte shumë i ndërlikuar, shumë i ngadalshëm ose kërkonte dokumente të panevojshme (Grafiku 6).


Kur u pyetën se cilat veprime do t'i ndihmonin më së shumti, gratë dhe burrat përmendën trajnimin udhëzues për përdorimin e eKosova (që mund të ofrohet përmes udhëzimeve online dhe kutive të bisedës), si dhe përmirësimin e disponueshmërisë së shërbimeve online, të pasuara nga koha më e shkurtër e pritjes, kostot më të ulëta dhe informimi më i mirë (Grafiku 7).

Në përgjithësi, të dhënat e Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit sugjerojnë se ndërmjet vitit 2021 dhe shkurtit 2026, shërbimet janë përdorur dukshëm më shumë nga burrat (74% e shërbimeve të përdorura) sesa nga gratë.<sup>36</sup> Një rishikim i 20 shërbimeve më të përdorura është ilustrues (Grafiku 8). Shërbimet që gratë i përdorën më shumë se burrat lidhen me materialet shkollore dhe shtesat për fëmijë, duke ilustruar rëndësinë e iniciativës së Qeverisë që inkurajon gratë të hapin llogari bankare për këto përfitime.



<sup>36</sup> Të dhënat e ofruara për RrGK-në në shkurt 2026. Shih Shtojcën 14 për të dhëna të mëtejshme, të ndara sipas gjinisë.

## Përdoruesit e Shërbimeve të eKosova-s, 2021-2026 (Shkurt)



Caktimi i termineve për COVID-19 kishte një balancë gjinore të përdoruesve. Vlen të theksohet se verifikimi i sigurimit/regjistrimit të automjeteve dhe paraqitja e ankesave kundër zyrtarëve policorë nuk kishin të dhëna të ndara sipas gjinisë, duke treguar nevojën që gjinia të bëhet një fushë e detyrueshme në këto sisteme. Duke qenë se regjistrimi i automjeteve, ndër shërbime të tjera, mund të përfshijë palë të treta, sistemi mund të mbledhë të dhëna të ndara sipas gjinisë si për palën e tretë ashtu edhe për përfutuesin përfundimtar të shërbimit, duke hedhur dritë edhe mbi atë se kush i përdor palët e treta për këto shërbime.

Deri në një masë, përdorimi është i paracaktuar nga normat dhe stereotipet më të gjera gjinore që lidhen me profesione specifike. Për shembull, në fushën e gjeodezisë, përbërja gjinore e aplikuesve përcaktohet kryesisht nga grupi ekzistues i profesionistëve të licencuar dhe kandidatëve që hyjnë në profesion; gjeodetët priren të jenë burra. Një studim i vitit 2024 ka konstatuar se gratë përdorin më shumë licencimin në profesionet shëndetësore sesa burrat dhe kanë rritur praninë e tyre në drejtësi, por mbeten pothuajse të papërfaqësuar në fusha si falimentimi dhe gjeodezia.<sup>37</sup> Gratë e reja janë përqendruar në sektorë tradicionalë si shëndetësia dhe arsimiti. Shërbimet digjitale nuk mund të ndikojnë domosdoshmërisht në balancën gjinore të përdoruesve kur shumica e kandidatëve janë burra.<sup>38</sup> Në raste të tilla, digjitalizimi synon të sigurojë qasje të barabartë dhe procedura të thjeshtuara për të gjithë aplikuesit e kualifikuar, por nuk mund të ndryshojë domosdoshmërisht përbërjen demografike të vetë profesionit. Prandaj, ndërsa shërbime si aplikimi për provimin e jurisprudencës apo proceset e licencimit profesional reduktojnë hapat administrativë, ndikimet e tyre të lidhura me gjininë varen nga përdoruesit.


<sup>37</sup> Autori i panjohur, "Përfshirja e sistemit të licencimit në Kosovë për gratë dhe të rinjtë", 2024. Studimi ka përdorur të dhëna të institucioneve publike (2012–2022) për të vlerësuar se si gratë dhe të rinjtë i navigojnë proceset e licencimit.

<sup>38</sup> Koment i GIZ-it për projektraportin.

Në përgjithësi, gjetjet nga intervistat sugjerojnë se, megjithëse thjeshtimi administrativ dhe digjitalizimi kanë reduktuar disa hapa proceduralë, qasja në shërbime vazhdon të ndryshojë varësisht nga disponueshmëria kohore e përdoruesve, aftësitë digjitale, gjuha, vendndodhja gjeografike, statusi i aftësisë së kufizuar, përkatësia etnike dhe përgjegjësitë e kujdesit. Këta faktorë ndikojnë jo vetëm në atë nëse shërbimet mund të qasen në mënyrë digjitale, por edhe në kohën totale të nevojshme për të përfunduar procedurat, përfshirë udhëtimin, pritjen, verifikimin e dokumenteve dhe nevojën për ndihmë.

### Kufizimet kohore dhe koha pritjes

Hulumtimi synoi të shqyrtojë dallimet me të cilat mund të përballen gratë dhe burrat e ndryshëm në kohët e pritjes, duke marrë parasysh udhëtimin, organizimin e kujdesit për fëmijë dhe kostot e tjera. Ndër pjesëmarrësit në anketë, një përqindje më e lartë e grave sesa burrave mendonin se kohët e pritjes ishin të gjata ose të tepërta (Grafiku 9). Në shërbimet e fundit që vizituan në vitin 2025, pak më shumë gra sesa burra raportuan se kishin vizituar më shumë se një institucion (Tabela 2).<sup>39</sup> Pjesëmarrësit në hulumtim theksuan se kohët e pritjes duhet të kuptohen si përfshirëse të udhëtimit drejt institucioneve, vizitave të përsëritura dhe kohëve të lidhura të pritjes për shkak të digjitalizimit jo të plotë, si dhe kohës së nevojshme për të organizuar kujdesin për fëmijë ose mungesën nga puna. Gratë përshkruan vazhdimisht se përballen me kufizime më të mëdha kohore për shkak të përgjegjësive shtëpiake dhe të kujdesit, gjë që mund t'i bëjë vizitat e përsëritura institucionale ose procedurat hibride veçanërisht të rënda.



**Tabela 2. Numri i institucioneve të vizituara për shërbimin e fundit sipas përqindjes së grave dhe burrave të anketuar**

Vizituar	Gra	Burra
1	50%	56%
2	30%	25%
3+	20%	19%

<sup>39</sup> Duke pasur parasysh madhësinë e vogël të mostrës, nuk ishte e mundur të identifikohen trendët që lidhen me gjininë dhe vendbanimin urban/rural, si dhe llojin e shërbimit.

## **Mosha, gjuha, vendndodhja gjeografike, aftësia e kufizuar**

Ky hulumtim shqyrtoi qasshmërinë e mjeteve të ZBA-së për grupe specifike të grave dhe burrave (përdorues ruralë, me të ardhura të ulëta, me aftësi të kufizuara, nga komunitetet pakicë dhe/ose të moshuar). Palët e interesit raportuan se qasja në mjetet digjitale administrative ndryshon ndjeshëm ndërmjet grupeve të popullsisë. Përdoruesit e moshuar dhe ata me aftësi më të ulëta digjitale mund të kenë vështirësi në përfundimin e procedurave në mënyrë të pavarur online. Banorët ruralë mund të përballen me kufizime të lidhshmërisë ose me kohë më të gjata udhëtimi në rastet kur ende kërkohet prezenca fizike. Përdoruesit e gjuhëve të pakicave mund të hasin pengesa kur ndërfaqet digjitale ose materialet udhëzuese nuk janë të qasshme në gjuhën e tyre. Personat me aftësi të kufizuara përballen si me barriera të qasshmërisë fizike, ashtu edhe me sfida procedurale kur sistemet kërkojnë konfirmime të përsëritura me prezencë fizike ose dorëzim të dokumentacionit. Personat me aftësi të kufizuara të përhershme u janë nënshtruar rivlerësimeve të përsëritura pavarësisht kushteve të përjetshme; ndërsa prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara janë detyruar të dorëzojnë sërish dokumente dhe të paraqiten shpesh fizikisht.<sup>40</sup> Pjesëmarrësit theksuan nevojën për digjitalizimin e plotë të këtyre proceseve, ofrimin e udhëzimeve më të qarta, sigurimin e njohjes automatike të kushteve të përhershme dhe ndërgjegjësim më efektiv për të garantuar qasshmërinë.

### **Përgjegjësitë e ndërlidhura me kujdesin**

Pjesëmarrësit në intervista theksuan se përgjegjësitë e kujdesit ndikojnë në mënyrën se si përdoruesit ndërveprojnë me sistemet administrative. Gratë në veçanti u përshkruan si më të prira për të balancuar procedurat administrative krahas kujdesit për fëmijët, të moshuarit apo detyrave shtëpiake, gjë që mund të kufizojë fleksibilitetin në caktimin e vizitave institucionale ose në pritjen për përfundimin e shërbimeve. Në rastet kur shërbimet kërkojnë hapa të shumtë ose vizita pasuese, kufizimet mund të rrisin barrën administrative edhe nëse procedurat formale janë thjeshtuar.

“

**Ka shumë persona të moshuar që jetojnë vetëm, pasi anëtarët më të rinj të familjes janë larguar nga komunitetet, dhe ata shpesh nuk kanë njohuritë e nevojshme për t'u qasur**

“

**Personat rreth moshës 50 vjeçare gjithashtu e kanë të vështirë të kyçen, edhe nëse janë të arsimuar. Shumë prej tyre nuk kanë telefona apo laptopë në shtëpi. Atyre u duket e vështirë dhe nuk duan të përpiqen. [...] Nuk po flasim për studentët, sepse e dimë që ata mund ta bëjnë këtë. Po flasim për amviset që kanë vështirësi dhe janë plotësisht të**

“

**Kujdesi për fëmijët duhet të përfshijë konsideratë shtesë për kohën e grave, qoftë për fëmijët apo për të moshuarit. Çdo dokument i kërkuar nga një institucion tjetër shton kohë dhe kosto**

“

**Nëna ime është 78 vjeçare; ajo nuk është mësuar të përdorë platformat. Ajo është me fat që më ka mua për ta ndihmuar [...] Shumë të moshuar dhe persona me aftësi të kufizuara kanë dikë që i ndihmon. Por çfarë nëse ajo nuk do të më kishte mua? Çdo gjashtë muaj ajo duhet të shkojë në Departamentin e Pensioneve për të marrë një nënshkrim dhe vulë që konfirmon se është gjallë për të marrë pensionin e saj. Si mund të zhvillohet eKosova për këto çështje në mënyrë që ajo të mos ketë nevojë të shkojë atje? Ajo duhet të përdorë autobusin. Për këto grupe njerëzish, apo për personat me dëmtime në shikim, me aftësi të kufizuara fizike [...] kush i ndihmon ata?”**

<sup>40</sup> Një studim i vitit 2024 ka përfshirë perspektiva të drejtpërdrejta të përdoruesve, duke u bazuar në tri grupe të fokusit me 28 pjesëmarrës në pesë komuna. Pjesëmarrësit theksuan nevojën për digjitalizim, udhëzime më të qarta, njohje automatike të kushteve të përhershme dhe ndërgjegjësim më efektiv për të garantuar qasshmërinë (UBO Consulting, Raporti i Grupeve të Fokusit – Angazhimi i Përdoruesve në Dizajnimin dhe Ofrimin e Shërbimeve, 2024). Raporti nuk përmbante analizë gjinore.

#### 4.4. Deri në çfarë mase gratë dhe burrat e ndryshëm i kanë burimet e nevojshme për të përdorur shërbimet publike, dhe në veçanti mjetet e ZBA-së?

Hulumtimi shqyrtoi shkallën në të cilën kufizimet e burimeve mund të pengojnë qasjen e grave dhe burrave të ndryshëm, duke përfshirë kostot financiare, qasjen e kufizuar në mjete digjitale dhe kufizimet e burimeve njerëzore, siç janë ato që ndërlidhen me aftësitë digjitale.

Një raport i vitit 2022 nga Korporata Ndërkombëtare Financiare mbi procedurat administrative në Komunën e Pejës ka konstatuar se 10% e procedurave përbënin 85% të kostove administrative, me barra të konsiderueshme indirekte si koha, dokumentacioni dhe pengesat në qasje.<sup>41</sup> Megjithëse studimit i mungonte analiza gjinore, kosto të tilla ka të ngjarë të ndikojnë në mënyrë disproporcionale tek gratë, veçanërisht ato me kohë, të ardhura apo qasje të kufizuara digjitale.

Intervistat treguan se qasja në shërbimet publike varet nga burimet financiare, teknike dhe praktike të përdoruesve. Të anketuarit theksuan se, ndonëse digjitalizimi redukton disa kosto administrative<sup>42</sup>, kostot indirekte mbeten, duke përfshirë transportin, kohën jashtë punës, organizimin e kujdesit për fëmijë dhe nevojën për të kërkuar ndihmë nga të tjerët për të përfunduar procedurat. Palët e interesit raportuan se disa përdorues mbështeten në anëtarët e familjes, ndërmjetësues apo ndihmë të paguar për të shfletuar sistemet digjitale, veçanërisht kur aftësitë digjitale janë të kufizuara. Qasja në pajisje të përshtatshme, lidhjet stabile interneti dhe aftësitë bazë digjitale u përshkrua si e pabarabarta ndërmjet grupeve të popullsisë, ku përdoruesit e moshuar, banorët ruralë dhe disa familje me të ardhura të ulëta kanë më shumë gjasa të përballen me kufizime në përdorimin e pavarur të platformave online si eKosova. Këto kufizime mund të përkeqësohen për gratë në këto grupe, të cilat përgjithësisht prirën të kenë më pak burime. Një shqetësim i shprehur në mënyrë të përsëritur është kërkesa e tepruar për të printuar dhe skanuar dokumente. Kjo praktikë krijon kosto të panevojshme financiare dhe vështirësi praktike për përdoruesit, veçanërisht për personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit që mund të mos posedojnë printerë. Ndërsa këto shpenzime mund të duken të vogla për disa përdorues, ato mund të përbëjnë një barrë të konsiderueshme për familjet me të ardhura të ulëta dhe personat me aftësi të kufizuara, veçanërisht për gratë që mund të përballen me barriera shtesë financiare.

Pjesëmarrësit në intervista gjithashtu theksuan se dallimet në njohuritë dhe vetëbesimin digjital ndikojnë në lehtësinë e përdorimit. Ndërsa disa përdorues i përfundojnë procedurat shpejt online, të tjerë hasin vështirësi në kuptimin e hapave të aplikimit, ngarkimin/shkarkimin e dokumenteve apo në gjurmimin e aplikimeve. eKosova ofron një seksion “Shiko videot udhëzuese”, dhe pjesëmarrësit në hulumtim treguan se videot mund t’i ndihmojnë njerëzit të mësojnë si të shfletojnë platformën. Megjithatë, shumë video nuk



Qasja në telefonat e mençur apo në internet nuk është e mjaftueshme. Grave u mungojnë gjithashtu aftësitë dhe koha e nevojshme për të përfunduar shërbimet në mënyrë të pavarur.



Nëse ke një telefon të mençur, duhet të kuptosh si ta hapësh eKosova me të. [...] Ndoshta vetëm 5% e personave me aftësi të kufizuara mund ta bëjnë këtë; është veçanërisht më e vështirë për personat e moshuar. [...] Kam ndihmuar ndoshta 20 persona muajin e kaluar për të aplikuar për subvencione për energjinë elektrike [dhe] asistencë sociale. Shumë prej tyre nuk kanë interes as të mbajnë mend fjalëkalimet e tyre. “Ti mbaje në mend”, thonë ata. “Unë nuk mund t’i mbaj mend të gjitha fjalëkalimet tuaja,” u them atyre. “Unë i harroi edhe të miam”



Gratë kanë frikë të bëjnë gabime dhe kanë më pak vetëbesim, ndërsa burrat kanë vetëbesim gjatë përdorimit të shërbimeve digjitale.

<sup>41</sup> Korporata Ndërkombëtare Financiare, *Inventari dhe Analiza e Procedurave Administrative në Komunën e Pejës*, 2022.

<sup>42</sup> Anketa online nuk ka zbuluar dallime të rëndësishme në kostot e drejtpërdrejta të shërbimeve për gratë dhe burrat lidhur me shërbimin e fundit të përdorur. Duke pasur parasysh mostrën jo përfaqësuese dhe faktin se shërbimet mund të përfshijnë kosto të ndryshme, këto të dhëna nuk janë përfshirë për të shmangur interpretimet potencialisht të gabuara.

funksionojnë në mënyrë të qëndrueshme dhe jo të gjitha shërbimet i kanë ato. Videot përfshijnë narracion me zë dhe përkthim, por u mungojnë veçoritë si përshkrimet e audios, duke i bërë të vështira për përdorim për personat e verbër, të shurdhër dhe ata me dëgjim të kufizuar. Videot janë të vendosura në një seksion të veçantë dhe nuk janë të integruara me shërbimet specifike, duke kërkuar që përdoruesit të rikthehen në faqen kryesore. Kjo krijon sfida për lehtësinë e përdorimit, kohën dhe për përdoruesit me aftësi të kufizuara digjitale.

#### 4.5. Deri në çfarë mase normat dhe vlerat ndikojnë në qasjen e grave dhe burrave të ndryshëm në mjetet e ZBA-së?

Tradicionalisht, burrat kanë qenë më të prirë sesa gratë të qasen në shërbimet publike në emër të të gjithë anëtarëve të familjes si “kryefamiljarë”. Duke pasur parasysh normat gjinore të socializuara, rolet dhe marrëdhëniet e pushtetit brenda familjeve, gratë mund të kenë më pak qasje në shërbimet e thjeshtuara dhe të digjitalizuara, përveç nëse këto role kundërshtohen në mënyrë aktive. Për shembull, kërkesa që gratë të regjistrohen për përfitimet për fëmijë është një shembull konkret ku Qeveria ka kundërshtuar në mënyrë aktive rolet gjinore në qasjen në shërbimet publike, duke ndikuar pozitivisht në hapjen e llogarive bankare nga gratë. Ndoshta një rezultat i paqëllimshëm ishte se kjo iniciativë njëkohësisht përforcoi normat gjinore që gratë (jo burrat) kanë rolin kryesor në kujdesin për fëmijët. Përforcimi i roleve gjinore mund të minojë kujdesin e balancuar gjinor, duke kontribuar në pjesëmarrjen e vazhdueshme të ulët të grave në tregun e punës dhe në jetën publike.

Një përqindje më e lartë e burrave të anketuar (80%) kanë përdorur shërbime me prezencë fizike krahasuar me gratë (68%), të cilat kishin pak më shumë gjasa të varen nga partnerët e tyre (22% e grave krahasuar me 10% të burrave). Intervistat treguan se normat shoqërore, marrëdhëniet e pushtetit brenda familjes dhe rolet gjinore të kujdesit mund të ndikojnë në mënyrën se si gratë dhe burrat qasen në shërbimet administrative dhe mjetet digjitale. Rolet gjinore që lidhen me përgjegjësitë shtëpiake dhe kujdesin mund të reduktojnë kohën në dispozicion të grave për t’u angazhuar me procedurat administrative, veçanërisht kur shërbimet ende kërkojnë vizita fizike ose hapa të përsëritur. Dinamika familjare dhe pritshmëritë shoqërore mund të formësojnë qasjen, duke përfshirë situatat kur gratë mbështeten tek bashkëshortët apo anëtarët e familjes për të siguruar dokumente ose për të ndërvepruar me institucionet në emër të tyre. Këto modele mund të jenë veçanërisht të theksuara në komunitetet e margjinalizuara dhe tek gratë me aftësi të kufizuara, ku pengesat e ndërthurura që lidhen me gjininë, aftësinë e kufizuar, qasjen në informacion dhe komunikim mund të kufizojnë më tej qasjen e pavarur në shërbime. Më gjerësisht, mungesa e besimit institucional, përvojat negative të mëparshme në mjedise administrative me prezencë fizike dhe perceptimet për pabarazi në pushtet mund të ndikojnë gjithashtu në gatishmërinë për t’u angazhuar me shërbimet publike. Prandaj, qasja formësohet jo vetëm nga disponueshmëria e sistemit, por edhe nga normat shoqërore dhe dinamika familjare.

Për shkak të marrëdhënieve të pushtetit brenda familjeve dhe shoqërisë, gratë kanë shumë më shumë gjasa sesa burrat të përjetojnë dhunë me bazë gjinore. Dhuna në familje mund të kontribuojë në mungesën e qasjes së grave në mjetet digjitale për përdorimin e shërbimeve. Në situata të abuzimit në familje, gratë mund të izoloohen në shtëpi, duke penguar qasjen fizike në shërbime. Në disa raste, gratë që përjetojnë dhunë mund të përdorin mjete digjitale për të qasur shërbime dhe



**Burrat thonë: “Jo, nuk do të shkosh ... Çfarë do të kërkojë ti, si grua, atje?”**



**Gratë me aftësi të kufizuara shpesh nuk merren seriozisht. Ata nuk më trajtojnë sipas moshës sime, por si një vajzë e re. [K]ur është një burrë, ai trajtohet si burrë. Pse të më trajtojnë si fëmijë vetëm sepse jam në karrocë? Karroca nuk e përcakton karakterin apo moshën time**

ndihmë.<sup>43</sup> Në situata të tjera, burrat mund të kontrollojnë qasjen e grave në mjetet digjitale dhe ato mund të mos kenë fare qasje. Gjocaj ka vënë në dukje se dhuna me bazë gjinore mund të kufizojë pjesëmarrjen në hapësirat digjitale, veçanërisht përmes ngacmimit online, përndjekjes kibernetike dhe fushatave të dezinformimit që synojnë gratë në jetën publike, të cilat minojnë besimin digjital dhe dekurajojnë angazhimin aktiv online.<sup>44</sup>

#### 4.6. Pushteti

Gjetjet nga nënseksionet e mëparshme tregojnë se qasja në procedurat administrative dhe shërbimet digjitale formësohet nga rregullat formale, por edhe nga praktikat institucionale, modelet e vendimmarrjes brenda familjes dhe qasja e pabarabartë në informacion dhe burime. Ndërsa reformat e ZBA-së synojnë të thjeshtojnë procedurat për të gjithë qytetarët, aftësia për të përfituar nga këto reforma varet nga kush kontrollon dokumentacionin, mjetet digjitale, kohën dhe njohuritë. Zyrtarët publikë ruajnë fuqi të konsiderueshme diskrecionale në zbatim, duke përfshirë kërkesat për dokumentacion fizik, pranimin e pabarabartë të të dhënave digjitale dhe dallimet në mënyrën se si zbatohen procedurat nëpër komuna. Marrëdhëniet e pushtetit mund të ndryshojnë në bazë të gjinisë për shkak të roleve gjinore të socializuara; ndërthurja e gjinisë dhe aftësisë së kufizuar mund të përkeqësojë pengesat në qasje. Kështu, pushteti mund të ndikojë nëse masat e thjeshtimit përkthehen në zvogëlim real të barrës për përdoruesit gra dhe burra. Në nivel të familjes, disa përdorues mbështeten në anëtarët e familjes ose ndërmjetësuesit për të përfunduar procedurat, veçanërisht kur aftësitë digjitale, vetëbesimi apo lëvizshmëria janë të kufizuara. Rolet gjinore mund të ndikojnë në atë se kush menaxhon dokumentacionin zyrtar dhe kontaktin institucional, gjë që mund të ndikojë në qasjen e drejtpërdrejtë të grave në shërbime, informacion dhe përfitime, megjithëse nevojiten hulumtime të mëtejshme.

## KONKLUZIONI

ZPS në kuadër të ZKM-së ka ndërmarrë përpjekje të ndërgjegjshme për të avancuar barazinë gjinore brenda ZBA-së, veçanërisht që nga miratimi i PPZBA 2025–2028. Këto përpjekje kanë pasur disa rezultate dhe ndikime të qarta drejt avancimit të barazisë gjinore. Iniciativa për të ndërmarrë këtë VNGJ ex ante sinjalizon përkushtimin e ZPS-së për avancimin e barazisë gjinore si pjesë e reformave të ardhshme dhe mund të shërbejë si praktikë e mirë për institucionet e tjera. Megjithatë, ende ekzistojnë mundësi për përmirësime. Vëmendja ndaj avancimit të barazisë gjinore ende nuk është institucionalizuar në mënyrë të qëndrueshme në ZBA, përmes sigurimit të VNBGJ-ve, objektivave të bazuara në dëshmi dhe të përgjegjshme gjinore që lidhen me ZBA, treguesve për monitorimin e zvogëlimit të barrës në mënyrë të përgjegjshme gjinore dhe BPGJ-së në përpjekjet e ZBA-së. Pavarësisht njëfarë vëmendjeje ndaj gjinisë, metodologjitë e ZBA-së nuk ofrojnë udhëzime mjaftueshëm të qarta që kërkojnë analizën e ndikimeve të mundshme mbi gratë dhe burrat e ndryshëm si përdorues. Integrimi i kufizuar i analizës së përgjegjshme gjinore në trajnimet, materialet udhëzuese dhe procedurat operative ul kapacitetin institucional për të identifikuar barrierat administrative të diferencuara dhe për të zbatuar reforma në mënyrë të qëndrueshme, të përgjegjshme gjinore dhe gjithëpërfshirëse.

Masat e thjeshtimit dhe digjitalizimit kanë reduktuar hapat proceduralë në disa fusha, duke ndikuar pozitivisht tek shumë gra dhe burra. Megjithatë, praktikat e paqëndrueshme institucionale, procedurat hibride dhe ndërveprueshmëria e paplotë vazhdojnë të gjenerojnë dorëzime të përsëritura, vizita shtesë dhe dyfishim të procedurave që kufizojnë zvogëlimin e barrës. Këto procedura administrative nuk përjetohen në mënyrë të njëjtë nga të gjithë

<sup>43</sup> Nevojiten procedura të veçanta për të siguruar sigurinë e grave. RrGK dhe Qendra Autonome e Grave kanë zhvilluar një Protokoll [*Protokoll për ofrimin e shërbimeve të këshillimit individual psikosocial përmes aplikacioneve online*, 2021] bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare, të cilin Qeveria mund ta përdorë në krijimin e shërbimeve të reja të sigurta.

<sup>44</sup> Shqipe Gjocaj, “Analizë mbi politikat gjinore të TIK dhe digjitalizimit”, 2024 (e papublikuar).

qytetarët. Dallimet në përgjegjësitë e kujdesit, frekuencën e ndërveprimit me shërbimet publike, qasjen digjitale, njohuritë dhe strukturat e mbështetjes në dispozicion formësojnë mënyrën se si gratë dhe burrat i shfletonë kërkesat administrative në praktikë. Mbledhja, publikimi dhe analiza e pamjaftueshme sistematike e të dhënave të ndara sipas gjinisë dhe ndërthurjeve të tjera mbi përdoruesit pengon monitorimin e ndikimit dhe planifikimin e përmirësimit të shërbimeve të bazuar në të dhëna. Megjithatë këto çështje janë kryesisht jashtë mandatit të ZPS-së në kuadër të ZKM-së, përmes udhëzimeve, modeleve dhe PPZBA-së së ardhshme ajo mund të inkurajojë institucionet përgjegjëse që t'i adresojnë më mirë këto çështje.

Sipas kriterëve të vlerësimit të OBZHE-së, gjetjet tregojnë se reformat e ZBA-së janë në përgjithësi relevante, pasi thjeshtimi procedural dhe digjitalizimi adresojnë barrierë reale administrative me të cilat përballen qytetarët. Megjithatë, ekzistojnë mundësi për përdorimin e VNBGJ ndërsektorial për të reflektuar më mirë nevojat dhe kufizimet e grave dhe burrave të ndryshëm. Koherenca me kornizat e BE-së dhe LBGJ mbetet e kufizuar, pasi detyrimet për barazi gjinore nuk përkthehen në mënyrë të qëndrueshme në dizajnin e programeve, metodologjitë, sistemet e monitorimit dhe praktikën e zbatimit në reformat e ZBA-së. Prandaj, efektiviteti i masave të ZBA-së është i pjesshëm: ndërsa disa shërbime janë thjeshtuar ose digjitalizuar, procedurat hibride, kërkesat për dokumentacion të përsëritur, zbatimi i pabarabartë institucional, çështjet e qasjes dhe normat gjinore mund të minojnë zvogëlimin e barrës për disa gra dhe burra. Reformat administrative kanë përmirësuar në parim efikasitetin procedural, por ndërveprueshmëria e paplotë, praktikën e vazhdueshme të verifikimit manual dhe hapat e dyfishtë administrativë nënkuptojnë se kursimet potenciale në kohë dhe kosto nuk realizohen plotësisht, duke prekur veçanërisht gratë që priren të kenë më pak qasje në burime. Ndërsa reformat e ZBA-së kanë pasur qartazi disa ndikime pozitive drejt avancimit të barazisë gjinore, sfidat mbeten. Dallimet strukturore në ekspozimin ndaj shërbimeve, përgjegjësitë e kujdesit, qasjen digjitale, njohuritë dhe praktikën institucionale nënkuptojnë se përfitimet nuk përjetohen në mënyrë të barabartë ndërmjet grave dhe burrave të ndryshëm. Qëndrueshmëria e ZBA-së së përgjegjshme gjinore do të varet nga forcimi i sistemeve të të dhënave të ndara, integrimi i analizës gjinore në metodologji dhe dizajn programor, institucionalizimi i përfshirjes së mekanizmave për barazi gjinore dhe sigurimi i monitorimit ndërsektorial dhe të ndarë sipas gjinisë të ndikimit tek përdoruesit.

## REKOMANDIMET

Rekomandimet rrjedhin nga gjetjet dhe praktikën më të mira ndërkombëtare, duke përfshirë aplikimin e Treguesit Gjinor të OBZHE-së në dizajnimin e programeve dhe VNBGJ të ABGJ-së.<sup>45</sup>

### Për PPZBA-në e ardhshme dhe Planin e Veprimit

- Referojuni në mënyrë të qartë kornizës ligjore dhe të politikave të barazisë gjinore në Kosovë, përfshirë detyrimet e LBGJ-së, duke forcuar qasjen e bazuar në të drejta për integrimin gjinor si detyrim.
- Siguroni që analiza gjinore ndërsektorale (VNBGJ) të kryhet dhe të përfshihet në programet e ardhshme, duke informuar objektivat dhe treguesit për të adresuar pabarazitë gjinore të identifikuara.
- Angazhoni ABGJ-në, ZBGJ-të, ekspertët gjinor dhe organizatat e ndryshme të grave në dizajnimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin, për të integruar më mirë vëmendjen ndaj barazisë gjinore.
- Siguroni që objektivat dhe rezultatet të synojnë avancimin e barazisë gjinore, të shoqëruara me tregues për të matur progresin (shih Shtojcën 5 për shembuj). Siguroni që

<sup>45</sup> Disa rekomandime janë bërë gjithashtu nga Gjocaj ("Analizë mbi politikën gjinore të TIK dhe digjitalizimit", 2024).

korniza e monitorimit të përfshijë tregues të ndarë sipas gjinisë, linja bazë dhe objektiva. Shmangni terminologjinë homogjene si “të cenueshëm” dhe “të marginalizuar”, pasi jo të gjitha gratë janë të cenueshme apo të marginalizuara. Në vend të kësaj, përfshini tregues më specifikë për gjininë dhe moshën, vendndodhjen rurale/urbane, përkatësinë etnike, (pa)aftësinë dhe statusin ekonomik.

- Siguroni qartësi në përgjegjësi dhe mekanizma të zbatimit për avancimin e barazisë gjinore, me role të përcaktuara qartë, udhëzime dhe burime.
- Zbatoni BPGJ-në në planin e veprimit në përputhje me detyrimet ligjore.
- Integroni përgjegjshmërinë gjinore në ZBA në zhvillimin e kapaciteteve për zyrtarët.
- Realizoni planet për të siguruar ofrimin e shërbimeve hibride (p.sh., përmes “sporteleve të shërbimeve” me shërbime të integruara dhe ofrues mobilë të shërbimeve), në mënyrë që gratë dhe burrat e ndryshëm me qasje dhe njohuri më të ulëta digjitale të mund të kapërcejnë barrierat administrative. Monitoroni përdorimin e këtyre shërbimeve duke përdorur analizë gjinore ndërsektoriale për të identifikuar ndikimet dhe pengesat e mbetura.
- Planifikoni dhe buxhetoni për ndërgjegjësim shumëdimensional të përshtatur për gratë dhe burrat e ndryshëm përmes televizionit, mediave sociale dhe në mënyrë fizike. Integroni video të shkurtra të përshtatura dhe funksionalitete të kutive të bisedës në eKosova, siç është planifikuar, për të ofruar mbështetje në kohë reale.
- Alokoni buxhet për të mbështetur financiarisht organizatat e grave, ndër të tjera, që u shërbejnë grupeve të marginalizuara për të ofruar edukim alternativ dhe mbështetje të përshtatur në përdorimin e mjeteve, duke arritur veçanërisht grupet e marginalizuara dhe të vështira për t’u arritur (p.sh., romë, ashkali, egjiptianë, persona me aftësi të kufizuara).
- Së bashku me Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, planifikoni integrimin e përdorimit të mjeteve online në kurrikulat arsimore në shkollat e mesme.
- Angazhoni komunitat për të bërë disa shërbime të disponueshme me orar më të gjatë pune të paktën një herë në javë dhe të shtunave, për të përshtatur më mirë oraret e punës së qytetarëve të ndryshëm.
- Vazhdoni t’i jepni prioritet digjitalizimit dhe thjeshtimit të shërbimeve me frekuencën më të lartë të ndërveprimit me qytetarët dhe barrën më të madhe administrative, duke përfshirë, bazuar në kërkesat e grave dhe burrave: (1) zgjerimin dhe shtrirjen e procedurave të ngjarjeve jetësore, duke përfshirë ato që lidhen me lindjen, vdekjen (përmes reformave në vazhdim të mbështetura nga Banka Botërore), trashëgiminë dhe përfitimet përkatëse; (2) asistencën sociale dhe shërbimet sociale, veçanërisht (ri)kualifikimin online për pensionet e pleqërisë, certifikimin e aftësisë së kufizuar dhe shërbimet përkatëse (p.sh., përmes përdorimit të videove live); (3) shërbimet e lidhura me shëndetin;<sup>46</sup> dhe (4) punësimin.
- Konsideroni lidhjen e certifikatave të vdekjes, trashëgimisë dhe agjencisë kadastrale përmes një sistemi të ndërveprueshëm, duke mundësuar njoftimin automatik të të gjithë trashëgimtarëve për të drejtat dhe përgjegjësitë pas vdekjes së një anëtar të familjes. Kjo mund të kontribuojë në qasje më të barabartë të grave në trashëgimi, përfshirë pronën, duke adresuar një pabarazi të madhe gjinore. Siguroni që dizajnimi të përfshijë analizë gjinore, duke përfshirë rreziqet e mundshme.
- Bashkëpunoni me policinë dhe gjykatat për të mundësuar aplikimet për urdhra mbrojtjeje online, me qëllim mbrojtjen e personave që përjetojnë dhunë me bazë gjinore, veçanërisht grave, të cilat mund të jenë të izoluara dhe të përballen me sfida sigurie gjatë aplikimit.
- Bashkëpunoni me Agjencinë për Ndihmë Juridike, duke përdorur shembuj dhe mësim të nxjerra nga [shërbimet falas juridike të Institutit të Kosovës për Drejtësi](#) dhe [Grupit për Studime Juridike dhe Politike](#), për të krijuar sisteme të sigurta për aplikim për ndihmë juridike.
- Planifikoni për përmirësimin e qasshmërisë duke siguruar formate të qasshme (tekst, audio, video, gjuhë të shenjave).

---

<sup>46</sup> Ndër pjesëmarrësit në anketë, shumica kërkuan shërbime më të mira shëndetësore online, veçanërisht gratë.

- Parashihni buxhet për vlerësime periodike të nevojave dhe anketa të përdoruesve për të matur ndikimet. Institucionalizoni anketa të rregullta në nivel të Kosovës për ekonomitë familjare për të mbledhur të dhëna specifike mbi digjitalizimin dhe përdorimin e ZBA-së, duke përfshirë të dhëna të ndara sipas gjinisë dhe ndërthurjeve të tjera mbi përdorimin, qasjen dhe pushtetin, veçanërisht në lidhje me treguesit e propozuar (Shtojca 5).
- Konsideroni përfshirjen e veprimeve specifike nga seksionet në vijim në PPZBA, sipas relevancës.

## **Për modelin dhe listat e kontrollit**

*Rekomandimet në vijim mund të japin informacion modelin dhe listat e kontrollit për institucionet e tjera, veçanërisht pasi jo të gjitha janë nën mandatin e ZPS-së në kuadër të ZKM-së. Shtojcat 9-11 përmbajnë rekomandime specifike.*

- Kërkoni që VNBGJ e detyrueshme të kryhet për të gjitha koncept dokumentet; realizoni analizë gjinore ndërsektoriale për përfshirjen digjitale në fillim të çdo iniciative të ZBA-së.
- Siguroni që grupet punuese që zhvillojnë koncept dokumente dhe politika të përfshijnë ABGJ-në, ZBGJ-të dhe ekspertë gjinorë.
- Siguroni konsultim me ABGJ-në dhe rishikim për sigurimin e cilësisë, veçanërisht për VNBGJ-të, duke përfshirë adresimin e të dhënave të ABGJ-së.
- Siguroni që legjislacioni të njohë ndërprerjet në karrierë dhe punën me honorar për gratë me përgjegjësi kujdesi dhe pushimin e lehonisë, duke përfshirë regjimet e licencimit.
- Siguroni që gjuha e ndjeshme gjinore të zbatohet në mënyrë sistematike në të gjitha ligjet dhe politikat, pasi gjuha e anshme gjinore mund të përforcojë normat gjinore në shërbimet e lidhura me ZBA-në, duke ndikuar në përdorim.
- Garantoni balancë gjinore (50% gra dhe 50% burra) në të gjitha bordet, organet, komisionet dhe strukturat e qeverisjes në përputhje me kërkesat e LBGJ-së, gjë që mund të ndikojë në pjesëmarrjen e grave dhe burrave në lidhje me ZBA-në dhe reformat e tjera ligjore dhe të politikave.
- Urdhëroni mbledhjen, mirëmbajtjen dhe raportimin e të dhënave mbi shërbimet, aplikuesit dhe përfituesit përmes sistemeve të ndërveprueshme, duke i ndarë të dhënat sipas gjinisë dhe moshës, përkatësisë etnike, aftësisë së kufizuar dhe vendndodhjes rurale/urbane. Të dhënat e tilla duhet të mblidhen duke përdorur parimin “vetëm një herë”, si p.sh. përmes detyrimit të përdorimit të llogarive në eKosova gjatë procesit të regjistrimit, duke siguruar këto të dhëna pa u kërkuar aplikuesve t’i dorëzojnë sërish ato.
- Siguroni ndërveprueshmëri me ASK-në dhe publikim në kohë reale të të dhënave, duke përfshirë ndërlidhjen me platformat e të dhënave të hapura, në përputhje me detyrimet e LBGJ-së.
- Siguroni zbatimin e parimit “vetëm një herë” dhe ndërveprueshmërinë ndërmjet shërbimeve.
- Siguroni që opsionet hibride dhe me prezencë fizike për aplikim të mbeten të disponueshme, duke përfshirë plotësimin e asistuar të formularëve online me mbrojtje të fjalëkalimeve dhe masa të sigurisë së të dhënave.
- Ndryshoni Ligjin për Noterinë për të futur mekanizma të noterizimit online për të reduktuar kohën, kostot e udhëtimit dhe pengesat që prekin veçanërisht gratë, banorët ruralë, personat me aftësi të kufizuara dhe komunitetet pakicë.
- Inkurajoni shqyrtimin e tarifave përkatëse nga perspektiva gjinore. Konsideroni masa afirmative për të hequr tarifat në drejtim të avancimit të barazisë gjinore në sektorët ku një gjini është e nënpërfaqësuar, në përputhje me LBGJ-në.

## **Për materialet për ndërtimin e kapaciteteve**

- Siguroni që materialet e trajnimit të integrojnë në mënyrë sistematike analizën gjinore të barrës administrative duke adresuar barrierat shtesë me të cilat mund të përballen gratë dhe burrat e ndryshëm, duke përfshirë kërkesat për transport, tarifat e shërbimeve, afatet

procedurale, aftësitë digjitale, pengesat gjuhësore, nevojat e qasshmërisë të lidhura me aftësinë e kufizuar dhe përgjegjësitë e kujdesit. Materialet duhet të shpjegojnë se si këta faktorë ndikojnë në qasjen në shërbime dhe të ofrojnë shembuj praktikë se si procedurat që duken neutrale mund të gjenerojnë ndikime të pabarabarta në praktikë.

- Integroni barrierat shtesë reale në ushtrimet praktike, duke kërkuar nga pjesëmarrësit të analizojnë se si faktorë si distanca e transportit, përgjegjësitë për kujdesin ndaj fëmijëve, aftësitë e kufizuara digjitale, pengesat gjuhësore, nevojat e qasshmërisë të lidhura me aftësinë e kufizuar, tarifat e shërbimeve dhe kërkesat e përsëritura për dokumentacion ndikojnë në aftësinë e përdoruesve të ndryshëm për të përfunduar procedurat administrative. Ushtrimet duhet të kërkojnë nga pjesëmarrësit të identifikojnë se ku këto barrierat krijojnë barrë administrative të pabarabartë dhe të propozojnë zgjidhje procedurale ose digjitale për t'i reduktuar ato.
- Forconi integrimin e parimeve të VNBGGJ-së në modulet e trajnimit duke udhëzuar zyrtarët të vlerësojnë se kush e përdor një shërbim, kush e përfundon atë në mënyrë të pavarur, ku përdoruesit ndërpresin procesin dhe cilat grupe kërkojnë vizita shtesë, ndihmë apo dokumentacion. Ushtrimet duhet të kërkojnë në mënyrë eksplicite nga pjesëmarrësit të identifikojnë rrugët e diferencuara të përdoruesve dhe barrat e mundshme të pabarabarta para se të propozojnë masa thjeshtimi.
- Zgjeroni ushtrimet praktike për të përfshirë simulime të udhëtimeve të përdoruesve për profile të ndryshme (p.sh.: grua rurale, përdorues i moshuar, person me aftësi të kufizuara, folës i gjuhëve të pakicave, pronar i biznesit të vogël apo kujdestar me kohë të kufizuar). Pjesëmarrësit duhet të llogarisin barrën administrative në aspektin e kohës, udhëtimit, numrit të hapave, kostove indirekte dhe mbështetjes të ndërmjetësit, duke propozuar rregullime për të zvogëluar ndikimet e pabarabarta.
- Përfshini udhëzime për mbledhjen dhe interpretimin e të dhënave të ndara sipas gjinisë dhe reagimeve të përdoruesve si pjesë e monitorimit të ZBA-së. Trajnimi duhet të demonstrojë se si regjistrat e ankesave, kërkesat për ndihmë, normat e përfundimit të shërbimeve dhe anketat e përdoruesve mund të analizohen për të identifikuar barrierat e qasjes të lidhura me gjininë dhe për të informuar ridizajnimin e shërbimeve.
- Siguroni që materialet të sqarojnë rolet institucionale të ZBGJ-ve dhe ABGJ-së në shqyrtimin e projektligjeve dhe procedurave, pjesëmarrjen në grupet punuese dhe mbështetjen në identifikimin e rreziqeve të lidhura me gjininë gjatë dizajnit dhe zbatimit të reformave.
- Ofroni mentorim dhe mbështetje të specializuar për ZBGJ-të për të avancuar kapacitetet e tyre në këshillimin për reformat. Parashihni buxhet për ekspertë për të mbështetur reformat e përgjegjshme gjinore.

### **Për ZPS në kuadër të ZKM-së**

- Siguroni përmes sigurimit të cilësisë që organet përgjegjëse qeveritare të konsultojnë gratë dhe burrat e ndryshëm, organizatat e grave, ZBGJ-të dhe ABGJ-në gjatë hartimit të ligjeve, politikave dhe programeve, duke institucionalizuar konsultimet si të detyrueshme si pjesë e proceseve të dizajnit.
- Përmirësoni sistemet e monitorimit për të përkthyer më mirë analizën gjinore në informimin e reformave.
- 

### **Për Zyrën Kombëtare të Auditimit**

- Përfshini në auditimin e ardhshëm të RAP-it, si dhe në auditimet e ardhshme, tregues që lidhen me ndikimet në barazinë gjinore, në koordinim të ngushtë me ZPS në kuadër të ZKM-së dhe ABGJ-në.

# SHTOJCAT

## Shtojca 1. Metodologjia

Metodologjia e plotë është në dispozicion sipas kërkesës nga ZPS në kuadër të ZKM-së. Duke pasur parasysh gjatësinë e saj, ajo është ofruar si një shtojcë e veçantë e jashtme.

## Shtojca 2. Analiza gjinore e programeve të Kosovës për zvogëlimin e barrës administrative

Kjo shtojcë ofron një analizë më të thelluar të PPZBA-ve të Kosovës për periudhat 2022–2027 dhe 2025–2028, përkatësisht nga një perspektivë gjinore, me qëllim identifikimin e mundësive për përmirësimin e PPZBA-së së ardhshme dhe planeve të ardhshme të veprimit. Analiza gjinore përfshiu vlerësimin e shkallës në të cilën secili program ka njohur dhe adresuar nevojat e ndryshme dhe ndikimet e mundshme mbi gratë dhe burrat e ndryshëm në qasjen në shërbimet administrative.

### ABPRP 2022-2027

PPZBA 2022–2027 përmban vetëm referenca minimale të drejtpërdrejta ndaj gjinisë.<sup>47</sup> Në seksionin mbi prioritetet, Programi thekson se, gjatë thjeshtimit dhe digjitalizimit të shërbimeve, “prioritet do t’u jepet atyre shërbimeve të cilat, bazuar në analizë, rezultojnë të përdoren më shumë nga gratë dhe grupet e cenushme.” Strategjia i referohet përfshirjes dhe mundësive të barabarta në terma të përgjithshëm. Megjithatë, ajo nuk analizon përdorimin e shërbimeve sipas gjinisë dhe as nuk priorizon reformat bazuar në nevojat specifike administrative të grave. Barazia gjinore përmendet vetëm në nivel parimor dhe nuk është e integruar në mënyrë sistematike. Programi nuk e integron në mënyrë sistematike dimensionin gjinor në objektivat apo parimet e tij. Asnjë objektivi apo parim gjithëpërfshirës nuk adreson barazinë gjinore apo qasjen gjithëpërfshirëse. Gjinia nuk përmendet në qëllimet kryesore. “Gjinia” apo “gratë” në masë të madhe mungojnë në narrativë (përveç rastit të vetëm të përmendur më sipër). Parimet udhëzuese të Programit (parimet e qeverisjes elektronike si “orientimi drejt përdoruesit”, “digjitalizimi në radhë të parë”, etj.) janë të formuluar në terma gjinorë neutralë, pa referencë eksplicite ndaj gjinisë apo diversitetit. Kështu që, barazia gjinore trajtohet si një konsideratë anësore dhe jo si një element thelbësor i dizajnit të programit. Përfshirja e grave në një fushë me prioritet, “Gjithëpërfshirja”, përbën një referencë të shkurtër dhe jo një integrim të plotë të perspektivës gjinore në dizajnin e programit.

Duke qenë se përmendja eksplicite e barazisë gjinore është e kufizuar, thellësia e integritit gjinor në këtë program është e kufizuar. Për shembull, korniza e monitorimit dhe vlerësimin të programit nuk përfshin tregues të ndarë sipas gjinisë apo metrika të përgjegjshme gjinore. Treguesit fokusohen në rezultate të përgjithshme si numri i shërbimeve të thjeshtuara, kursimet në kohë/kosto dhe kënaqshmëria e përgjithshme e përdoruesve, pa ndonjë kërkesë për të ndjekur dallimet ndërmjet grave dhe burrave, apo ndërmjet grave dhe burrave nga grupe specifike (p.sh., sipas moshës, aftësisë së kufizuar, përkatësisë etnike apo vendndodhjes rurale/urbane). Objektivat për ndërgjegjësimin dhe kënaqshmërinë e qytetarëve nuk përfshijnë ndarje gjinore. Po ashtu, nuk ka indikacione për BPGJ apo alokim të burimeve për të adresuar nevoja specifike gjinore. Përpjekjet për ndërtimin e kapaciteteve në kuadër të programit (trajnimi i zyrtarëve publikë për zvogëlimin e barrës) përkrahohen në terma të përgjithshëm, pa referencë për ndërtimin e kapaciteteve në lidhje me barazinë gjinore në ZBA apo sigurimin e një balance gjinore ndërmjet pjesëmarrësve. Perspektiva gjinore, aty ku ekziston, trajtohet më shumë si një detaj zbatimi (zgjedhja e disa shërbimeve për digjitalizim) sesa si një qasje transformuese.

<sup>47</sup> Republika e Kosovës, Qeveria, ZKM, [Programi për Parandalimin dhe Reduktimin e Barrës Administrative 2022-2027](#), 2022.

Në një rast, trajtohet një barrë specifike gjinore: Plani i Veprimit përfshin një masë për të eliminuar kërkesën për certifikatën e martesës (për gratë e martuara) që nuk duhet të jetë më e vjetër se gjashtë muaj në disa procedura. Ky është një hap i rëndësishëm, pasi heq një barrë të panevojshme që prekte vetëm gratë (gratë e martuara duhej të dëshmonin vazhdimisht statusin e tyre martesor). Përveç kësaj mase, çështje të tjera potencialisht të ndërlidhura me gjininë (si kërkesat për dokumente të pronësisë që shpesh i disfavorizojnë gratë apo dokumentacioni për kujdesin ndaj fëmijëve që prek nënat vetushqyese) nuk diskutohen në mënyrë eksplicite. Programi i ka përfshirë gratë në kategorinë e “grupeve të cenueshme” pa nuancë, gjë që mund të errësojë nevojat specifike të grave krahasuar me popullatat e cenueshme, veçanërisht pasi jo të gjitha gratë janë të cenueshme.

Programi 2022–2027 synon sjellë përfitime për “qytetarët dhe bizneset” në përgjithësi, por pa masa të synuara, disa grupe mund të mbeten pas. Duke i dhënë përparësi shërbimeve publike digjitale (“parimi digjital në radhë të parë”) dhe efikasitetit, programi supozon se përdoruesit mund të qasen lehtësisht në shërbimet elektronike. Kjo mund të favorizojë në mënyrë të pavullnetshme burrat dhe popullsinë urbane nëse, për shembull, burrat kanë më shumë gjasa të posedojnë pajisje digjitale apo të kenë kohë të lirë për të shfletuar sistemet e reja, ndërsa gratë, veçanërisht gratë e moshuara apo ato në zonat rurale, mund të përballen me barriera teknologjike. Programi nuk përmend në mënyrë eksplicite gratë rurale, prindërit e vetëm, personat me aftësi të kufizuara apo komunitetet pakicë. Për shembull, një grua rurale apo një pensioniste e moshuar me lëvizshmëri të kufizuar mund të ketë vështirësi në udhëtimin drejt zyrave qeveritare, duke bërë që procedurat me prezencë fizike të kenë kosto disproporcionale në kohë për to. Përmirësimet e përgjithshme të Programit (si reduktimi i numrit të dokumenteve apo vizitave të kërkuara) sigurisht që do të sjellin përfitime për këto grupe, por mungesa e ndërgjegjësimit të synuar nënkupton se ato mund të mos kenë qasje në këto shërbime.

Vetë Programi nuk artikulon se si barrat administrative ndikojnë ndryshe tek gratë dhe burrat në analizën e tij. Megjithatë, këto dallime janë të dokumentuara mirë në analizat gjinore të qeverisjes. Gratë shpesh përjetojnë varfëri kohore për shkak të përgjegjësisë të papaguara të kujdesit, kështu që proceset e gjata burokratike apo pritja në radhë paraqesin kosto më të larta për to.<sup>48</sup> Në mënyrë të ngjashme, kufizimet në lëvizshmëri (mungesa e qasjes në automjet apo transport publik të sigurt) nënkuptojnë se kërkesat për dorëzim fizik të formularëve mund të jenë më sfiduese për gratë (veçanërisht në zonat rurale) dhe për të moshuarit.<sup>49</sup> Digjitalizimi mund të ndihmojë në zbutjen e këtyre çështjeve duke mundësuar qasje në distancë; në të vërtetë, Programi thekson qasjen shumëkanalëshe në shërbime, duke vënë në dukje se mbështetja telefonike është “shumë e dobishme për të moshuarit dhe grupet e marginalizuara”, ndërsa mediat sociale përdoren më shumë nga të rinjtë. Kjo tregon njëfarë vetëdijeje për hendekun digjital. Megjithatë, gratë nuk konsiderohen në mënyrë eksplicite, por vetëm nënkuptohen në kuadër të “të marginalizuarve”. Në Kosovë, si edhe gjetkë, gratë (veçanërisht gratë e moshuara apo ato në komunitete tradicionale) mund të kenë aftësi më të ulëta digjitale, duke e bërë qasjen “digjitale në radhë të parë” një pengesë potenciale. Programi nuk përmend pengesa dokumentare si fakti që pronat apo bizneset zakonisht regjistrohen në emër të burrave, një çështje që mund ta bëjë më të vështirë për gratë mbledhjen e dokumenteve të kërkuara. Duke mos i diskutuar në mënyrë eksplicite këto dimensione gjinore, programi rrezikon të anashkalojë mënyrat se si reformat mund të kenë nevojë të përshtaten për të siguruar që gratë të përfitojnë në mënyrë të barabartë.

### **Konkluzioni: Çështjet kryesore lidhur Programin 2022-2027**

- Nuk ka indikacione që një analizë gjinore ka informuar zhvillimin apo përcaktimin e prioriteteve të Programit. Kjo krijon rrezikun që reformat të jenë neutrale ndaj gjinisë dhe të dështojnë në adresimin e barrierave specifike me të cilat përballen gratë, si varfëria kohore apo qasja më e ulët në informacion.

<sup>48</sup> RrGK, [Barazia Gjinore: Në qendër të TI-së...dhe përtej](#), 2024.

<sup>49</sup> Po aty.

- Megjithëse Programi i referohet në mënyrë të përgjithshme “grupeve të cenueshme”, ai nuk identifikon apo adreson nevojat specifike të grupeve si gratë me aftësi të kufizuara, gratë nga komunitetet pakicë apo prindërit vetëushqyes. Pa masa të synuara, barrierat administrative të ndërthurura për këto grupe ka të ngjarë të vazhdojnë.
- Vëmendja ndaj avancimit të barazisë gjinore përmes ZBA-së nuk është e integruar qartë në rezultatet e ZBA-së. Kjo e anashkalon konsideratën gjinore dhe rrit rrezikun që ajo të neglizhohet gjatë zbatimit dhe monitorimit.
- Korniza e monitorimit nuk përfshin tregues të ndarë sipas gjinisë, linja bazë apo objektiva, duke i trajtuar qytetarët dhe bizneset si një grup të vetëm, gjinor neutral. Si rezultat, Programi nuk mund të masë nëse ZBA përfiton gratë dhe burrat në mënyrë të barabartë apo nëse redukton pabarazitë ekzistuese gjinore.
- Programi nuk i cakton asnjë rol institucioneve për barazi gjinore, organizatave të grave apo ekspertëve të gjinisë në qeverisje, konsultim apo mbikëqyrje. Kjo kufizon kontributin e strukturuar drejt avancimit të barazisë gjinore gjatë proceseve të dizajnit të politikave, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit.
- Programi nuk përdor BPGJ, nuk alokon burime për masa gjithëpërfshirëse gjinore dhe nuk kërkon ndërtim të kapaciteteve të përgjegjshme gjinore për zyrtarët publikë. Kjo dobëson zbatimin, pasi zyrtarëve u mungojnë udhëzimet dhe aftësitë për të identifikuar dhe adresuar dallimet gjinore në përdorimin dhe qasjen në shërbime.

## PPZBA 2025-2028

PPZBA 2025-2028 më i fundit tregon një përmirësim të dukshëm në integrimin e perspektivës gjinore. Në fillim të dokumentit, ai e njeh sfidën e “pabarazisë gjinore” në Programin e mëparshëm, duke theksuar pjesëmarrjen e ulët të grave në programet e trajnimit të ZBA-së, veçanërisht në nivel lokal. Kjo njeh faktin se gratë nuk kanë përfituar në mënyrë të barabartë nga ndërtimi i kapaciteteve të zyrtarëve publikë. Programi 2025-2028 gjithashtu ndërtohet mbi konceptin e dizajnit gjithëpërfshirës të shërbimeve. Në seksionin mbi përfshirjen e përdoruesve, ai thekson në mënyrë eksplicite se zhvillimi i politikave do të përfshijë analiza të detajuara të demografisë së përdoruesve “si gjinia, përkatësia etnike, moshë dhe nivelet e aftësive digjitale”, në mënyrë që grupet e synuara të prekura nga reformat të identifikohen dhe të konsultohen. Kjo nënkupton se gjatë dizajnit të shërbimeve të reja ose thjeshtimit të procedurave, qeveria angazhohet të marrë parasysh dallimet ndërmjet përdoruesve gra dhe burra, komuniteteve shumicë/pakicë, grupeve të ndryshme të moshës, etj. Për më tepër, Programi prezanton objektiva të ndara sipas gjinisë dhe “grupeve të cenueshme” në kornizën e tij të rezultateve që lidhen me shërbimet e thjeshtuara dhe të digjitalizuara. Për shembull, nëse deri në vitin 2028 thjeshtohen 150 shërbime, Programi synon të masë se si këto thjeshtime ndikojnë tek gratë dhe grupet e cenueshme (duke nënkuptuar gjurmimin e përdorimit ose përfitimit sipas grupeve demografike). Gjithashtu, Programi prezanton referenca ndaj treguesve të ndarë sipas gjinisë dhe grupeve të cenueshme në kornizën e tij të rezultateve. Ky është një hap i rëndësishëm drejt integritit të barazisë gjinore: ai përfshin idenë se suksesi nuk matet vetëm me numrin e shërbimeve të thjeshtuara, por edhe me sigurimin që këto reforma arrijnë te grupe të ndryshme. Kështu, krahasuar me programin paraprak, Programi 2025-2028 përfshin më drejtpërdrejt dhe më shpesh konsideratat gjinore, që nga diagnostikimi i problemit (hendeku gjinor në trajnim), te planifikimi (konsultimi gjithëpërfshirës) dhe deri te monitorimi (treguesit e ndarë).

Gjinia përmendet në kontekste substanciale si ndërtimi i kapaciteteve, dizajnimi i orientuar drejt përdoruesit dhe matja e performancës. Programi e trajton përfshirjen si pjesë të qasjes së tij thelbësore të orientuar drejt përdoruesit. Për shembull, strategjia për përfshirjen e përdoruesve kërkon një angazhim të vazhdueshëm për të përfshirë përdoruesit dhe madje edhe “strategjitë e avancuara të përfshirjes”, duke siguruar që zërat e grave dhe grupeve të tjera të dëgjohen gjatë gjithë dizajnit të shërbimeve. Kjo tregon se gjinia merret në konsideratë gjatë fazës së dizajnit të shërbimeve administrative (jo vetëm gjatë vlerësimit të rezultateve). Prania e treguesve të ndarë sipas gjinisë është veçanërisht e rëndësishme: ajo vendos një nivel llogaridhënieje për arritjen e grave dhe grupeve të cenueshme. Duke

premtuar matjen e rezultateve sipas gjinisë, Programi krijon presion për zbatimin e reformave në mënyrë të barabartë.

Megjithëse këta hapa janë progresivë, gjinia ende trajtohet kryesisht nën ombrellën e “grupeve të cenueshme” ose “demografisë” dhe jo si një prioritet në vetë. Ky formulim është problematik, pasi gratë nuk përbëjnë një grup të cenueshëm në vetvete, por përfaqësojnë gjysmën e popullsisë. Ekzistojnë dallime ndërmjet grave. Pabarazitë gjinore burojnë nga faktorë strukturorë që ndikojnë në qasje, pjesëmarrje dhe rezultate në të gjitha shërbimet administrative. Megjithatë, qëllimi kryesor i Programit është i formuluar në terma të përgjithshëm (shërbime efikase dhe të orientuara drejt përdoruesit për të gjithë), dhe nuk ekziston një seksion i dedikuar për barazinë gjinore. Prandaj, megjithëse i përmirësuar, barazia gjinore mund të përshkruhet si e integruar, por jo plotësisht e synuar.

Hartuesit duket se kanë synuar një qasje gjithëpërfshirëse. Për shembull, ata planifikojnë të përshtatin trajnimet dhe konsultimet për t'i bërë ato më gjithëpërfshirëse. Megjithatë, dokumenti nuk detajon saktësisht se si do të rritet pjesëmarrja e grave në trajnim. Integrimi gjinor trajtohet si një konsideratë e rëndësishme zbatimi dhe pjesë e dizajnit cilësor të shërbimeve, por jo si një **objektiv qendror** në vetvete. Mungesa e objektivave të qarta drejt barazisë gjinore mund të pengojë monitorimin e progresit.

Programi synon të zgjerojë përfituesit e ZBA-së për të siguruar që askush të mos mbetet pas. Theksi i tij në decentralizim dhe fuqizim të palëve të interesit sugjeron përfitime për nivelet lokale dhe potencialisht për qytetarët jashtë kryeqytetit. Gratë, në veçanti, pritet të përfitojnë nga thjeshtimi dhe digjitalizimi i vazhdueshëm i shërbimeve: kursimet në kohë dhe kosto janë të parashikuara (një objektiv prej >50% kursim kohe deri në vitin 2026), gjë që do të ndihmojë ata me përgjegjësi kujdesi ose burime të kufizuara, shumë prej të cilëve janë gra. Fokusi i Programit në ofrimin e shërbimeve të orientuara drejt përdoruesit nënkupton që shërbimet duhet të dizajnohen rreth nevojave reale të përdoruesve; duke qenë se ai përfshin në mënyrë eksplicite gjininë në hulumtimin e përdoruesve, nevojat e grave kanë më shumë gjasa të adresohen sesa më parë. Për shembull, nëse gratë sipërmarrëse apo gratë rurale konsultohen, shërbimi që rezulton mund të jetë më i thjeshtë (më pak udhëtime, më pak dokumentacion) dhe më i qasshëm (i përshtatshëm për telefon mobil, në gjuhë lokale) për to. Megjithatë, disa grupe mund të rrezikojnë ende përjashtimin nëse zbatimi nuk është i mjaftueshëm. Dokumenti nuk përmend në mënyrë eksplicite personat me aftësi të kufizuara, prindërit e vetëm apo gratë e moshuara si kategori të veçanta, por i grupon ato nën “të cenueshëm” ose sipas moshës. Nëse nuk synohen me kujdes, kjo mund të nënkuptojë se disa nevoja (si shërbimet digjitale të qasshme për persona me aftësi të kufizuara apo mbështetja për kujdesin ndaj fëmijëve gjatë trajnimeve ose takimeve publike) mund të neglizhohen. Njohja e niveleve të aftësive digjitale është e rëndësishme; ajo nënkupton që Programi do të marrë parasysh personat që nuk janë të aftë në teknologji (shpesh individë të moshuar, një grup që përfshin shumë gra dhe burra të moshuar). Duke planifikuar strategji “shumëkanalëshe” në mbështetjen e përdoruesve (siç duket se mësimet nga programi i mëparshëm vazhdojnë të aplikohen), ka më shumë gjasa që të përfitojë një bazë më e gjerë përdoruesish.<sup>50</sup> Megjithatë, nëse qasja “digjitale në radhë të parë” mbetet dominante, ata pa qasje në internet apo aftësi (në mënyrë disproporcionale gratë e moshuara, gratë rurale dhe grupet me të ardhura të ulëta) kanë nevojë për alternativa të vazhdueshme.

Si përfundim, përfituesit e synuar të reformave 2025-2028 janë të gjithë qytetarët dhe bizneset, me një synim më të qartë për të siguruar që gratë, pakicat dhe të tjerët të përfitojnë. Masat e Programit (nëse zbatohen), si konsultimet e synuara dhe monitorimi i ndarë sipas grupeve, duhet të zvogëlojnë rrezikun e përjashtimit. Megjithatë, suksesi do të varet nga zbatimi praktik, për shembull zhvillimi i takimeve të synuara me organizatat e grave apo përshtatja e shërbimeve kur identifikohen hendeqet gjinore. Gratë që mund të përfitojnë më së shumti përfshijnë nënat që punojnë (përmes kursimit të kohës), gratë sipërmarrëse (përmes procedurave më të lehta të biznesit) dhe gratë rurale (përmes qasjes digjitale që eliminon

<sup>50</sup> Shumëkanalëshe i referohet ofrimit të shërbimeve publike dhe mbështetjes për përdoruesit përmes kanaleve të shumta të integruara të qasjes, siç janë portalet online, aplikacionet mobile, qendrat e thirrjeve, sportelet fizike dhe emaili, duke ua mundësuar përdoruesve të zgjedhin opsionin më të qasshëm.

nevojën për udhëtim). Ato që mund të mbeten ende jashtë përfshijnë gratë me qasje shumë të ulët digjitale ose ato që nuk arrihen përmes kanaleve standarde të komunikimit, përveç nëse bëhet ndërgjegjësimit i veçantë (p.sh., rome, ashkali, egjiptiane, gra të moshuara dhe gra me aftësi të kufizuara).

Programi fillon të adresojë disa aspekte gjinore të barrës administrative, megjithëse shpesh në mënyrë indirekte. Duke njohur pjesëmarrjen e ulët të mëparshme të grave zyrtare në trajnim, ai prek një çështje klasike gjinore në administratën publike: gratë priren të jenë të nënpërfaqësuar në role apo trajnime të caktuara profesionale, ndoshta për shkak të faktorëve si përfaqësimi më i ulët në pozita udhëheqëse ose kufizimet si përgjegjësitë familjare që e bëjnë të vështirë pjesëmarrjen në trajnime. Programi e evidenton këtë problem, duke nënkuptuar nevojën për zgjidhje (si modalitete më të qasshme të trajnimit, të cilat planifikohen përmes moduleve online). Sa i përket mënyrës se si barrat ndikojnë ndryshe tek gratë dhe burrat: teksti vetë ende nuk jep shembuj të drejtpërdrejtë si “gratë kanë më pak kohë” apo “dokumentet e pronës janë në emër të burrave”, por përfshin zgjidhjen duke insistuar në hulumtim të përdoruesve dhe bashkë-dizajnim me përdorues të ndryshëm. Kjo nënkupton se çështje si varfëria kohore apo kufizimet në lëvizshmëri duhet të dalin natyrshëm gjatë angazhimit me përdoruesit realë. Për shembull, përmes hulumtimit me grupe të fokusit, qeveria mund të mësojë se gratë e kanë të vështirë të paraqiten fizikisht për të finalizuar dokumentet për shkak të përgjegjësisë të kujdesit – dhe më pas të përshtatë shërbimet duke mundësuar dorëzim online ose duke zgjatur orarin e shërbimeve. Shtytja e vazhdueshme e Programit drejt digjitalizimit, e shoqëruar me dizajn të orientuar drejt përdoruesit, mund të lehtësojë barrat gjinore si koha e shpenzuar (automatizimi redukton pritjen), lëvizshmëria (shërbimet online kursejnë udhëtimet) dhe kostoja e mundësisë (procedurat më të thjeshta nënkuptojnë më pak mungesë nga puna – e rëndësishme për gratë që mund të jenë në punë me paga më të ulëta dhe fleksibilitet më të kufizuar). Megjithatë, sa i përket hendekut digjital, Programi njeh nivelet e ndryshme të aftësive digjitale, por nuk përmend në mënyrë eksplicite dallimet gjinore në qasjen digjitale. Në Kosovë, nëse gratë (veçanërisht ato më të moshuara apo në disa komunitete rurale) kanë norma më të ulëta të përdorimit të internetit, sukcesi i shërbimeve elektronike për to do të varet nga trajnimet apo alternativat e ofruara. Gjithashtu, nuk ka përmendje specifike për përshtatjen e kërkesave ligjore që mund të kenë paragjykim gjinor (përveç vazhdimet të thjeshtimit të përgjithshëm). Heqja e kërkesës për certifikatën e martesës në planin e mëparshëm të veprimit supozohet të vazhdojë, por pengesa të reja specifike gjinore mund të ekzistojnë në fusha të tjera. Dokumenti nuk i liston ato. Një element i ri është aplikimi i teknikave të avancuara të përfshirjes së përdoruesve si “vlerësimi i fshehtë i shërbimeve” dhe përcaktimi i udhëtimit të përdoruesit. Këto mund të zbulojnë pengesa të fshehta, duke përfshirë ato që prekin veçanërisht gratë. Për shembull, ushtrimi “vlerësuesi i fshehtë i shërbimeve” mund të tregojë se një nënë vetushqyese e ka të ndërlikuar të përfitojë një ndihmë sociale për shkak të shumë hapave, duke orientuar kështu thjeshtimin e procedurës. Në përmbledhje, ndonëse Programi 2025-2028 nuk e shpreh në mënyrë eksplicite se “gratë përballen me X barrë dhe ne do ta zgjidhim me Y”, ai krijon korniza (të dhëna të ndara sipas gjinisë, hulumtim të përdoruesve sipas gjinisë, etj.) që mundësojnë identifikimin dhe adresimin e barrave gjinore gjatë zbatimit. Kjo përfaqëson një qasje më proaktive sesa Programi i mëparshëm, duke iu afuar trajtimit të gjinisë si pjesë thelbësore e reformës së orientuar drejt përdoruesit, dhe jo si një element dytësor.

Nga perspektiva e monitorimit, Programi përfshin tregues të rezultateve dalëse që lidhen me numrin e shërbimeve të thjeshtuara dhe të digjitalizuara, duke iu referuar ndarjes sipas gjinisë dhe grupeve të cenushme. Megjithatë, ai nuk prezanton tregues specifikë të rezultateve përfundimtare gjinore që do të mundësonin vlerësimin nëse reformat reduktojnë barrierat administrative në mënyrë të ndryshme për gratë dhe burrat. Programi nuk specifikon se cilat të dhëna do të ndahen, si do të mblidhen ato, apo nëse kjo i referohet përdorimit të shërbimeve, përfituesve apo ndikimeve. Gjithashtu, Programi nuk zbaton parimet e BPGJ-së; alokimet financiare nuk analizohen në aspektin e ndikimit të tyre të diferencuar tek gratë dhe burrat. Po ashtu, nuk parashihen burime të dedikuara për të adresuar barrierat specifike gjinore në qasje. Si rezultat, si korniza e treguesve ashtu edhe qasja buxhetore mbeten kryesisht gjinore neutrale.

### **Konkluzioni: Çështjet kryesore lidhur me PPZBA 2025-2028**

- Programi njeh pjesëmarrjen e ulët të grave në trajnim, por nuk përcakton masa konkrete, objektiva apo stimuj për të rritur përfshirjen e grave. Pa veprime specifike ose tregues matës, aktivitetet e ndërtimit të kapaciteteve rrezikojnë të mbeten të dominuara nga burrat, veçanërisht në nivel lokal.
- Megjithëse përmenden gjinia, mosha dhe përkatësia etnike, Programi vazhdon të përdorë referenca të përgjithshme ndaj “grupeve të cenueshme” pa i identifikuar qartë ato. Grupet si personat me aftësi të kufizuara, prindërit e vetëm apo personat me nivel të ulët të shkrimleximit nuk adresohen në mënyrë eksplicite, duke rritur rrezikun që nevojat e tyre specifike të qasjes të anashkalohe në dizajnimin e shërbimeve.
- Barazia gjinore nuk reflektohet në objektivat kryesore apo vizionin e përgjithshëm të Programit, të cilat mbeten të formuluar në terma gjinorë neutralë, të fokusuar në efikasitet dhe kënaqësi. Si rezultat, barazia gjinore nuk pozicionohet si një rezultat i qartë, duke reduktuar peshën e saj në prioritizim dhe vendimmarrje. Pa qëllime të qarta, progresi në avancimin e barazisë gjinore është i vështirë të matet.
- Programi nuk i referohet në mënyrë eksplicite kornizës ligjore dhe të politikave të barazisë gjinore në Kosovë, duke përfshirë detyrimet sipas LBGJ-së. Kjo dobëson bazën e qasjes së bazuar në të drejta për integrimin gjinor dhe rrezikon që përfshirja gjinore të trajtohet si opsionale dhe jo si e detyrueshme.
- Masat gjithëpërfshirëse si konsultimi i përdoruesve të ndryshëm dhe ndarja e të dhënave sipas gjinisë përmenden në nivel të përgjithshëm, pa qartësi mbi përgjegjësitë apo mekanizmat e zbatimit. Mungesa e roleve të qarta, udhëzimeve dhe burimeve krijon rrezikun që këto angazhime të mos zbatohen në mënyrë sistematike në praktikë.
- Megjithëse digjitalizimi promovohet fuqishëm, Programi nuk garanton në mënyrë eksplicite vazhdimin e qasjes jodigjitalë apo të asistuar në shërbime. Pa një angazhim të qartë për ofrim të shërbimeve hibride, gratë me qasje më të ulët digjitale dhe grupet e tjera të marginalizuara mund të përballen me barriera të reja administrative.
- Treguesit e ndarë sipas gjinisë fokusohen kryesisht në rezultatet dalëse, si numri i shërbimeve të thjeshtuara apo të digjitalizuara. Nuk ka tregues të qartë të rezultateve përfundimtare që kapin ndryshimet në barazinë gjinore, përdorimin e shërbimeve nga gratë, kursimet në kohë apo kënaqshmërisë, duke kufizuar aftësinë e Programit për të vlerësuar ndikimin e tij real në barazinë gjinore.
- Programi nuk zbaton parimet e BPGJ-së. Alokimet financiare nuk analizohen në aspektin e ndikimit të tyre të diferencuar tek gratë dhe burrat, dhe nuk parashihen burime të dedikuara për të adresuar barrierat specifike gjinore në qasjen në shërbimet administrative.

### Shtojca 3. Përmbledhja e kornizave ligjore dhe të politikave relevante për barazi gjinore dhe reformën e administratës publike në Kosovë

Sipas TeR, ky seksion përmban një identifikim fillestar dhe të shpejtë të kornizave ligjore dhe të politikave relevante për barazinë gjinore dhe RAP në Kosovë. Për shkak të kufizimeve kohore, ky hartëzim fillestar mbështetet kryesisht në një analizë gjinore të ligjeve dhe politikave përkatëse, e realizuar tashmë nga RrGK-së në vitin 2024, në [Barazia gjinore: Në qendër të TI-së...dhe më përtej: Analizë Gjinore e Digjitalizimit në Kosovë](#), veçanërisht “Kapitulli 1. Analiza Gjinore e Digjitalizimit”.<sup>51</sup> Duke pasur parasysh kërkesat për gjatësi të shkurtër të faqes dhe për të shmangur përsëritjen e hulumtimeve ekzistuese, ligjet dhe politikat relevante të analizuara për përgjegjshmërinë e tyre gjinore përmbledhen këtu.

Ligji apo politika	Përgjegjshmëria gjinore
Kushtetuta e Republikës së Kosovës (me Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave – CEDAW)	E ndjeshme ndaj gjinisë
Kodi Penal i Republikës së Kosovës	Neutral ndaj gjinisë
Kodi i Procedurës Penale	Neutral ndaj gjinisë
Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Krimit Kibernetik	Neutral ndaj gjinisë
Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale	Neutral ndaj gjinisë
Ligji për Komunikimet Elektronike	Neutral ndaj gjinisë
Ligji për Organet Qeveritare për Shoqërinë e Informacionit	Neutral ndaj gjinisë
Ligji për Mbrojtjen e Fëmijëve	Neutral ndaj gjinisë
Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative	Neutral ndaj gjinisë
Ligji për Barazi Gjinore	E ndjeshme ndaj gjinisë
Ligji për Statistikat Zyrtare	Neutral ndaj gjinisë
Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë	Neutral ndaj gjinisë
Ligji për Financat e Pushtetit Lokal	Neutral ndaj gjinisë
Ligji për Prokurimin	Neutral ndaj gjinisë
Rregullorja e Punës të Kuvendi të Republikës së Kosovës	Neutral ndaj gjinisë
Rregullorja për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil	Neutral ndaj gjinisë
UA për Përdorimin dhe Menaxhimin e Internetit në Institucionet i Republikës së Kosovës	Neutral ndaj gjinisë
Strategjia për Rregullim më të Mirë 2.0 për Kosovën 2017-2021	E ndjeshme ndaj gjinisë
Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021	E ndjeshme ndaj gjinisë, por neutrale ndaj digjitalizimit
Programi i Qeverisë 2021-2025	I ndjeshëm ndaj gjinisë
Programi i Kosovës për të Barazi Gjinore 2020-2024	Transformues gjinor
Agjenda Evropiane e Reformave II	Neutral ndaj gjinisë
Strategjia e TI-së në Kosovë	Neutral ndaj gjinisë
Strategjia e Komunikimit dhe Informacionit 2018-2021	Neutral ndaj gjinisë
Politika e Sektorit të Komunikimit Elektronik – Agjenda Digjitale për Kosovën 2013- 2020	Neutral ndaj gjinisë
Agjenda Digjitale e Kosovës 2030	Neutral ndaj gjinisë
Strategjia e Kosovës për Qeverisje Elektronike 2023-2027	Neutral ndaj gjinisë
Strategjia e Reformës së Menaxhimit të Financave Publike të Kosovës	Neutrale ndaj gjinisë - negative
Strategjia për Përmirësimin e Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave në Kosovë (Sistemi i Integruar i Planifikimit) 2017-2021	Neutral ndaj gjinisë
Strategjia për Modernizimin e Administratës Publike	Neutral ndaj gjinisë
Strategjia e Reformës së Administratës Publike 2022-2027	Neutral ndaj gjinisë
Programi i Statistikave Zyrtare 2018-2022	Neutrale ndaj gjinisë (me disa elemente të përgjegjshme)
Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit 2022-2026	Neutral ndaj gjinisë

<sup>51</sup> Për analizën, ju lutemi shihni këtë raport, veçanërisht faqet 40-69. Kapituj të tjerë përmbajnë një analizë të ngjashme të shërbimeve të digjitalizuara në sektorë të tjerë (p.sh., shëndetësia, arsimi, shërbimet sociale, etj.).

Ligji apo politika	Përgjegjshmëria gjinore
Programi i Reformës Ekonomike 2023-2025	I ndjeshëm ndaj gjinisë
Strategjia për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026	Neutral ndaj gjinisë
Strategjia për Rini 2019- 2023	Neutral ndaj gjinisë
Plani i Veprimit për Kuvendin e Hapur 2023-2026	Neutral ndaj gjinisë
Kontrata e Reformës Sektoriale të Kosovës për Reformën e Administratës Publike	Neutral ndaj gjinisë
Udhëzim Administrativ (GRK) Nr. 10/2023 për Licencimin e Profesionistëve të Huaj Shëndetësorë	Neutral ndaj gjinisë
Udhëzimi Administrativ (MPB) Nr. 12/2024 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MPB) Nr. 04/2023 për Regjistrimin e Automjeteve	Neutral ndaj gjinisë
Udhëzim Administrativ (në Kujdesin Shëndetësor) Nr. 02/2025 për Kushtet dhe Procedurat për Ushtrimin e Aktiviteteve Shëndetësore në Institucionet Private	Neutral ndaj gjinisë
Udhëzim Administrativ (MKRS) Nr. 02/2025 për Kriteret, Kërkesat, Rregullat dhe Procedurat Lidhur me Lëshimin, Administrimin dhe Revokimin e Licencave Profesionale për Personat Fizikë dhe Juridikë në Fushën e Trashëgimisë Kulturore	Neutral ndaj gjinisë
Udhëzim Administrativ (GRK) Nr. 04/2024 për Tarifat për Produktet dhe Shërbimet Kadastrale Gjeodezike dhe Regjistrimit të Pronave	I ndjeshëm ndaj gjinisë
Udhëzim Administrativ (MESPI) Nr. 06/2024 për Dhënien e Lejeve për Kompanive Gjeodezike dhe Licencimin e Gjeodetëve	Neutral ndaj gjinisë
Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2024 për Bashkëpagesat për Shërbimet Shëndetësore	Neutral ndaj gjinisë
Udhëzim Administrativ (MESPI) nr. 03/2025 për Procedurat dhe Kriteret për Licencimin e Personave Fizikë dhe Juridikë për Hartimin e Raportit të VNM-së	Neutral ndaj gjinisë
Rregullorja (GRK) Nr. 20/2024 për Arsimin, Trajnimin dhe Njohjen e Shërbimeve dhe Ekspertëve	Neutrale ndaj gjinisë (deri diku e ndjeshme)

### PVBGJ III i BE-së

Përveç ligjeve dhe politikave të lartpërmendura, është kryer një analizë e shpejtë mbi relevancën e PVBGJ III të BE-së. Meqenëse Kosova nuk është shtet anëtar i BE-së, ajo nuk ka detyrim për të zbatuar PVBGJ III. Megjithatë, PVBGJ III i BE-së dhe treguesit e tij janë relevantë për të gjitha programet e financuara nga BE-ja, duke përfshirë mbështetjen e drejtpërdrejtë buxhetore, e cila financon administratën publike të Kosovës dhe reformat që lidhen me anëtarësimin në BE. Treguesit e PVBGJ III nuk adresojnë drejtpërdrejt administratën publike, megjithëse ekziston potencial për ndryshime në kuadër të PVBGJ IV të ardhshëm. Ndërkohë, në përgjithësi, nevoja për analizë gjinore dhe integrim gjinor përmendet përgjatë PVBGJ III. Veprimet që ndërlidhen me RAP të mbështetura nga BE-ja duhet të informohen nga VNBGJ-të dhe të përfshijnë objektiva, tregues dhe të dhëna të ndara sipas gjinisë, në përputhje me angazhimet e PVBGJ III. Disa tregues lidhen me integrimin gjinor në ligje dhe politika dhe me rritjen e qasshmërisë në shërbime si shëndetësia, arsimi, punësimi dhe shërbime të tjera, përfshirë përmes digjitalizimit. Për më tepër, PVBGJ III i BE-së përmban disa tregues që janë drejtpërdrejt relevantë:

Objektivi	Veprimi	Treguesi	Caku	Rëndësia
<b>Objektivi 3: Promovimi i buxhetimit të përgjegjshëm gjinor.</b>	3.1. Rritja e numrit të veprimeve (operacioneve të mbështetjes buxhetore ose projekteve) që mbështesin reformat në menaxhimin e	% e veprimeve të reja që mbështesin reformat në MFP dhe që përfshijnë një komponent të	Të paktën 20% e veprimeve të reja që mbështesin reformat në MFP	BE-ja ka mbështetur analizën e PEFA-së si pjesë e mbështetjes për MFP. Mbështetja e drejtpërdrejtë

	financave publike (MFP) dhe që përfshijnë një komponent të buxhetimit gjinor.	buxhetimit gjinor, sipas viteve	përfshijnë një komponent të buxhetimit gjinor (nga viti 2021)	buxhetore e BE-së mund ta kushtëzojë më mirë BPGJ-në. Qeveria e Kosovës ka miratuar koncept dokumentin për BPGJ me qëllim institucionalizimin.
<b>Objektiva 4. Treguesit specifikë gjinorë dhe/ose të ndarë sipas gjinisë përdoren në mënyrë sistematike</b>	4.1. Sigurimi që treguesit specifikë gjinorë ose të ndarë sipas gjinisë të jenë pjesë e sistemit të monitorimit dhe vlerësimit të veprimeve të financuara nga BE-ja	% e veprimeve të financuara nga BE-ja që kanë të dhëna specifike sipas gjinisë ose të ndara sipas gjinisë, të paktën në përditësimin më të fundit të progresit	85% e veprimeve të reja deri në vitin 2025 kanë të paktën të dhënat më të fundit të progresit të ndara sipas gjinisë ose specifike gjinore, siç kërkohet nga formulimi i treguesit.	Të dhënat janë të nevojshme për raportim në BE. LBGJ kërkon ndjekjen dhe raportimin e të dhënave të ndara sipas gjinisë, por disa institucione nuk i zbatojnë rregullisht përgjegjësitë; mungojnë sisteme për ndjekjen dhe raportimin e të dhënave.

Burimi: E përshtatur nga Komisioni Evropian (KE), Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit të Jashtëm për Punë të Jashtëm dhe Politikën e Sigurisë. "Dokument pune i përbashkët i stafit: Objektivat dhe treguesit për të orientuar zbatimin e Planit të Veprimit për Barazi Gjinore III (2021-2025)". SWD(2020) 284 final. Bruksel: 2020, p.4. Kolonat e para janë origjinale; kolona e fundit përfshin analizën e RrGK-së.

## Shtojca 4. Përmbledhje e analizës së koncept dokumenteve dhe akteve ligjore

Kjo shtojcë përmbledh analizën gjinore të koncept dokumenteve dhe akteve ligjore. VNGJ ka përfshirë rishikimin e pesë koncept dokumenteve të dhe 15 akteve ligjore. Bazuar në hapat në [Manualin për Vlerësimin e Ndikimit në Barazinë Gjinore](#)<sup>52</sup> të ABGJ-së, analiza shqyrtoi: (1) qëllimin e politikës; (2) relevancën gjinore të politikës, që përfshin analizimin nëse ajo mund të ndikojë në barazinë gjinore; (3) analizën e ndjeshme gjinore për të kuptuar situatën aktuale të grupeve të prekura nga politika, si mund të ndikojë politika në situatën e tyre dhe si ndërhyrja e planifikuar mund ta ndryshojë atë; (4) ndikimin gjinor, që përfshin përcaktimin se si politika do të kontribuojë në barazinë gjinore dhe ndikimin e parashikuar në marrëdhëniet gjinore; dhe (5) gjetjet dhe rekomandimet e identifikuar për opsionet e politikave/legjislatcionit, përfshirë mënyrat për eliminimin e ndikimeve negative dhe rritjen e atyre pozitive.<sup>53</sup> Vlen të theksohet se kjo përfshinte një analizë të shpejtë për qëllime ilustruese, duke u bazuar në hulumtimet ekzistuese nga burimet sekondare dhe nuk përbënte një VNBGJ të plotë, e cila do të kërkonte hulumtim shtesë dhe konsultim me gra dhe burra të ndryshëm. Gjithashtu, bazuar në kriteret e KNZH-së të OBZHE-së për shënimin gjinor, relevante për të gjitha programet e financuara nga BE-ja, çdo dokument u analizua për të vlerësuar nëse: (1) përfshinte analizë gjinore; (2) përdorte analizën gjinore për të informuar objektivat drejt barazisë gjinore; (3) identifikonte treguesit për të matur progresin drejt barazisë gjinore; dhe (4) përfshinte të dhëna të ndara sipas gjinisë për caqet.<sup>54</sup> Nënseksionet në vijim përmbledhin gjetjet për secilin dokument bazuar në këtë analizë.

Vlen të theksohet se kjo analizë është bazuar në një rishikim gjinor të koncept dokumenteve dhe akteve që lidhen me shërbimet publike; ajo nuk është fokusuar vetëm në aspektet që lidhen drejtpërdrejt me ZBA-në. Prandaj, disa nga gjetjet dhe rekomandimet janë relevante për personat e angazhuar në hartimin e këtyre ligjeve dhe politikave, por mund të mos jenë relevante për ZPS në kuadër të ZKM-së sipas mandatit të saj specifik. Megjithatë, duke qenë se këto ligje dhe politika rregullojnë ofrimin e shërbimeve publike, një qasje holistike, e orientuar drejt përdoruesit dhe e përgjegjshme gjinore në dizajnimin e tyre duhet të marrë parasysh analizën gjinore në përputhje me kërkesat e LBGJ-së dhe udhëzimet e VNBGJ-së. Prandaj, megjithëse gjetjet dhe rekomandimet janë jashtë mandatit dhe fushëveprimit të punës së ZPS në kuadër të ZKM-së, ato mund të jenë të dobishme për ata që angazhohen në reformat e ZBA-së në të ardhmen.

### ***Udhëzim Administrativ (GRK) Nr. 10/2023 për Licencimin e Profesionistëve të Huaj Shëndetësorë***

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ (UA) është të rregullojë procedurat dhe kushtet për licencimin, rilicencimin dhe angazhimin e profesionistëve të huaj shëndetësorë në Kosovë. Ai prek të gjithë profesionistët e huaj shëndetësorë, institucionet shëndetësore, bordet e licencimit dhe komisionet përkatëse. Ai përmban dispozita që lidhen me profesionistët e diasporës dhe angazhimin e profesionistëve shëndetësorë për qëllime humanitare ose emergjente.

Gratë prirën të jenë të mbi-përfaqësuar në sektorin e shëndetësisë, veçanërisht në pozita me paga më të ulëta (p.sh., infermieret), për të cilat Kosova mund të ketë kërkesë më të madhe për profesionistë të huaj për shkak të emigrimit të këtyre profesionistëve nga Kosova.<sup>55</sup> Për më tepër, kërkesat administrative për licencim, koha dhe kostot përkatëse,

<sup>52</sup> Kjo kërkon që çdo politikë, ligj apo program i ri ose i rishikuar t'i nënshtrohet një procesi të strukturuar për të testuar relevancën e tij për barazinë gjinore, për të identifikuar ndikimet e mundshme të pabarabarta dhe për të propozuar masa korrigjuese.

<sup>53</sup> Gjetjet janë përmbledhur në tabelën më poshtë.

<sup>54</sup> OBZHE "DAC gender equality policy marker", qasur më 25 shkurt 2026.

<sup>55</sup> Shih për shembull, Lumi Qehaja, Fatime & Maljichi, Driton & Serafimovska, Eleonora (2025). Migrimi dhe Profesionistët e Kujdesit Shëndetësor në Sektorin Publik në Kosovë. Problemy Polityki Społecznej Studia i Dyskusje. 68. 1-26. 10.31971/paps/196564. Shih gjithashtu, Open Data Kosovo, (13 shtator 2019). [Women in the workplace – Working hard for the money](#).

kushtet që lidhen me migrimin dhe lejet e punës mund të ndikojnë në mënyrë të ndryshme tek gratë dhe burrat, pasi rregullat formalisht neutrale shpesh krijojnë barriera të pabarabarta në praktikë për gratë për shkak të pabarazive të tyre në të ardhura, sektor të punësimit dhe përgjegjësi të kujdesit.

Në përgjithësi, ky Udhëzim Administrativ është **neutral ndaj gjinisë**, pasi nuk mbështet apo forcon barazinë gjinore. Ai nuk merr parasysh se si procedurat e gjata administrative mund të ndikojnë ndryshe tek gratë dhe burrat. Disa dispozita mund të ndikojnë ndryshe tek gratë dhe burrat për shkak të pengesave administrative, migrimit, statusit socio-ekonomik dhe rrugëve të karrierës. Dokumentacioni i kërkuar për licencim është i gjerë dhe kërkon që i gjithë dokumentacioni të jetë i noterizuar dhe i përkthyer zyrtarisht. Për më tepër, ekziston një kosto e konsiderueshme për aplikimin për licencim dhe ri-licencim, e cila nuk rimbursohet nëse aplikimi refuzohet. Kjo, së bashku me përkthimin dhe noterizimin, paraqet kosto të konsiderueshme dhe një proces të gjatë. Nuk parashihen përjashtime nga tarifat për asnjë kategori. Profesionistët shëndetësorë gra me përgjegjësi familjare si kujdesi për fëmijë dhe ato nga vende me të ardhura më të ulëta ka të ngjarë të preken më shumë nga këto tarifa dhe procedura. Kjo mund të minojë qasjen e profesionistëve shëndetësorë gra në këtë sektor. Gjithashtu, licenca lëshohet vetëm për të njëjtën kohëzgjatje si leja e punës ose leja e qëndrimit, që do të thotë se procedura e rilicencimit është e shpeshtë dhe e kushtueshme. Gratë që kanë detyrime familjare (p.sh., kujdesi për fëmijë, gjidhënia) ka të ngjarë të përballen me vështirësi shtesë për të aplikuar shpesh për shkak të kufizimeve kohore. Udhëzimi Administrativ nuk përdor gjuhë të ndjeshme gjinore; të gjithë profesionistët mjekësorë referohen në gjininë mashkullore.<sup>56</sup> Gjithashtu, UA nuk kërkon në mënyrë të qartë mbledhjen sistematike, monitorimin dhe publikimin e të dhënave të ndara sipas gjinisë për aplikimet e dorëzuara, licencat e dhëna, rinovimet dhe refuzimet apo për përbërjen e bordeve. Kjo mund të rrezikon mosrespektimin e LBGJ-së dhe kërkesës së tij për raportim të rregullt të të dhënave të ndara sipas gjinisë tek ASK, si dhe për sigurimin e monitorimit të duhur të procedurave të aplikimit. Gjithashtu, dispozitat nuk kërkojnë përfaqësim të balancuar gjinor në bordet apo komisionet e licencimit. Duke pasur parasysh pabarazitë gjinore në pjesëmarrje, kjo rrezikon nënpërfaqësimin e grave në borde dhe komisione dhe mund të zvogëlojë konsideratat për barazi gjinore gjatë shqyrtimit të aplikimeve. Rekomandimet:

- 
- Kërkoni përfaqësim të barabartë gjinor në Borde dhe komisione në përputhje me LBGJ-në.
- Siguroni fleksibilitet në vlerësimin e përvojës profesionale në rastet e ndërprerjeve për gratë, veçanërisht për shkak të pushimit të lehonisë.
- Përfshini gjuhë të ndjeshme gjinore duke përdorur terminologji që i referohet si grave ashtu edhe burrave.
- Konsideroni uljen ose përjashtimin nga tarifat për kategoritë e cenueshme, duke përfshirë gratë nga vendet me të ardhura të ulëta.
- Kërkoni mbledhjen e të dhënave të ndara sipas gjinisë për aplikimet dhe licencat e dhëna, si dhe publikimin e të dhënave të ndara sipas gjinisë dhe kategorive të tjera, në përputhje me LBGJ-në. Në drejtim të ndërveprueshmërisë, lidhni të dhënat me ASK-në për publikim automatik.
- Thjeshtoni proceset e riaplikimit duke mundësuar riaplikimin online, duke minimizuar kohën e nevojshme për riaplikim. Konsideroni pranimin e noterizimit elektronik të dokumenteve origjinale për të zvogëluar kohën dhe kostot e udhëtimit.

---

<sup>56</sup> Edhe pse disa përpjekje ligjore dhe politike kanë synuar të përfshijnë një klauzolë që çdo emërtim i referohet edhe gjinisë tjetër, kjo qasje nuk është e ndjeshme gjinore.

## **UA (MPB) Nr. 12/2024 për Ndryshimin dhe Plotësimin e UA (MPB) Nr. 04/2023 për Regjistrimin e Automjeteve**

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ (UA) është të ndryshojë dhe plotësojë UA për regjistrimin e automjeteve. Ky UA është **neutral ndaj gjinisë**, pasi zbatohet njësoj për gratë dhe burrat. Megjithatë, një analizë e situatës sugjeron se disa elemente mund të ndikojnë ndryshe tek gratë krahasuar me burrat. Regjistrimi i automjetit kërkon patentë shoferi që korrespondon me kategorinë e automjetit. Kjo dispozitë mund të përbëjë një pengesë, veçanërisht për gratë që synojnë të regjistrojnë një automjet në emrin e tyre, pasi gratë kanë më pak gjasa të posedojnë patentë shoferi, veçanërisht gratë rurale, të moshuara, më të varfra dhe disa gra nga komunitetet pakicë.<sup>57</sup> UA Nr. 04/2023 për Regjistrimin e Automjeteve tashmë rregullon regjistrimin e automjetit në emër të një personi pa patentë shoferi, duke kërkuar që pronari të caktojë një përdorues të automjetit me autorizim të noterizuar. Kjo dispozitë rrit kostot e regjistrimit të automjetit. Gjithashtu, ajo nuk bën dallim ndërmjet pronësisë së automjetit si pronë private individuale dhe përdorimit të automjetit. Ndërsa drejtimi i automjetit pa patentë shoferi duhet të ndalohet, pronësia e automjeteve nuk duhet të kufizohet vetëm për personat që posedojnë patentë shoferi, veçanërisht duke marrë parasysh faktorët apo aftësitë e kufizuara që mund të pengojnë individët të pajisen me patentë shoferi. Ata duhet të jenë në gjendje të regjistrojnë automjetin në pronësi të tyre pa qenë e nevojshme të specifikohet një përdorues i automjetit. Varësia nga një përdorues përzien të drejtën e pronësisë me atë të përdorimit. Kjo mund të përforcojë role gjinore që mund t'i disfavorizojnë gratë më shumë se burrat, si në rastet e dhunës në familje [06], përfshirë ndarjen e pronës gjatë divorcit, kur përcaktohet një përdorues i automjetit dhe jo ai që pronari i automjetit dëshiron (më tej). Për më tepër, dispozitat kërkojnë që aplikanti të paraqitet në Qendrën për Regjistrimin e Automjeteve (QRA) për të dorëzuar një kopje fizike të raportit të kontrollit të automjetit ose për të tërhequr targat e automjetit pasi të jenë gati; procedurat e tjera mund të kryhen online. Këto kërkesa mund të ndikojnë në mënyrë disproporcionale tek gratë, veçanërisht ato që janë të moshuara, nga zonat rurale, kanë aftësi të kufizuara digjitale ose përballen me kufizime në lëvizshmëri për shkak të përgjegjësisë të kujdesit, transportit publik jo të qasshëm, kufizimeve financiare apo aftësisë së kufizuar. QRA gjithashtu ka orar të kufizuar pune, gjë që mund të jetë e pafavorshme për gratë dhe burrat e punësuar, veçanërisht për gratë me përgjegjësi për kujdesin ndaj fëmijëve dhe kufizime kohore. Rekomandimet:

- Siguroni që masat të masat të mundësojnë regjistrimin e automjetit në emër të pronarit pa kërkuar patentë shoferin.
- Adresoni hendeqet e mundshme gjinore në qasjen digjitale për grupet e cënueshme, përfshirë personat me aftësi të kufizuara, dhe/ose ofroni mekanizma alternativë mbështetës, duke pasur parasysh se UA kërkon një kombinim të procedurave online dhe atyre me prezencë fizike. Ofroni asistencë për aplikim fizik për personat që kanë nevojë.
- Kërkoni mbledhjen dhe publikimin e rregullt të të dhënave mbi pronësinë e automjeteve, regjistrimin, çregjistrimin dhe përdorimin e shërbimeve online kundrejt atyre me prezencë fizike, të ndara sipas gjinisë dhe moshës, vendndodhjes rurale/urbane, përkatësisë etnike dhe aftësisë së kufizuar, për të identifikuar dhe adresuar barrierat dhe kostot e diferencuara gjinore. Ndërlidhni të dhënat me ASK-në përmes ndërveprueshmërisë.
- Zgjatni orarin e punës së QRA-ve në ditë të caktuara ose të shtunave për të lehtësuar qasjen për gratë dhe burrat e punësuar.
- Minimizoni paraqitjen e detyrueshme fizike vetëm në situata thelbësore (p.sh., për parandalimin e mashtrimit) dhe siguroni alternativa të qasshme për individët që përballen me kufizime në lëvizshmëri, kohë apo qasje digjitale. Mundësoni dorëzimin e të gjithë dokumentacionit online dhe pranimin e targave përmes postës.

<sup>57</sup> RrGK, [Analiza Gjinore e Transportit Tokësor në Kosovë](#), 2025.

## **UA (në Kujdesin Shëndetësor) Nr. 01/2025 për Kushtet dhe Procedurat për Ushtrimin e Aktiviteteve Shëndetësore në Institucionet Private**

Ky udhëzues ka për qëllim të rregullojë procedurat e licencimit për shërbimet shëndetësore. Ai është **neutral ndaj gjinisë**, pasi nuk përmban dispozita specifike që ndërlidhen me gjininë dhe nuk merr parasysh barrierat gjinore, duke përfshirë kushtet e qasjes fizike për personat me aftësi të kufizuara apo hapësirat për ndërrimin e foshnjave për familjet me fëmijë. Ai nuk kërkon që bordet apo komisioni i ankesave të kenë përfaqësim të balancuar gjinor. Personat duhet të aplikojnë për licencë “përmes qasjes në modulën elektronik të aplikimit në Ministrinë e Shëndetësisë”; ai nuk parashikon metoda alternative për aplikim. Kjo mund t’i vë në disavantazh në mënyrë indirekte disa gra, bazuar në aftësitë e tyre digjitale dhe moshën, veçanërisht praktikatat e vogla në pronësi të grave. Megjithatë faqja e internetit ka një video për të udhëzuar përdoruesit, ata me qasje të kufizuara në teknologji dhe me aftësi të ulëta digjitale mund të hasin vështirësi. Për më tepër, [faqja](#) nuk ofron mundësi aplikimi në gjuhën serbe. Rekomandimet:

- Mundësoni që aplikimet të dorëzohen edhe fizikisht ose me asistencë.
- Kërkoni përfaqësim të barabartë gjinor në Bordin e Licencimit të Institucioneve Shëndetësore Private dhe në Komisionin e Ankesave në përputhje me LBGJ-në.

### **Projektligji për Shoqëritë Tregtare**

Projektligji ka për qëllim rregullimin e themelimit, organizimit, të drejtave dhe detyrimeve të bizneseve, pronarëve dhe aksionarëve të bizneseve. Ai është deri diku i **ndjeshëm ndaj gjinisë**, pasi përdor gjuhë të ndjeshme gjinore, duke iu referuar drejtorëve dhe pasardhësve të bizneseve në të dy gjinitë. Një masë tjetër e ndjeshme gjinore është kuota e detyrueshme gjinore (40%) për anëtarët e Bordit të Drejtorëve dhe Drejtorët Menaxhues të Shoqërisë Aksionare.

Ndërsa regjistrimi digjital zvogëlon barrën administrative dhe kohën e gjatë të pritjes, ai mund të përbëjë pengesë për gratë që kanë qasje minimale në mjete digjitale. [Faqja e internetit](#) e Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës mundëson aplikim online për regjistrimin e biznesit vetëm në gjuhën shqipe. Platforma nuk është e lehtë për përdorim, gjë që mund të paraqesë pengesa për ata me aftësi të kufizuara digjitale. [Videoja](#) e vetme udhëzuese për përdorimin e platformës është vetëm në gjuhën shqipe; kjo pengon qasjen për ata që nuk flasin shqip, duke përfshirë gratë nga komunitetet pakicë. Për më tepër, barrierat strukturore shoqërore mund të kufizojnë qasjen e grave në pronësinë e bizneseve në Kosovë për bizneset e drejtuara nga gra për herë të parë, pasi ato përballen në mënyrë disproporcionale me kufizime në kohë, burime financiare dhe aftësi digjitale. Rekomandimet:

- Siguroni që shërbimet online për regjistrimin e bizneseve të Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës, materialet udhëzuese dhe përmbajtja udhëzuese të jenë plotësisht të disponueshme dhe funksionalisht të barasvlershme në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze, për të parandaluar diskriminimin indirekt ndaj atyre që nuk flasin shqip, përfshirë gratë nga komunitetet pakicë.
- Mundësoni gjithashtu procedura të asistuar për aplikim fizik.
- Ofroni stimuj për bizneset e regjistruara për herë të parë të drejtuara nga gratë.

### **Projektligji për zejtari**

Ky Projektligj rregullon kushtet për ushtrimin e veprimtarive zejtare, procedurat e regjistrimit dhe licencimit për zejtarët, kualifikimet profesionale, organizimin përmes Odës së Zejtarëve dhe masat për promovimin dhe zhvillimin e zejeve dhe aktiviteteve artizanale. Ai vendos procedura të standardizuara, regjistrim të detyrueshëm, licencim, tarifa, provime dhe mekanizma mbikëqyrës. Projektligji nuk përdor gjuhë neutrale gjinore, pasi pronarët dhe zejtarët referohen gjithmonë në gjininë mashkullore (*pronari, zejtari, llogarinë e tij*).

Ai ka relevancë gjinore pasi rregullon fusha ku vetëpunësimi është mbizotërues, aktivitetet e vogla ekonomike dhe aktivitetet ekonomike familjare, ku gratë kanë tendencë të angazhohen. Ai parasheh qasje në licenca për disa zeje, trashëgiminë e veprimtarisë zeytare dhe tarifata e anëtarësimit. Tarifata e anëtarësimit mund të ndikojnë më shumë tek individët me më pak burime dhe qasje të kufizuar në kapital, si gratë. Projektligji mundëson që anëtarët e familjes të kontribuojnë në bizneset e shërbimeve zeytare pa një marrëdhënie zyrtare pune apo pagesë. Dështimi i ligjit për të rregulluar dhe njohur punën e papaguar në bizneset familjare mund të kontribuojë në informalitet, që prek më shumë gratë sesa burrat, cenon autonominë dhe sigurinë ekonomike të grave anëtare të familjes dhe kontribuon në varfëri në moshë më të shtyrë për shkak të mungesës së kontributeve pensionale që lidhen me punën e tyre. Asnjë dispozitë nuk kërkon mbajtjen e të dhënave të ndara sipas gjinisë në regjistrat e zeyteve, licencimit dhe titujve, në përputhje me kërkesat e LBGJ-së. Në përgjithësi, ndërsa Projektligji përmban disa dispozita të **ndjeshme gjinore**, të tjerat janë neutrale ndaj gjinisë ose madje **negative nga perspektiva gjinore**. Rekomandimet:

- Kërkoni mbledhjen dhe raportimin automatik tek ASK të të dhënave të ndara sipas gjinisë në regjistrat e zeyteve, licencimit dhe titujve profesionalë, duke përdorur sisteme të ndërveprueshme. Kjo mundëson analizë më të mirë të ndikimeve të diferencuara gjinore dhe efikasitetit të procedurave.

#### **UA (MESPI) Nr. 03/2025 për Procedurat dhe Kriteret për Licencimin e Personave Fizikë dhe Juridikë për Hartimin e Raportit të VNM-së**

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ (UA) është të rregullojë procedurën për licencimin e personave fizikë dhe juridikë për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit mjedisor (VNM). Ai përcakton afatet kohore, tarifata dhe kërkesat për licencim. Aplikimi për licencim bëhet online, pas një thirrjeje të publikuar çdo vit në faqen e internetit të MMPHI-së. Në përgjithësi, është **neutral ndaj gjinisë** pasi të gjitha kërkesat dhe procedurat zbatohen njësoj për të gjithë aplikuesit. Neni 3 thekson se format mashkullore dhe femërore përdoren në mënyrë të ndërsjellë, megjithëse kjo mund të përforcojë në mënyrë indirekte normat gjinore. Ky udhëzim rregullon qasjen në ofrimin e shërbimeve të specializuara. Prandaj, ai parasheh kërkesa specifike hyrëse, si pesë vite përvojë, publikime, bashkëpunim paraprak me një person tashmë të licencuar dhe tarifa të pakthyeshme në rast të refuzimit të kërkesës. Personat juridikë duhet të punësojnë të paktën tre ekspertë të licencuar.

Këto kërkesa mund të vënë në disavantazh gratë, veçanërisht gratë e reja dhe/ose të marginalizuara që nuk posedojnë të njëjtat mundësi për rrjetëzim profesional dhe punësim të pandërprerë. Për më tepër, ai parasheh që lista e ekspertëve të licencuar të publikohet. Në [faqen e internetit](#) të MMPHI-së, lista nuk është e qasshme pas shkarkimit, pasi faqja shfaqet bosh për disa vite (p.sh., 2025, 2022). Gjithashtu, lista nuk është e ndarë sipas gjinisë. Kjo do të ishte e dobishme për analizë gjinore të individëve të licencuar dhe për monitorimin e procedurave të aplikimit. Për më tepër, rinovimi i licencave kërkon një kopje të dokumentit të identifikimit dhe një kopje të licencës së mëparshme, që nga perspektiva e ZBA-së “vetëm një herë” nuk duhet të kërkohet, pasi Ministria tashmë i posedon këto dokumente. Rekomandimet:

- Përdorni gjuhë të përgjegjshme gjinore në të gjithë tekstin në vend të nenit 3, për të shmangur përforcimin e stereotipeve gjinore.
- Uleni tarifata për aplikim dhe rinovim të licencave dhe ofroni rimbursim të pjeshëm në rast refuzimi të kërkesave. Për procedurat e rinovimit, hiqni kërkesat për dokument të identifikimit dhe licencën e mëparshme, pasi Ministria i posedon këto dokumente.
- Kërkoni mbledhjen dhe publikimin e të dhënave të ndara sipas gjinisë për aplikuesit dhe personat fizikë dhe juridikë të licencuar, të përditësuara automatikisht tek ASK përmes ndërveprueshmërisë

## ***Rregullorja (GRK) Nr. 20/2024 për Arsimin, Trajnimin dhe Njohjen e Shërbimeve dhe Ekspertëve***

Qëllimi është të përcaktojë kërkesat dhe procedurat për licencim, arsimim dhe aftësim për ekspertët në mbrojtjen nga rrezatimi dhe sigurinë bërthamore. Megjithëse teknike, ajo ka efekte të tërthorta sociale dhe gjinore pasi rregullon qasjen në licencim për një profesion specifik. Kriteret zbatohen për të gjithë aplikuesit, gratë dhe burrat. Rregullorja kërkon që aplikuesit të kenë të paktën pesë vite përvojë pune. Kjo mund t'i disfavorizojë gratë për shkak të pushimit të lehonisë ose përgjegjësive të kujdesit. Licenca lëshohet me vlefshmëri pesëvjeçare. Për rinovimin e licencës, eksperti duhet të paraqesë dëshmi për 100 pikë të fituara gjatë pesë viteve të fundit, mesatarisht njëzet pikë në vit, ku një ditë e plotë trajnimi barazohet me dhjetë pikë. Kjo kërkesë nuk lë fleksibilitet për pushimin e lehonisë, punën me honorar (p.sh., për shkak të përgjegjësive të kujdesit) apo vështirësitë për të marrë pjesë në trajnime për shkak të përgjegjësive familjare, të cilat prekin kryesisht gratë. Rregullorja nuk adreson kushtet për vazhdimësinë e karrierës në rastet kur gratë vendosin të ndërpresin ose të reduktojnë orarin e punës për shkak të rreziqeve që lidhen me shtatzëninë, duke ua pamundësuar atyre përmbushjen e mesatares së pikëve të kërkuara në vit. Gjithashtu, ajo nuk kërkon balancë gjinore në Komisionin për licencim. Kështu, ndonëse duket gjinore neutrale, ajo mund të ketë ndikime **negative gjinore**. Rregullorja nuk kërkon mbledhjen apo publikimin e të dhënave; formularët e aplikimit vetëm theksojnë se informacioni i kërkuar do të përpunohet në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Rekomandimet:

- Ndryshoni procedurën për sistemin e pikëve për rinovimin e licencës, i cili kërkon mesatarisht 20 pikë në vit, duke e bërë atë më fleksibil dhe kumulativ gjatë pesë viteve, për të adresuar rastet e punësimit me kohë të pjesshme ose pushimit të lehonisë.
- Mblidhni dhe raportoni të dhëna të ndara sipas gjinisë në përputhje me kërkesat e LBGJ-së në Kosovë.

## ***UA (MKRS) Nr. 02/2025 për Kriteret, Kërkesat, Rregullat dhe Procedurat Lidhur me Lëshimin, Administrimin, dhe Revokimin e potenciale Profesionale për Personat Fizikë dhe Juridikë në Fushën e Trashëgimisë Kulturore***

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ (UA) është rregullimi i licencimit të personave në fushën e konservimit, restaurimit dhe aktiviteteve arkeologjike në trashëgiminë kulturore. Dispozitat e qarta specifikojnë se licencimi është i hapur për të gjithë ata që i plotësojnë kriteret. Licencimi bëhet përmes një sistemi elektronik për të thjeshtuar procesin e aplikimit.

Udhëzimi ka relevancë gjinore pasi rregullon licencimin në një fushë ku gratë janë të nënprefaqësuar, veçanërisht në restaurimin teknik dhe në rolet e ekspertëve të lartë.<sup>58</sup> Megjithatë, përmendja e vetme e gjinisë është për të siguruar që të gjitha termat e përdorur i referohen edhe gjinisë tjetër, gjë që mund të përforcojë stereotipet gjinore. Ai nuk parashikon udhëzime apo asistencë jashtë sistemit elektronik, gjë që mund të ndikojë tek personat me qasje të kufizuar, duke përfshirë gratë, veçanërisht nga grupet e marginalizuara Sistemi elektronik i aplikimit kërkon noterizimin e dokumenteve të ndryshme, tarifa për aplikim dhe përvojë të vazhdueshme relevante. Këto mund të ndikojnë më shumë tek gratë për shkak të ndërprerjeve në punësim për shkak të pushimit të lehonisë dhe përgjegjësive të kujdesit. Asnjë dispozitë nuk rregullon përfaqësimin e balancuar gjinor në Bordin e Licencimit. Bordi është i obliguar të raportojë tek Ministria, por jo në mënyrë eksplicite të ndajë të dhënat sipas gjinisë dhe faktorëve të tjerë socio-demografikë. Kështu, Udhëzimi duket neutral ndaj gjinisë, por pa masa të përgjegjshme gjinore, ai mund të përjashtojë në mënyrë indirekte gratë, si dhe grupe të tjera të marginalizuara, duke kufizuar pjesëmarrjen e tyre në sektorin e trashëgimisë kulturore, çka mund të ketë ndikim negativ gjinor. Rekomandimet:

---

<sup>58</sup> Profili Gjinor i Vendi i UN Women (2024) trajton sistemin e licencimit në Kosovë dhe mënyrën se si ai krijon barriera administrative që ndikojnë në mënyrë disproporcionale tek gratë, si dhe *dallimet gjinore në pjesëmarrje në profesione të licencuara*.

- Përdorni gjuhë të ndjeshme gjinore.
- Futni njohjen e ndërprerjeve në karrierë për shkak të pushimit të lehonisë gjatë llogaritjes së viteve të përvojës.
- Mblidhni dhe publikoni rregullisht të dhëna të ndara sipas gjinisë dhe treguesve të tjerë socio-ekonomik për aplikuesit dhe miratimet e licencave, duke i ndërlidhur me ASK-në përmes ndërveprueshmërisë në përputhje me LBGJ-në.
- Kërkoni kuotë gjinore në Bord në përputhje me LBGJ-në (50%).
- Kërkoni që Bordi të përfshijë analizën gjinore në raportet e tij, me qëllim identifikimin e fushave për përmirësimin e barazisë gjinore.
- Siguroni mbështetjen e aplikantëve me asistencë online dhe offline.

### **Projektligji për Bankat**

Ky Projektligj ka për qëllim të rregullojë aktivitetet bankare dhe financiare përmes licencimit të bankave vendore dhe të huaja, rregullimit të menaxhimit të bankave, mbikëqyrjes si dhe rimëkëmbjes ose likuidimit të bankave.

Projektligji ka relevancë gjinore pasi rregullon qasjen në punësim, financim, pozita të mesme dhe të larta në sistemin financiar dhe pozita vendimmarrëse në sektorin bankar. Gratë janë të nënpërfaqësuar në pozitat e mesme dhe të larta drejtuesve dhe në pozitat vendimmarrëse në sektorin bankar.<sup>59</sup> Kjo pabarazi përforcohet nga fakti që Projektligji u referohet të gjitha pozitave, nga agjentët deri te pozitat e mesme dhe të larta drejtuese, në gjuhën shqipe dhe serbe në gjininë mashkullore. Kjo promovon stereotipet gjinore se pozitat e mesme dhe të larta drejtuese në sektorin bankar janë për burra. Nënpërfaqësimi i grave në sektorin bankar mund të çojë në vlerësime të njëanshme të rrezikut dhe dizajn jo të përshtatshëm gjinor të produkteve financiare. Projektligji mund të kontribuojë pozitivisht në barazinë gjinore duke përfshirë masa për përmirësimin e qasjes së grave në financa, por nuk e bën këtë. Po ashtu, ai nuk kërkon mbledhjen dhe publikimin e të dhënave të ndara sipas gjinisë. Prandaj, ai është **negativ nga perspektiva gjinore** pasi përforcon stereotipet dhe ruan statuskuonë që ka kontribuar në pabarazitë gjinore në qasjen në financa. Rekomandimet:

- Kërkoni mbledhjen e të dhënave për mbajtësit e llogarive, kërkesat për kredi, miratimet e kredive dhe vlerat e tyre, depozitat dhe shërbimet financiare, të ndara sipas gjinisë dhe moshës, përkatësisë etnike, vendndodhjes rurale/urbane dhe aftësisë së kufizuar, të dorëzuara rregullisht dhe të publikuara nga ASK përmes një sistemi të ndërveprueshëm.
- Përdorni gjuhë të ndjeshme gjinore.
- Kërkoni përfaqësim të balancuar gjinor në bordet e bankave në përputhje me LBGJ-në.

### **UA (GRK) Nr. 04/2024 për Tarifat për Produktet dhe Shërbimet Kadastrale Gjeodezike dhe Regjistrimit të Pronave**

Ky Udhëzim Administrativ (UA) rregullon tarifën për regjistrimin e pronës, produktet kadastrale dhe gjeodezike për të gjitha pronat e paluajtshme. Megjithatë nuk rregullon mënyrën se si fitohen të drejtat pronësore, ai rregullon shërbimet që lidhen me regjistrimin e pronës, qasjen online në sistemet e informacionit kadastral dhe shërbime të tjera digjitale.

Ai ka relevancë gjinore pasi gratë në Kosovë statistikisht kanë pronësi më të ulët të pronës dhe mund të përballen me barriera shtesë në realizimin e të drejtave të tyre pronësore, si në rastet e dhunës në familje, divorcit dhe trashëgimisë. Tarifat e regjistrimit mund të pengojnë gratë me të ardhura të ulëta ose të marginalizuara për të regjistruar pronën. Rregullimi i tarifave është i përgjegjshëm gjinor pasi neni 8 përfshijë kategori të caktuara

---

Shihni, për shembull, [Shoqatën e Bankave të Kosovës dhe Doracakun për Barazi Gjinore dhe Përfshirje Sociale \(BGJPS\)](#) për sektorin bankar, i cili rekomandon përmirësimin e mundësive për gratë dhe grupet e nënpërfaqësuar për të marrë pjesë dhe për të udhëhequr në institucionet bankare, në kontekstin e pabarazive gjinore.

nga tarifat, duke përfshirë nënat vetushqyese, personat që marrin asistencë sociale dhe në mënyrë specifike gratë, personat me aftësi të kufizuara, viktimat e dhunës në familje (por jo formave të tjera), dhe të mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë luftës. Kërkesa e vetme është që individët të paraqesin dëshmi që i përkasin kategorive të përjashtuara. Kjo mund të paraqesë rrezik në qasjen në dokumentacion, veçanërisht nëse ai mbahet nga anëtarë të tjerë (meshkuj) të familjes (p.sh., asistencë sociale shpesh regjistrohet në emër të burrave).<sup>60</sup> Kërkesa për paraqitjen e kësaj dëshmie gjithashtu mund të cenojë parimin “vetëm një herë”, pasi këto të dhëna duhet të jenë tashmë të disponueshme në llogaritë e aplikuesve në eKosova, duke shmangur nevojën për dorëzim të dokumenteve shtesë. Ndërsa UA është i **përgjegjshëm gjinor**, ndikimi i tij varet nga ndërjegjësimi dhe qasja në këto përjashtime. UA nuk kërkon mbledhjen dhe raportimin e të dhënave të ndara sipas gjinisë. Rekomandimet:

- Kërkoni raportim të rregullt të të dhënave mbi regjistrimin e pronës sipas gjinisë dhe përjashtimet nga tarifat, të ndara sipas gjinisë dhe moshës, vendndodhjes rurale/urbane, përkatësisë etnike, përfituesve të asistencës sociale, të mbijetuarve të dhunës me bazë gjinore, nënave vetushqyese dhe aftësisë së kufizuar, tek ASK për publikim të menjëhershëm përmes ndërveprueshmërisë.
- Vendosni ulje të tarifave për regjistrimin e parë të pronës për të gjitha gratë, me qëllim rritjen e përqindjes së pronës së regjistruar në emër të grave.
- Zgjeroni përjashtimet nga tarifat për të përfshirë të mbijetuarit e të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore dhe jo vetëm të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës dhe dhunës në familje
- Përmirësoni ndërveprueshmërinë dhe zbatimin e parimit “vetëm një herë”, në mënyrë që aplikuesit të mos kenë nevojë të dorëzojnë dëshmi shtesë që tashmë mbahen nga shteti, si p.sh. dëshmi për përfitimin e asistencës sociale.
- Rregulloni më qartë që informacioni mbi përjashtimet të specifikohet qartë për aplikantët.

#### **UA (MMPHI) Nr. 06/2024 për Dhënien e Lejeve për Kompanive Gjeodezike dhe Licencimin e Gjeodetëve**

Ky Udhëzim Administrativ (UA) përcakton kërkesat, procedurat dhe standardet për lejet për kompanitë gjeodezike, licencimin e gjeodetëve dhe tarifat. Ai gjithashtu rregullon Komisionin për Dhënien e Lejeve dhe Licencimit. Ky UA kufizon periudhat e aplikimit gjatë vitit në afate të shkurtra. Komisioni përpunon vetëm deri në katër kërkesa në vit dhe aplikimi bëhet përmes dokumenteve fizike; nëse ndonjë dokument mungon, aplikimi i paplotë refuzohet.

Këto kërkesa mund të ndikojnë në mënyrë disproporcionale tek gratë për shkak të ndërprerjeve në karrierë, qasjes në dokumente, aranzhimeve të punës dhe përgjegjësisë të kujdesit, të cilat e bëjnë më të vështirë aplikimin brenda afateve kaq të rrepta. Gjithashtu, tarifa e lartë pas miratimit të licencës arrin në 300 €, që mund të përbëjë pengesë për gratë që statistikisht fitojnë më pak se burrat dhe kanë më pak qasje në financa.<sup>61</sup> Licencat dhe lejet mund të shkarkohen në mënyrë digjitale dhe të pranohen edhe në formë fizike. Kjo sugjeron një mundësi të pashfrytëzuar për të bashkëngjitur dokumentet e kërkuara gjatë procesit të aplikimit për të reduktuar barrën administrative. Një masë e përgjegjshme gjinore lejon pezullimin e licencës me vlefshmëri pesëvjeçare me kërkesë të gjeodetit të licencuar në rast të pushimit të lehonisë. Periudha e pezullimit është një vit, e cila nuk i jep gjeodetit mundësinë për të përcaktuar vetë kohëzgjatjen e pezullimit. Për shembull, një grua mund të dëshirojë të marrë më pak kohë pushim, siç parashihet nga Ligji i Punës që lejon pushimin e lehonisë nga gjashtë muaj deri në një vit. Në përgjithësi, ndërsa dispozitat janë kryesisht neutrale ndaj gjinisë, një prej tyre është e përgjegjshme gjinore dhe ekzistojnë barrierat e tërthorta gjinore që mund të çojnë në rezultate negative gjinore. Rekomandimet:

<sup>60</sup> KWN, *Buxhetimi për Mirëqenie Sociale*, 2018.

<sup>61</sup> Shih, për shembull, Oda Ekonomike e Grave të Kosovës, “*Gratë në Biznes*”, 2014.

- Ndryshoni procesin e aplikimit për të pasur më shumë fleksibilitet në kohën e kërkesave, si p.sh. përpunim të vazhdueshëm të kërkesave. Ofroni mundësinë për të ngarkuar dokumentet e kërkuara përmes eKosova ose një sistemi elektronik.
- Ulni tarifat ose ofroni masa afirmative për grupe të caktuara që kanë qasje të kufizuar në financa, duke përfshirë gratë.
- Ndryshoni nenin 22 (par. 2) në mënyrë që gjeodetët e licencuar të mund të përcaktojnë kohëzgjatjen e pezullimit për pushimin e lehonisë.

### **UA (MINT) Nr. xx/2025 për Procedurat për Futjen e të Dhënave në Regjistrin e Pronarëve Përfitues**

Qëllimi është të rregullojë procedurat se si të dhënat futen në Regjistrin e Pronarëve Përfituesve nga Regjistri i Bizneseve dhe Organizatave Jofitimprurëse. Ai përcakton mënyrën e funksionimit të Regjistrit të Pronarëve Përfituesve. Ai ka relevancë të ulët për barazinë gjinore për shkak të natyrës së tij teknike. Ndërsa më shumë burra kanë tendencë të jenë pronarë të bizneseve, gratë janë të përfaqësuara mirë në mesin e udhëheqësve të organizatave jofitimprurëse. Disa gra dhe grupe të caktuara socio-demografike mund të kenë nevojë për mbështetje gjatë regjistrimit. UA përdor gjuhë të anshme gjinore në shqip dhe serbisht, duke iu referuar vetëm burrave si pronarë të bizneseve. Ai nuk kërkon që regjistri dhe të dhënat të ndahen sipas gjinisë dhe faktorëve të tjerë socio-demografikë, në përputhje me kërkesat e LBGJ-së. UA në përgjithësi është **neutral ndaj gjinisë**, por mund të promovojë stereotipe **gjinore negative**. Rekomandimet:

- Kërkoni që regjistri të mbledhë dhe raportojë rregullisht përmes sistemeve të ndërveprueshme tek ASK të dhëna mbi pronarët dhe grupet përkatëse, të ndara sipas gjinisë dhe moshës, përkatësisë etnike, vendndodhjes rurale/urbane, aftësisë së kufizuar dhe/ose faktorëve të tjerë socio-demografikë.
- Siguroni përdorimin e gjuhës neutrale gjinore për të mos promovuar stereotipe gjinore.
- Ofroni mbështetje fizike për organizatat joqeveritare të udhëhequra nga gra për të mundësuar qasje më të lehtë.

### **Koncept dokument për qëndrim dhe vendbanim**

Qëllimi është të bëhet një vlerësim i ndikimit të kornizës legjislative lidhur me qëndrimin dhe vendbanimin në Kosovë, duke identifikuar boshllëqet ligjore që do të mundësonin një regjistër gjithëpërfshirës të adresave për qëndrim dhe vendbanim.

Megjithëse Manuali për Hartimin e Koncept Dokumenteve ofron modele të mjeteve për Vlerësimin e Ndikimit në Barazinë Gjinore (VNBGJ), ato nuk janë bashkëngjitur si shtojca, duke sugjeruar se nuk është kryer një VNBGJ. Prandaj, opsioni i propozuar për hartimin e një ligji të ri për qëndrim dhe vendbanim nuk merr parasysh se qasja në lejet e qëndrimit dhe vendbanimit mund të jetë më sfiduese për gratë, veçanërisht për gratë migrante dhe kategoritë e cenueshme, për shkak të faktorëve si arsimit, mosha, mjetet financiare, (pa)punësia ose puna joformale dhe varësia ekonomike nga të tjerët, ndër faktorë të tjerë. Ai nuk vlerëson në mënyrë të mjaftueshme qasjen në të drejta dhe shërbime duke përdorur analizën e ndjeshme gjinore. Për shembull, ai nuk merr parasysh situatat kur gratë e divorcuara nuk mund të sigurojnë leje qëndrimi nëse aplikimi ka qenë i bazuar në ribashkimin familjar ose nëse ato janë ekonomikisht të varura nga ish-partnerët e tyre. Ndërsa Rregullorja Nr. 17/2024 e Punës së Qeverisë parasheh që koncept dokumentet të kenë një proces konsultimi para publikimit për konsultim publik me subjektet brenda ZKM-së, ajo nuk tregon se koncept dokumenti duhet të dërgohet për konsultim në ABGJ. Koncept dokumenti gjithashtu liston grupin punues që e ka hartuar, por nuk specifikon nëse gjatë hartimit ka përfshirë ndonjë zyrtar për barazi gjinore dhe nuk liston mjetin e përdorur në shtojcë. Ky mjet, sipas Udhëzimeve dhe Manualit, do të duhej të ishte bashkëngjitur si shtojcë, në mënyrë që lexuesi të kuptojë pse i vetmi ndikim gjinor i listuar ishte mbledhja e të dhënave të ndara sipas gjinisë. Të gjithë këta faktorë kanë kontribuar në një vlerësim jo të duhur të nevojave të grave dhe rreziqeve lidhur me kërkesat

për qëndrim. Prandaj, megjithëse koncepti dokumenti është **neutral** ndaj gjinisë, ai mund të ketë ndikime **negative gjinore**. Rekomandimet:

- Kryeni një VNBGGJ për të siguruar që analiza gjinore të informojë për opsionet e propozuara dhe që këto të adresojnë barrierat dhe pabarazitë gjinore të identifikuara në realizimin e të drejtës për qëndrim.
- Kërkonte konsultim me ABGGJ-në gjatë hartimit të konceptit dokumenteve dhe siguron mbledhjen dhe përdorimin e të dhënave të ndara sipas gjinisë për hartim të politikave të bazuar në dëshmi.
- Siguroni që grupi punues që përgatit konceptin dokumentin të përfshijë një ekspert të barazisë gjinore ose një zyrtar për barazi gjinore.
- Bashkëngjitni të gjitha modelet e VNBGGJ-së si shtojca në dokumentin e publikuar dhe siguron që analiza gjinore të përfshijë vëmendje ndaj ndërsektorialitetit.
- Siguroni që regjistri i ri të kërkojë të dhëna të ndara sipas gjinisë dhe moshës, përkatësisë etnike, shtetësisë, aftësisë së kufizuar dhe faktorëve të tjerë socio-demografikë. Ai duhet të jetë i ndërveprueshëm me ASK-në, duke mundur qasje në kohë reale në të dhëna të ndara sipas gjinisë.

### **Projektligji për Veterinarisë**

Qëllimi është të rregullojë kornizën ligjore për aktivitetet dhe shërbimet veterinare për të mbrojtur shëndetin e kafshëve dhe njerëzve, duke garantuar sigurinë e ushqimit dhe produkteve me origjinë shtazore. Aktivitetet përfshijnë licencimin e veterinerëve, inspektimet, tarifën dhe raportimin. Ai gjithashtu rregullon Odën e Veterinerëve dhe Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë. Projektligji rregullon qasjen në licenca, veterinerët e vetëpunësuar dhe bizneset e vogla, duke përfshirë aktivitetet e ndryshme bujqësore, siç janë prodhimi i ushqimit dhe produkteve me origjinë shtazore. Lejet, regjistrimi, inspektimet, tarifën dhe raportimi i aktiviteteve bujqësore rregullohen në Projektligj.

Ai ka relevancë të lartë gjinore pasi gratë angazhohen në këtë treg, duke përfshirë në fermat e vogla familjare dhe si operatore, si në mënyrë formale ashtu edhe joformale. Tarifën për licencim, rinovim, anëtarësim dhe kostot e tjera paguhen nga aplikanti ose operatori bujqësor pa ndonjë përjashtim apo zbritje për operatorët më të vegjël ose ata të cenueshëm. Projektligji obligon përdorimin e sistemit elektronik për raportim dhe regjistrim të të dhënave, por nuk e bën të detyrueshëm në mënyrë të qartë raportimin e të dhënave të ndara sipas gjinisë. Gratë nga zonat rurale me arsim të kufizuar, aftësi të ulëta digjitale apo qasje të kufizuar digjitale mund të përballen me barrierë shtesë. Projektligji nuk i adreson në mënyrë adekuate ndikimet që mund të ketë tek grupet e cenueshme, duke përfshirë gratë. Ai gjithashtu nuk vendos masa për të adresuar informalitetin (i cili është shumë i ndikuar nga gjinia) si pjesë e regjistrimit dhe inspektimeve, si p.sh. kërkesën për inspektimin e anëtarëve të familjes që punojnë, punësimin e tyre dhe të drejtat e punës. Po ashtu, nuk parashikon masa të përgjegjshme gjinore si periudha kalimtare për përdorimin e sistemit, asistencë teknike fizike apo afate më të gjata për dorëzimin e aplikimeve. Sanksionet e larta për mosrespektim mund të përkeqësojnë nivelet e informalitetit, duke prekur më shumë gratë sesa burrat. Prandaj, ndonëse është formalisht **neutral ndaj gjinisë**, Projektligji rrezikon të krijojë barrierë për licencim dhe formalizim të aktiviteteve veterinare dhe bujqësore të grave dhe grupeve të tjera të cenueshme, duke përforcuar potencialisht pabarazitë gjinore në informalitet. Ndikimet mund të jenë **negative në aspektin gjinor**. Rekomandimet:

- Përfshini në inspektime kërkesën që anëtarët e familjes të angazhuar në bizneset familjare të regjistrohen me kontrata pune, pagesë, kontribute pensionale dhe të drejta të punës. Kërkonte që inspektorët të trajtohen në qasje të përgjegjshme gjinore në inspektime, duke marrë parasysh pabarazitë gjinore dhe shkeljet e të drejtave brenda familjeve dhe mënyrën e adresimit të tyre në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme gjinore.

- Vendosni masa lehtësuese si ulja e sanksioneve dhe tarifave për operatorët në shkallë të vogël.
- Vendosni periudha kalimtare dhe asistencë personale për të mbështetur mësimin dhe përdorimin e sistemeve digjitale; siguroni që sportelet e shërbimit të kenë këto shërbime të disponueshme, duke përfshirë kompjuterë dhe mjete digjitale për personat që nuk i posedojnë ato, si dhe burime njerëzore të trajnuara në qasje të përgjegjshme gjinore për të mbështetur përdoruesit e ndryshëm në regjistrim.
- Kërkoni mbledhjen e të dhënave të ndara sipas gjinisë dhe moshës, përkatësisë etnike, vendndodhjes rurale/urbane, aftësisë së kufizuar dhe faktorëve të tjerë socio-demografikë, të ndara dhe të shpërndara automatikisht tek ASK përmes sistemeve të ndërveprueshme, duke mundësuar shikim dhe analizë në kohë reale të të dhënave.

### **Koncept dokumenti për veprimtaritë kërkimore-shkencore dhe inovacion**

Qëllimi është të vlerësohen ndikimet rregullatore, ekonomike, sociale dhe administrative të opsioneve të politikave për përmirësimin e kornizës ligjore për veprimtarinë kërkimore-shkencore dhe inovacionin në Kosovë. Dokumenti thekson se ka përfshirë komunikim me institucione, duke përfshirë ABGJ-në. Ai ka relevancë gjinore pasi gratë, veçanërisht ato nga grupet e margjinalizuara, mund të përballen me barriera shtesë në pjesëmarrjen në kërkimin shkencor. Ai identifikon barazinë gjinore dhe gjithëpërfshirjen si parime dhe i liston ato si objektiv për t'u harmonizuar me standardet e Zonës Evropiane Kërkimore. Ai përmend programe për barazi gjinore.

Kjo qasje e ndjeshme gjinore mbetet kryesisht në nivelin e parimeve që udhëheqin hartimin e dokumentit. Megjithatë dokumenti e njeh rëndësinë e përfshirjes dhe barazisë gjinore, ai thekson se opsionet e propozuara dhe të rekomanduara nuk do të kenë asnjë ndikim gjinor. Ai nuk përdor mjetin e paraparë në Manualin për Hartimin e Koncept Dokumenteve, ndonëse ky Manual në mënyrë specifike e liston shkencën, kërkimin dhe teknologjinë si fusha relevante për VNBGJ. Dokumenti nuk e përfshin VNBGJ-në siç kërkohet nga Manuali. Ai nuk ofron të dhëna të ndara sipas gjinisë për hulumtuesit, stafin akademik, barrierat apo mënyrën se si opsionet do të ndikojnë tek gratë në kërkim. Mungesa e një raporti të VNBGJ kufizon aftësinë për të përcaktuar nëse opsionet e propozuara adresojnë në mënyrë efektive pabarazitë gjinore në qasjen në mundësitë për kërkim dhe inovacion. Duke i trajtuar ndikimet gjinore si neutrale, opsioni i propozuar rrezikon të ruajë pabarazitë ekzistuese gjinore në kërkim dhe inovacion. Opsioni do të mund të krijonte stimuj në rastet kur gratë hulumtuese janë të nënpërfaqësuar dhe të reduktonte barrierat gjinore. Rekomandimet:

- Përdorni mjetet e detyrueshme të VNBGJ-së të ofruara në Manualin për Hartimin e Koncept Dokumenteve (fq. 115).
- Siguroni që grupi punues që zhvillon koncept dokumentin të përfshijë një ekspert/e të barazisë gjinore ose një zyrtar për barazi gjinore.
- Siguroni që VNBGJ të përfshijë vëmendje ndaj ndërsektorialitetit. Përdoreni atë për të përfshirë në dokument të dhëna të ndara sipas gjinisë dhe kategorive të tjera socio-demografike, duke dhënë informacion për përmbajtjen e tij.
- Përfshini masa afirmative për të adresuar pabarazitë në kërkim dhe inovacion.

### **Koncept dokumenti për bujqësinë organike**

Qëllimi është të vlerësohen ndikimet e opsioneve të politikave për të rregulluar prodhimin organik, certifikimin, etiketimin dhe sistemin, duke përafuar Kosovën me standardet e BE-së për prodhimin organik. Nga perspektiva e ZBA-së, ai adreson certifikimin, sistemet e inspektimit dhe qasjen në bujqësi organike.

Ai ka relevancë gjinore, pasi gratë marrin pjesë në ferma të vogla dhe ferma familjare, shpesh në mënyrë joformale. Prandaj, procedurat që rregullojnë certifikimin organik të produkteve dhe regjistrimin duhet të marrin parasysh aftësitë digjitale, kohën e kufizuar të grave dhe nivelin e lartë të informalitetit. Dokumenti nuk ofron të dhëna të ndara sipas gjinisë për fermerët, prodhuesit, pronësinë e tokës, qiratë e tokës apo trashëgiminë, gjë që mund të

pengojë angazhimin e grave të ndryshme në këtë sektor. Po ashtu, ai nuk ka përdorur VNBGJ-në e detyrueshme për të informuar për dizajnin e tij. Megjithëse dokumenti është **neutral ndaj gjinisë**, procedurat uniforme rrezikojnë të bëhen pengesa për qasje ose të përforcojnë nivelin e lartë të informalitetit, gjë që mund të ketë ndikime negative gjinore. Identifikimi dhe adresimi i pabarazive gjinore mund të rrisë pjesëmarrjen e grave të ndryshme në bujqësi organike, të adresojë ekonominë joformale dhe të kontribuojë në përmirësimin e rezultateve ekonomike për gratë dhe familjet e tyre. Rekomandimet:

- Përdorni mjetet e detyrueshme të VNBGJ-së në Manualin për Hartimin e Koncept Dokumenteve për të vlerësuar dhe adresuar pabarazitë gjinore.
- Siguroni që grupi punues i dokumentit të përfshijë një ekspert të barazisë gjinore ose një zyrtar për barazi gjinore.
- Siguroni që ligji të kërkojë mbledhjen dhe raportimin në kohë reale të të dhënave të ndara sipas gjinisë për bujqësinë organike, përfituesit e tokës, pronarët e tokës dhe prodhimin organik tek ASK përmes sistemeve të ndërveprueshme.
- Adresoni çështjet e qasjes digjitale duke ofruar asistencë fizike për të lehtësuar regjistrimin.

### ***Projekt Udhëzimi Administrativ për Procedurën e Dhënies, Rinovimit, Pezullimit dhe Revokimit të Licencave për Ofruesit e Shërbimeve Sociale dhe Familjare***

Projekt UA përcakton procedurën për aplikimin për licenca në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare, si dhe pezullimin, revokimin e licencave, procedurën e ankesës dhe tarifat për licencim. Ai synon të standardizojë kërkesat dhe të forcojë mbikëqyrjen e ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare përmes procedurave dhe inspektimeve të qarta.

Ai ka relevancë të lartë gjinore pasi shërbimet sociale dhe familjare ofrohen kryesisht nga gratë dhe përdoren kryesisht nga gratë, të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore, gratë e moshuara, nënat vetushqyese dhe personat me aftësi të kufizuara, ndër të tjera. . Neni 5 përcakton se të gjithë aplikantët do të duhet të dorëzojnë kërkesat e tyre për licencim në mënyrë elektronike pas themelimit të sistemit elektronik të aplikimit. Gratë mund të përballen me barriera shtesë në dorëzimin e aplikimeve online, të lidhura me qasjen në mjete digjitale dhe njohuritë përkatëse. Nëse një kërkesë për licencim refuzohet, aplikanti duhet të presë gjashtë muaj për të riaplikuar. Veçanërisht në rastet kur aplikantët bëjnë gabime ose lënë diçka pa dashje, kjo mund të disfavorizojë gratë me aftësi të kufizuara digjitale. Projekt UA kërkon dokumentacion të gjerë, infrastrukturë dhe staf, gjë që mund të ndikojë në mënyrë disproporcionale tek OJQ-të e udhëhequra nga gratë, strehimoret apo iniciativat e drejtuara nga komuniteti, të cilat mund të kenë më pak financim, hapësira më të vogla, kapital të kufizuar ose infrastrukturë të dobët, veçanërisht në zonat rurale. Pas dhënies, licencat janë të vlefshme për tri vite me mundësi rinovimi për pesë vite shtesë; kjo kufizon aktivitetin e shërbimeve të ofruara në tetë vite. Kjo mund të ndikojë në cilësinë e shërbimeve të ofruara duke mos lejuar ofruesit me përvojë të vazhdojnë të ofrojnë shërbime, gjë që është veçanërisht relevante për shërbimet për të mbijetuarit e dhunës me bazë gjinore.

Dokumentet e kërkuara për licencim përfshijnë dëshminë se personi nuk ka borxhe ndaj Administratës Tatimore të Kosovës dhe pasqyra financiare për rinovimin e licencës. Këto mund të paraqesin pengesë për gratë që kanë më pak qasje në kapital. Procedura e pezullimit nuk specifikon një afat kohor. Pezullimi i licencës pa kohë të mjaftueshme për përmirësimin e çështjeve të identifikuar mund të ndërpresë vazhdimësinë e shërbimeve, duke ndikuar në cilësinë e tyre. Kjo është veçanërisht relevante për viktimat e dhunës me bazë gjinore, të cilat mund të mbesin pa këto shërbime thelbësore. Projekt UA nuk përmban dispozita që sigurojnë vazhdimësinë e shërbimeve, gjë që mund të dëmtojë gratë që i përdorin këto shërbime. Sa i përket regjistrimit të të dhënave që do të mbahet nga Ministria e Drejtësisë, nuk specifikohet që ai do të përmbajë të dhëna të ndara sipas gjinisë në mënyrë ndërsektoriale. Në këtë mënyrë, UA është neutral ndaj gjinisë, por mund të ketë ndikime negative gjinore. Rekomandimet:

- Ofroni mundësi të asistuarra për aplikim dhe udhëzime për aplikantët me aftësi të kufizuara digjitale.
- Vendosni kërkesa të përgjegjshme gjinore për licencim, proporcionale me zonën e themelimit, madhësinë, kapacitetin dhe shërbimin e ofruar.
- Rregulloni procedurat për aplikimet elektronike të paplota (njoftoni aplikantin) dhe hiqni ndalimin gjashtëmujor për riaplikim në rastet e gabimeve teknike ose mungesës së dokumentacionit.
- Parashihni një periudhë lehtësuese për përmirësimin e çështjeve të identifikuara para pezullimit. Shtoni dispozita për të siguruar vazhdimësinë e shërbimeve në rast të revokimit ose pezullimit të licencave.
- Kërkoni që regjistri i të dhënave për ofruesit e shërbimeve sociale dhe familjare të përfshijë të dhëna të ndara sipas gjinisë në mënyrë ndërsektoriale, në përputhje me kërkesat për mbrojtjen e të dhënave dhe të ndahen me ASK-në në kohë reale përmes ndërveprueshmërisë.
- Hiqni kufizimet mbi numrin maksimal të viteve për të cilat licencat mund të rinovohen, pasi ofruesit e kualifikuar duhet të jenë në gjendje të rinovojnë licencat në mënyrë të vazhdueshme.

### ***Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2024 për Bashkëpagesat për Shërbimet Shëndetësore***

Ky Udhëzim Administrativ (UA) rregullon bashkëpagesat për shërbimet shëndetësore, përjashtimet, përfituesit e përjashtimeve, si dhe procedurat e pagesës dhe rimbursimit në sektorin publik shëndetësor. UA ka relevancë të lartë gjinore pasi gratë mund të përballen me barriera më të mëdha në qasjen në shërbimet publike shëndetësore sesa burrat, veçanërisht gratë nga zonat rurale dhe komunitetet pakicë. Bashkëpagesat, përjashtimet dhe procedurat e pagesës mund të prodhojnë ndikime të diferencuara gjinore për gratë. Përfituesit e përjashtuar nga bashkëpagesat përfshijnë personat e zhvendosur me forcë nga shtëpitë e tyre, siç janë viktimat e dhunës në familje dhe trafikimit të qenieve njerëzore. Megjithatë, ky përjashtim zbatohet vetëm për vitin e parë pas regjistrimit zyrtar. Gratë përbëjnë shumicën dërrmuese të të mbijetuarve të dhunës me bazë gjinore dhe koha e nevojshme për rikuperim dhe riintegrim mund të ndryshojë ndjeshëm për secilën grua. Disa ndikime shëndetësore të dhunës janë afatgjata. Prandaj, kohëzgjatja e përjashtimit duhet të bazohet në nevojë, e vlerësuar nga punëtorët socialë në planet e menaxhimit të rasteve, deri në momentin kur viktima është riintegruar plotësisht në tregun e punës dhe mund të përballojë pagesat.

Një dispozitë kalimtare parashikon përjashtimin e grave nga bashkë-pagesat për shërbimet që lidhen me shtatzëninë dhe lehoninë, mamografinë dhe PAP testet. Megjithatë, UA nuk specifikon se si personat/gratë që i përkasin këtyre kategorive verifikojnë statusin e tyre. Kjo mund të përfshijë kohë shtesë dhe vështirësi në sigurimin e dëshmimeve përkatëse. Gjithashtu, UA nuk kërkon që të dhënat për përdoruesit, duke përfshirë për secilën kategori të përjashtuar, frekuencën e përdorimit të shërbimeve apo ndikimet e bashkë-pagesave, të ndahen sipas gjinisë dhe kategorive të tjera socio-demografike. Kjo mund të kufizojë monitorimin e ndikimeve në barazinë gjinore. Në përmbledhje, UA përmban disa masa të **ndjeshme gjinore**, por mund të bëhet më i përgjegjshëm gjinor. Rekomandimet:

- Ndryshoni periudhën njëvjeçare të përjashtimit për viktimat e dhunës në familje dhe trafikimit, duke e ndërlidhur përjashtimin me rezultatet e riintegrimin në planet e menaxhimit të rasteve, siç është stabiliteti ekonomik.
- Specifikoni mënyrën se si individët që i përkasin kategorive të përjashtuara verifikojnë statusin e tyre duke përdorur parimin “vetëm një herë”, duke shmangur barrën administrative që mund të pengojë qasjen.
- Përfshini në mënyrë eksplicite strehimoret për gratë dhe institucionet e tjera specifike për mbrojtje gjinore në listën e institucioneve shtetërore të përjashtuara në nenin 5.

- Kërkoni mbledhjen e të dhënave të ndara sipas gjinisë dhe moshës, përkatësisë etnike, vendndodhjes rurale/urbane, aftësisë së kufizuar dhe kategorisë së përjashtimit për përfituesit, frekuencën e përdorimit të shërbimeve dhe ndikimin financiar.

### **Koncept dokumenti për qeverisjen dhe menaxhimin e arsimit dhe aftësimin profesional**

Dokumenti vlerëson ndikimet e pritshme ekonomike, sociale, administrative dhe institucionale të opsioneve të politikave që lidhen me arsimin dhe aftësimin profesional (AAP), duke përfshirë efektet në punësim, qasjen në trajnim, mësimin gjatë gjithë jetës dhe zhvillimin e fuqisë punëtore.

Ai ka relevancë të lartë gjinore pasi AAP ndikon në qasjen në tregun e punës dhe normat e pjesëmarrjes së grave në fuqinë punëtore janë më të ulëta në Ballkanin Perëndimor. Kjo pabarazi nuk është analizuar siç duhet në dokument. Opsioni i propozuar është reformimi i strukturës institucionale të AAP-së dhe Agjencisë Kombëtare të Kualifikimeve në Kosovë përmes ndryshimit të ligjeve individuale dhe hartimit të një ligji të ri. Dokumenti thekson se opsioni i propozuar do të rrisë potencialin e punësimit të kategorive që nuk kanë kualifikime dhe që kanë nevojë për trajnim për të ruajtur vendin e punës ose për t'u avancuar në vendet e tyre të punës. Ai nuk përfshin analizë gjinore për të informuar ligjin, si p.sh. për të rritur potencialin e punësimit të grave të ndryshme. Ai dështon të adresojë faktin që gratë përballen me diskriminim në arsim dhe punësim, si dhe sfida për shkak të përgjegjësisë të kujdesit (koha për trajnim) në kushte të programeve jofleksibile të AAP-së, shqetësimeve për siguri, kufizimeve në transport, mbështetjes së pamjaftueshme financiare dhe ndonjëherë pengesave nga familja që minojnë aftësinë e tyre për të ndjekur kualifikime. Po ashtu, nuk përmenden stereotipet gjinore profesionale në AAP apo mënyrat se si do të adresohen ato. Dokumenti nuk ka përfshirë VNBGJ-në e detyrueshme për të identifikuar dhe adresuar këto çështje. Ai përmban vetëm një tabelë me të dhëna të ndara sipas gjinisë, e cila mungon në të dhëna dhe analizë ndërsektoriale. Gratë e ndryshme mund të përballen me nivele të shumta pabarazie që pengojnë qasjen e tyre në AAP ose punësim, siç janë gratë që rikthehen në tregun e punës, nënat, dhe gratë rurale, të reja nga komunitetet pakicë dhe me aftësi të kufizuara. Mungesa e qasjes në AAP mund të përforcojë normat e tyre të ulëta të pjesëmarrjes në tregun e punës. Prandaj, dokumenti dhe projektligji **neutral ndaj gjinisë** rrezikojnë të ruajnë pabarazitë ekzistuese gjinore në qasjen në AAP dhe punësim. Rekomandimet:

- Kryeni VNBGJ-në e detyrueshme për të identifikuar pabarazitë gjinore të mundshme në qasjen në AAP dhe përdorni gjetjet për të ofruar informacion për dokumentin dhe projektligjin.
- Kërkoni mbledhjen e të dhënave të ndara sipas gjinisë dhe faktorëve të tjerë socio-demografikë, si moshë, përkatësia etnike, zona rurale/urbane, gjuha, përgjegjësitë e kujdesit, mjetet financiare dhe sfidat e transportit për grupet e synuara dhe përfituesit e AAP-së, duke mundësuar hartimin e masave afirmative. Raportoni në kohë reale në ASK përmes sistemeve të ndërveprueshme.
- Vlerësoni procedurat e regjistrimit, fushatat e ndërgjegjësimit, oraret e trajnimeve dhe elementet e tjera të ndërlidhura me dokumentet për të analizuar se si ato mund të ndikojnë në mënyrë disproporcionale tek gratë e ndryshme, veçanërisht nga grupet e marginalizuara. Përfshini masa afirmative për të adresuar këto çështje.

### **Koncept dokumenti për përmbajtjen digjitale, shërbimet digjitale dhe shitjen e mallrave**

Dokumenti vlerëson ndikimet ekonomike, sociale dhe administrative për të rekomanduar opsionin më të mirë të politikave për forcimin e mbrojtjes së konsumatorit dhe mbështetjen e zhvillimit të tregut digjital në Kosovë. Opsioni i politikës që ai rekomandon është transpozimi i Direktivave të BE-së 2019/770 dhe 2019/771 në Rregulloren për Përmbajtjen Digjitale, Shërbimet Digjitale dhe Shitjen e Mallrave, me qëllim harmonizimin e të drejtës kontraktuale të konsumatorit me standardet e BE-së lidhur me përmbajtjen digjitale, shërbimet

dhe mallrat. Kjo do të prezantonte të drejta të reja, detyrime, mekanizma zbatimi dhe kërkesa për përputhshmëri për bizneset dhe konsumatorët.

Dokumenti është **neutral ndaj gjinisë** dhe pohon se gjatë procesit të hartimit dhe hulumtimit grupi punues nuk ka identifikuar ndikime gjinore; nuk përmendet VNBGJ. Relevanca gjinore është e ulët, pasi rregullorja do të rrisë mbrojtjen e konsumatorit në përgjithësi. Duke qenë se konsumatorët e prekur tashmë blejnë online, supozohet se ata kanë qasje dhe aftësi digjitale për të paraqitur ankesa. Mungesa e të dhënave të ndara sipas gjinisë nuk mundëson matjen e nivelit të pjesëmarrjes së grave në ndërmarrësi digjitale dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme që shesin produkte online. Detyrimet dhe rregullat e reja kontraktuale do të ndikojnë në të gjitha NVM-të që operojnë dhe shesin produkte online ose ofrojnë shërbime digjitale. Ndikimet nuk paraqesin domosdoshmërisht rrezik për barriera të diferencuara gjinore. Megjithatë, gjatë zbatimit, gratë dhe burrat e ndryshëm kanë nevoja të ndryshme në qasjen në informacion lidhur me reformat, dhe dokumenti nuk i kushton vëmendje ndërgjegjësimit të përgjegjshëm gjinor. Rekomandimet:

- Parashihni fushata ndërgjegjësuëse dhe udhëzuese të përgjegjshme gjinore, thjeshtim dhe masa mbështetëse që synojnë gratë dhe burrat e ndryshëm, duke lehtësuar zbatimin.
- Mblidhni të dhëna të ndara sipas gjinisë dhe treguesve të tjerë socio-demografikë lidhur me ankesat, mbikëqyrjen e tregut, produktet dhe shërbimet për të kuptuar më mirë pabarazitë e mundshme gjinore në treg. Siguroni ndarjen e të dhënave në kohë reale me ASK-në për publikim përmes sistemeve të ndërveprueshme.

#### Përmbledhje e gjetjeve bazuar në VNBGJ të ABGJ-së

Koncepti dokumenti/akti ligjor	Qëllimi i politikës	Relevanca për barazi gjinore	Analiza gjinore: Situata e grupeve të prekura	Analiza gjinore: Si duhet të avancohet barazia gjinore	Si do të ndikojë në barazinë gjinore	Rekomandimet për eliminimin e ndikimeve negative dhe përmirësimin e atyre pozitive
<b>UA (QRK) Nr. 10/2023 për Licencimin e Profesionistëve të Huaj Shëndetësorë</b>	Të rregullohen procedurat dhe kushtet për licencimin, rilicencimin dhe angazhimin e profesionistëve të huaj shëndetësorë në Kosovë.	Mesatare deri e lartë. Gratë priren të jenë të mbipërfaqësuar në sektorin e shëndetësisë. Kërkesat administrative, kostot, kushtet që lidhen me migrimin dhe lejet e punës mund të ndikojnë ndryshe tek gratë dhe burrat.	Dispozitat mund të ndikojnë në mënyrë indirekte më shumë tek gratë sesa tek burrat. Profesionistet shëndetësore gra, veçanërisht ato me përgjegjësi për kujdesin ndaj fëmijëve, nga vendet me të ardhura të ulëta ose me ndërprerje në karrierë për shkak të shtatzënisë, mund të përballen me sfida më të mëdha për shkak të procedurave të gjata dhe komplekse administrative, kërkesave të gjera për	Duhet të parashikohet fleksibilitet në vlerësimin e përvojës profesionale kur ndërprerjet lidhen me lehoninë, kujdesin ndaj fëmijëve apo përgjegjësitë familjare. Procedurat administrative duhet të thjeshtohen dhe barra financiare të rishikohet për të parandaluar diskriminimin indirekt. Duhet të përdoret gjuhë e ndjeshme gjinore. Duhet të kërkohej	Nëse zbatohet pa përshtatje të ndjeshme gjinore, Udhëzimi rrezikon të kufizojë në mënyrë indirekte qasjen e grave në tregun e punës në sektorin shëndetësor, veçanërisht për nënat, gratë e reja dhe gratë migrante.	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Ndryshoni kërkesën për “një vit përvojë të pandërprerë” duke njohur pushimin e lehonisë si përvojë profesionale ose duke zëvendësuar “të pandërprerë” me përvojë kumulative, në përputhje me nenin 3, paragrafi 1.6 të LBGJ-së.</li> <li>● Kërkoni përfaqësim të barabartë gjinor në Borde dhe komisione në përputhje me LBGJ-në.</li> <li>● Siguroni fleksibilitet në vlerësimin e përvojës profesionale në rastet e ndërprerjeve për gratë, veçanërisht për shkak të pushimit të lehonisë.</li> <li>● Përfshini gjuhë të ndjeshme gjinore duke përdorur terminologji që i referohet si grave ashtu edhe burrave.</li> <li>● Konsideroni uljen ose përjashtimin nga tarifat për kategoritë e cenueshme, duke përfshirë gratë nga vendet me të ardhura të ulëta.</li> <li>● Kërkoni mbledhjen e të dhënave të ndara sipas gjinisë për aplikimet dhe</li> </ul>

Koncepti/dokumenti/akti/ligjor	Qëllimi i politikës	Relevanca për barazi gjinore	Analiza gjinore: Situata e grupeve të prekura	Analiza gjinore: Si duhet të avancohet barazia gjinore	Si do të ndikojë në barazinë gjinore	Rekomandimet për eliminimin e ndikimeve negative dhe përmirësimin e atyre pozitive
			dokumentacion, noterizimit dhe përkthimit të detyrueshëm me kosto dhe tarifave të larta të pakthyeshme.	balancë gjinore në bordet dhe komisionet e licencimit.		licencat e dhëna, si dhe publikimin e të dhënave të ndara sipas gjinisë dhe kategorive të tjera, në përputhje me LBGJ-në. Në drejtim të ndërveprueshmërisë, lidhni të dhënat me ASK-në për publikim automatik. <ul style="list-style-type: none"> <li>Thjeshtoni proceset e riaplikimit duke mundësuar riaplikimin online, duke minimizuar kohën e nevojshme për riaplikim. Konsideroni pranimin e noterizimit elektronik të dokumenteve origjinale për të zvogëluar kohën dhe kostot e udhëtimit.</li> </ul>
<b>UA (MPB) Nr. 12/2024 për Ndryshimin dhe Plotësimin e UA (MPB) Nr. 04/2023 për Regjistrimin e Automjeteve</b>	Ndryshon i UA Nr. 04/2023 për Regjistrimin e Automjeteve, duke përcaktuar dispozitat dhe procedurat për regjistrimin e automjeteve, llojet e regjistrimit dhe çregjistrimin në Kosovë.	Mesatare. Udhëzimi është neutral ndaj gjinisë. Disa dispozita që ndërlidhen me kërkesat për patentë të shoferit, kushtet e pronësisë dhe qasjen në shërbimet e regjistrimit mund të ndikojnë ndryshe tek gratë për shkak të hendeqev e ekzistues gjinore në posedimin e patentë shoferit, lëvizshmërinë, qasjen digjitale dhe faktorët socio-	Procedura alternative që kërkon caktimin e një përdoruesi të automjetit përmes autorizimit të noterizuar rrit kostot dhe hapat administrativë dhe krijon varësi, duke përforcuar potencialisht rolet tradicionale gjinore. Kërkesat për paraqitje fizike në Qendrat për Regjistrimin e Automjeteve (QRA) për disa procedura mund të ndikojnë në mënyrë disproporcional e tek gratë me përgjegjësi kujdesi, lëvizshmëri të kufizuar ose aftësi më të ulëta digjitale.	Bëni dallim të qartë ndërmjet pronësisë së automjetit dhe përdorimit të tij, duke lejuar regjistrimin e automjeteve në emër të pronarit pavarësisht posedimit të patentës së shoferit. Minimizoni paraqitjen e detyrueshme fizike dhe siguronit alternativa të qasshme për individët që përballen me kufizime në lëvizshmëri, kohë apo qasje digjitale.	Me këto ndryshime, ai mund të mbështesë më të barabartë të drejtave pronësore të grave dhe të rrisë përqindjen e automjeteve të regjistruara në emër të grave.	<ul style="list-style-type: none"> <li>Siguronit që masat të masat të mundësojnë regjistrimin e automjetit në emër të pronarit pa kërkuar patentë shoferin.</li> <li>Adresoni hendeqet e mundshme gjinore në qasjen digjitale për grupet e cenueshme, përfshirë personat me aftësi të kufizuara, dhe/ose ofroni mekanizma alternativë mbështetës, duke pasur parasysh se UA kërkon një kombinim të procedurave online dhe atyre me prezencë fizike. Ofroni asistencë për aplikim fizik për personat që kanë nevojë.</li> <li>Kërkoni mbledhjen dhe publikimin e rregullt të të dhënave mbi pronësinë e automjeteve, regjistrimin, çregjistrimin dhe përdorimin e shërbimeve online kundrejt atyre me prezencë fizike, të ndara sipas gjinisë dhe moshës, vendndodhjes rurale/urbane, përkatësisë etnike dhe aftësisë së kufizuar, për të identifikuar dhe adresuar barrierat dhe kostot e diferencuara gjinore. Ndërlidhni të dhënat me ASK-në përmes ndërveprueshmërisë.</li> <li>Zgjatni orarin e punës së QRA-ve në ditë të caktuara ose të shtunave për të lehtësuar qasjen për gratë dhe burrat e punësuar.</li> <li>Minimizoni paraqitjen e detyrueshme fizike dhe</li> </ul>

Koncepti/dokument/akti/ligjor	Qëllimi i politikës	Relevanca për barazinë gjinore	Analiza gjinore: Situata e grupeve të prekura	Analiza gjinore: Si duhet të avancohet barazia gjinore	Si do të ndikojë në barazinë gjinore	Rekomandimet për eliminimin e ndikimeve negative dhe përmirësimin e atyre pozitive
		ekonomikë.				siguroni alternativa të qasshme për individët që përballen me kufizime në lëvizshmëri, kohë apo qasje digjitale. Mundësoni dorëzimin e të gjithë dokumentacionit online dhe pranimin e targave përmes postës.
<b>UA (në Kujdesin Shëndetësor) Nr. 01/2025 - për Kushtet dhe Procedurat për Ushtrimin e Aktiviteve Shëndetësore në Institucionet Private</b>	Ka për qëllim të rregullojë procedurat e licencimit për shërbimet e kujdesit shëndetësor.	Neutral ndaj gjinisë. Pjesëmarrja dhe përfaqësimi i barabartë nuk adresohen në përputhje me LBGJ-në. Përmban elemente proceduralë që mund të krijojnë barrierë të tërthorta gjinore.	Gratë me njohuri të kufizuara digjitale mund të përballen me barrierë për shkak të përdorimit ekskluziv të sistemit elektronik të aplikimit. Mungesa e kërkesës për balancë gjinore në Bordin e Licencimit dhe Komisionin e Ankesave mund të kufizojë përfaqësimin e grave në vendimmarrje dhe të ndikojë në rezultatet e licencimit.	Siguroni qasje të barabartë në procedurat e licencimit duke mundësuar edhe aplikime fizike. Kërkonte përfaqësim të balancuar gjinor në Bordin e Licencimit dhe Komisionin e Ankesave.	Mund të mbështesë qasje të barabartë të grave dhe burrave në aplikimin për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor.	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mundësoni që aplikimet të dorëzohen edhe fizikisht ose me asistencë.</li> <li>Kërkonte përfaqësim të barabartë gjinor në Bordin e Licencimit të Institucioneve Shëndetësore Private dhe në Komisionin e Ankesave në përputhje me LBGJ-në.</li> </ul>
<b>Projekti i gjigj për Shoqëritë Tregtare</b>	Ka për qëllim të rregullojë themelimin, organizimin, të drejtat dhe obligimet e shoqërive tregtare dhe pronarëve, si dhe të përcaktojë mandatin e Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve	Ka relevancë të lartë gjinore pasi rregullon qasjen në pronësi të biznesit, regjistrim dhe likuidim. Këto janë fusha ku ekzistojnë hendeqe strukturore gjinore, duke pasur parasysh nënpërfaqësimin e grave si pronare të biznesit.	Gratë preken pasi ato zakonisht zotërojnë ndërmarrje të vogla dhe të mesme. Gratë nga grupet e marginalizuara dhe pakicat përballen me barrierë administrative për shkak të kohës së kufizuar, burimeve financiare, aftësive digjitale dhe qasjes në sistemet digjitale. Regjistrimi online është i disponueshëm në gjuhën shqipe pa	Adresoni barrierat strukturore dhe digjitale, duke siguruar qasje në regjistrim për gratë të ndryshme, përfshirë edhe fizikisht dhe në gjuhë të ndryshme. Ligji parashikon balancë gjinore në udhëheqjen e Shoqërive Aksionare, gjë që mund të kontribuojë në barazinë gjinore.	Megjithëse digjitalizimi ul kohën dhe kostot në përgjithësi, pa dizajn gjithëpërfshirës rrezikon të përforcojë pabarazitë gjinore duke rritur informalitetin në mesin e bizneseve të udhëhequra nga gratë dhe duke kufizuar	<ul style="list-style-type: none"> <li>Siguroni që shërbimet online për regjistrimin e bizneseve të Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës, materialet udhëzuese dhe përmbajtja udhëzuese të jenë plotësisht të disponueshme dhe funksionalisht të barasvlershme në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze, për të parandaluar diskriminimin indirekt ndaj atyre që nuk flasin shqip, përfshirë gratë nga komunitetet pakicë.</li> <li>Mundësoni gjithashtu procedura të asistuar për aplikim fizik.</li> <li>Ofroni stimuj për bizneset e regjistruara për herë të parë të drejtuar nga gratë.</li> </ul>

Koncepti/dokument/ligjor	Qëllimi i politikës	Relevanca për barazi gjinore	Analiza gjinore: Situata e grupeve të prekura	Analiza gjinore: Si duhet të avancohet barazia gjinore	Si do të ndikojë në barazinë gjinore	Rekomandimet për eliminimin e ndikimeve negative dhe përmirësimin e atyre pozitive
	e të Kosovës.		udhëzime për folësit e gjuhës serbe dhe angleze. Këto elemente i vënë në disavantazh gratë nga pakicat dhe ato që nuk flasin shqip.		qasjen e tyre në financa, grante dhe mundësi tregu. Kuota gjinore prej 40% për udhëheqjen e Shoqërive Aksionare mund të kontribuojë në barazinë gjinore.	
<b>Projekti igji për Zejtarinë</b>	Rregullon ushtrimin e veprimtarive zejtare dhe artizanale, duke përfshirë regjistrimin, licencimin, kualifikimet profesionale dhe organizimin përmes Odës së Zejtarëve.	Ka relevancë të lartë gjinore pasi rregullon vetëpunësimin, aktivitetet e vogla ekonomike dhe ato familjare, ku gratë shpesh janë të angazhuara, duke përfshirë punën joformale dhe të papaguar.	Gratë e angazhuara në bizneset familjare zejtare mund të përballen me barriera për shkak të tarifave të anëtarësisë, kostove të licencimit, punës së papaguar, punës joformale, qasjes së pabarabartë në trashëgimi dhe qasjes më të kufizuar në mentorim dhe rrjete profesionale të nevojshme për të marrë kualifikime dhe tituj profesionalë.	Masat duhet të adresojnë barrierat ekonomike dhe strukturore duke hequr tarifat, duke siguruar të drejtat e punës dhe duke futur mundësi për mentorim dhe gratë. Duhet të ekzistojnë kuota për përfaqësim të barabartë në Odë.	Pa ndryshim e, mund të përforcojë pabarazitë ekzistues e gjinore në punën e papaguar, informalitetin, qasjen në sektor, avancimin profesional dhe vendimmarrjen. Përfaqësimi i barabartë në Odë mund të përmirësojë pjesëmarrjen e grave.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Hiqni tarifat për gjinitë dhe grupet e nënpërfaqësuar si masë afirmative në përputhje me masat e veçanta të LBGJ-së.</li> <li>• Parashihni programe trajnimi dhe mentorimi për gjinitë e nënpërfaqësuar që dëshirojnë të përvetësojnë zejtarinë.</li> <li>• Specifikoni kuota për përfaqësim gjinor (minimumi 50% sipas LBGJ-së) për të gjitha strukturat në Odë.</li> <li>• Harmonizoni dispozitat me Ligjin e Punës, duke rregulluar marrëdhënien e punës ndërmjet anëtarëve të familjes, duke garantuar të drejtat e punës përfshirë pushimin e lehonisë dhe pushime të tjera të paguara, si dhe duke kërkuar kontribute pensionale.</li> <li>• Përfshini në dispozitat mbi trashëgiminë që ajo duhet të ndahet në mënyrë të barabartë pavarësisht gjinisë.</li> <li>• Kërkoni mbledhjen dhe raportimin automatik tek ASK të të dhënave të ndara sipas gjinisë në regjistrat e zejeve, licencimit dhe titujve profesionalë, duke përdorur sisteme të ndërveprueshme. Kjo mundëson analizë më të mirë të ndikimeve të diferencuara gjinore.</li> </ul>
<b>UA (MMPHI)</b>	Ka për qëllim të	Rregullon qasjen në	Kërkesat rigoroze si	Kriteret e licencimit	Rritni pjesëmarrjen	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdorni gjuhë të përgjegjshme gjinore në të</li> </ul>

Koncepti/dokument/akti/ligjori	Qëllimi i politikës	Relevanca për barazinë gjinore	Analiza gjinore: Situata e grupeve të prekura	Analiza gjinore: Si duhet të avancohet barazia gjinore	Si do të ndikojë në barazinë gjinore	Rekomandimet për eliminimin e ndikimeve negative dhe përmirësimin e atyre pozitive
<b>) Nr. 03/2025 për Procedurat dhe Kriteret për Licencimin e Personave Fizikë dhe Juridikë për Hartimin e Raportit të VNM-së</b>	rregullojë procedurën për licencimin e personave fizikë dhe juridikë për hartimin e raporteve të VNM-së.	një shërbim profesional të specializuar ku gratë janë të nënpërfaqësuar dhe mund të përballen me barriera në hyrje. Kryerja e VNM-ve mund të ketë relevancë gjinore, duke përfshirë ndërveprimet me klientët dhe përmbajtjen, megjithëse e kjo nuk merret parasysh.	minimumi 5 vite përvojë, historiku i publikimeve, bashkëpunimi paraprak me ekspertët të licencuar, tarifave dhe paktyeshme dhe pragjet e stafit mund të vënë në disavantazh gratë, veçanërisht gratë e reja dhe grupet e marginalizuara që kanë më shumë gjasa të kenë ndërprerje në karrierë, përgjegjësi kujdesi, rrjete profesionale të kufizuara dhe më pak qasje në financa.	mund të njohin pushimin e lehonisë, kufizimet në rritëzim, punën me kohë të pjesshme dhe të ulin barrierat financiare dhe administrative për të arritur qasje të barabartë. Komisioni duhet të ketë kuota gjinore në përputhje me LBGJ-në.	jen e grave si eksperte të VNM-së dhe në vendimmarrje në këtë sektor.	gjithë tekstin në vend të nenit 3, për të shmangur përforsimin e stereotipeve gjinore. <ul style="list-style-type: none"> <li>Uleni tarifat për aplikim dhe rinovim të licencave dhe ofroni rimbursim të pjesshëm në rast refuzimi të kërkesave. Për procedurat e rinovimit, hiqni kërkesat për dokument të identifikimit dhe licencën e mëparshme, pasi Ministria i posedon këto dokumente.</li> <li>Kërkoni që Komisioni për shqyrtimin e kërkesave të ketë përfaqësim të balancuar gjinor në përputhje me LBGJ-në (50%).</li> <li>Kërkoni mbledhjen dhe publikimin e të dhënave të ndara sipas gjinisë për aplikuesit dhe personat fizikë dhe juridikë të licencuar, të përditësuar automatikisht tek ASK përmes ndërveprueshmërisë.</li> <li>Lejoni përvojë ekuivalente, siç është puna e bazuar në projekte, konsulenca, angazhimi me kohë të pjesshme dhe/ose mentorimi, të cilat mund të jenë në dobi të eksperteve gra të cilat mund të mos kenë qasje të barabartë në përvojë më formale.</li> </ul>
<b>Rregullorja (GRK) Nr. 20/2024 për Arsimin, Trajnimin dhe Njohjen e Shërbimeve dhe Ekspertëve</b>	Ka për qëllim të përcaktojë të kërkesat dhe procedurat për licencim, arsimim dhe aftësim për ekspertët në mbrojtjen nga rrezatimi dhe sigurinë	Rregullimi i qasjes dhe rinovimit të licencave mund të përfshijë barriera të tërthorta për angazhimin e grave. Ekspertët e licencuar duhet të kenë njohuri për rreziqet	Kriteret për rinovimin e licencës nuk marrin parasysh ndërprerjet për shkak të pushimit të lehonisë, punës me honorar apo përgjegjësi të kujdesit. Ndërsa rreziqet e ndërlidhura me shtatzëninë adresohen, rreziqet e tjera shëndetësore sipas gjinisë nuk trajtohen. Nuk ka	Inkurajoni më shumë gra, duke përfshirë ato në moshë riprodhuese, që të hyjnë në këtë sektor. Siguroni qasje të barabartë në informacion për gratë dhe burrat e ndryshëm mbi ndikimet shëndetësore të rrezatimit. Avancoheni barazinë	Siguroni fleksibilitet në kërkesat për trajnim dhe rinovim të licencave për të rritur pjesëmarrjen e grave në këtë sektor. Përmirësoni qasjen e barabartë	<ul style="list-style-type: none"> <li>Kërkoni që ekspertët trajnues të kenë njohuri dhe kapacitete të mjaftueshme për të ofruar trajnim mbi ndikimet e rrezatimit, duke përfshirë ndikimet e gjera të mundshme shëndetësore për gratë dhe burrat dhe parandalimin e tyre.</li> <li>Ndryshoni sistemin e pikëve për rinovimin e licencës që kërkon mesatarisht 20 ditë në vit për të fituar pikë, duke e bërë më fleksibil</li> </ul>

Koncepti/dokument/akti/ligjor	Qëllimi i politikës	Relevanca për barazi gjinore	Analiza gjinore: Situata e grupeve të prekura	Analiza gjinore: Si duhet të avancohet barazia gjinore	Si do të ndikojë në barazinë gjinore	Rekomandimet për eliminimin e ndikimeve negative dhe përmirësimin e atyre pozitive
	bërthamore.	shëndetësore të rrezatimit për gratë dhe burrat, përtej rreziqeve për fetusin gjatë shtatzënisë.	dispozita për balancë gjinore në komision.	gjinore në vendimmarrje në Komision.	të grave dhe burrave në informacion mbi shëndetin dhe potencialin shtetëror rezultatat shëndetësore. Mundësoni barazi gjinore në vendimmarrje.	dhe kumulativ gjatë pesë viteve për të adresuar rastet e punës me honorar ose pushimit të lehonisë. <ul style="list-style-type: none"> <li>Mblidhni dhe raportoni të dhëna të ndara sipas gjinisë në përputhje me kërkesat e LBGJ-së në Kosovë.</li> <li>Kërkoni që Komisioni të ketë përfaqësim të balancuar gjinor (50%), në përputhje me LBGJ-në.</li> </ul>
<b>UA (MKRS) Nr. 02/2025 për Kriteret, Kërkesat, Rregullat dhe Procedurat Lidhur me Lëshimin, Administrimin, dhe Revokimin e potenciale Profesionale për Personat Fizikë dhe Juridikë në Fushën e Trashëgimisë Kulturore</b>	Ka për qëllim të rregullojë kërkesat dhe procedurat për licencimin e personave fizikë dhe juridikë të angazhuar në aktivitete të konservimit, restaurimit dhe arkeologjisë.	Udhëzimi rregullon licencimin në një sektor ku gratë janë të nënpërfaqësuar, veçanërisht në restaurimin teknik dhe në rolet e ekspertëve të lartë në sektorin e trashëgimisë kulturore.	Mbështetja ekskluzive në sistemet elektronike të aplikimit pa mbështetje fizike mund të pengojë qasjen. Ndërprerjet në karrierë të ndërlidhura me lehoninë dhe përgjegjësitë e kujdesit mund të disfavorizojnë gratë. Nuk ka dispozita që sigurojnë përfaqësim të balancuar gjinor në Bordin e Licencimit.	Kriteret dhe procedurat e licencimit duhet të njohin pushimin e lehonisë dhe të promovojnë balancë gjinore në vendimmarrje. Bordi mund të kërkohet të përfshijë analizën gjinore në raportet e tij, me qëllim të identifikimit të fushave për përmirësimin e barazisë gjinore.	Me masa të përgjegjshme gjinore, ai mund të mbështesë pjesëmarrje dhe udhëheqje më të barabartë të grave në sektorin e trashëgimisë kulturore.	<ul style="list-style-type: none"> <li>Përdorni gjuhë të ndjeshme gjinore.</li> <li>Futni njohjen e ndërprerjeve në karrierë për shkak të pushimit të lehonisë gjatë llogaritjes së viteve të përvojës.</li> <li>Mblidhni dhe publikoni rregullisht të dhëna të ndara sipas gjinisë dhe treguesve të tjerë socio-ekonomik për aplikuesit dhe miratimet e licencave, duke i ndërlidhur me ASK-në përmes ndërveprueshmërisë në përputhje me LBGJ-në.</li> <li>Kërkoni kuotë gjinore në Bord në përputhje me LBGJ-në (50%).</li> <li>Kërkoni që Bordi të përfshijë analizën gjinore në raportet e tij, me qëllim identifikimin e fushave për përmirësimin e barazisë gjinore.</li> <li>Siguroni mbështetjen e aplikantëve me asistencë online dhe offline.</li> </ul>
<b>Projekti për Bankat</b>	Ka për qëllim të rregullojë aktivitetet	Ai ka relevancë të lartë gjinore	Gratë janë të nënpërfaqësuar në pozitave të mesme dhe të	Ai duhet të adresojë pabarazitë strukturore	Masat e përgjegjshme gjinore do	<ul style="list-style-type: none"> <li>Kërkoni mbledhjen e të dhënave për mbajtësit e llogarive, kërkesat për kredi,</li> </ul>

Koncepti dokumenti/akti ligjor	Qëllimi i politikës	Relevanca për barazi gjinore	Analiza gjinore: Situata e grupeve të prekura	Analiza gjinore: Si duhet të avancohet barazia gjinore	Si do të ndikojë në barazinë gjinore	Rekomandimet për eliminimin e ndikimeve negative dhe përmirësimin e atyre pozitive
	bankare dhe financiar e.	pasi rregullon qasjen në financa, punësimin, pozitat e mesme dhe të larta drejtuese në sistemin financiar dhe pozitat vendimmarre në sektorin bankar.	larta drejtuesve dhe në pozitat vendimmarre në sektorin bankar. Mbipërfaqësimi i burrave në udhëheqjen e bankave mund të kontribuojë në vlerësime të njëanshme të rrezikut dhe dizajn të produkteve financiare që nuk i përgjigjen në mënyrë adekuate nevojave të grave, veçanërisht grave nga grupet e marginalizuara.	gjinore në udhëheqjen e bankave, qasjen në financa dhe udhëheqje përmes masave afirmative dhe kuotave, në përputhje me LBGJ-në. Ai mund të inkurajojë përdorimin e të dhënave ndërkushtesh e ndara sipas gjinisë për informuar rreth dizajnit më të përgjegjshëm gjinor të produkteve financiare.	të kontribuonin pozitivisht në barazinë gjinore duke përmirësuar vendimmarrjen e grave në sektorin bankar dhe qasjen në financa. Dispozitat aktuale me gjuhë mashkullore përforcojnë stereotipet gjinore në sektor, duke dekurajuar potencialin pjesëmarrës të grave dhe duke minuar qasjen në financa.	miratimet e kredive dhe shumat e tyre, depozitat dhe shërbimet financiare, të ndara sipas gjinisë dhe moshës, përkatësisë etnike, vendndodhjes rurale/urbane dhe aftësisë së kufizuar, të dorëzuara rregullisht dhe të publikuara nga ASK përmes një sistemi të ndërveprueshëm. <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdorni gjuhë të ndjeshme gjinore.</li> <li>• Kërkoni përfaqësim të balancuar gjinor në bordet e bankave në përputhje me LBGJ-në.</li> </ul>
<b>UA (GRK) Nr. 04/2024 për Tarifatat për Produktet dhe Shërbimet Kadastrale Gjeodezike dhe Regjistrimit të Pronave</b>	Rregullon tarifatat për regjistrimin e pronës, produktet kadastrale dhe gjeodezike për të gjitha pasuritë e paluajtshme.	Ka relevancë të lartë gjinore duke pasur parasysh nënpërfaqësimin e grave si pronare të pronave. Gratë mund të përballen me barriera shtesë në realizimin e të drejtave të	Siç dihet, gratë që marrin asistencë sociale, personat me aftësi të kufizuara, viktimat e dhunës në familje dhe të mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë luftës mund të përballen me barriera shtesë dhe mund të mos kenë mundësi të përballojnë tarifatat. Ato	Ai prezanton përjashtime nga tarifatat e përgjegjshme gjinore që mund të përmirësojnë qasjen e grave në shërbimet e regjistrimit të pronës dhe në të drejtat pronësore.	Ka ndikim potencial pozitiv në barazinë gjinore duke ulur barrierat financiare për regjistrimin e pronës. Ndikimi varet nga ndërgjegjësimi dhe qasja e grave në këto përjashtime.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kërkoni raportim të rregullt të të dhënave mbi regjistrimin e pronës sipas gjinisë dhe përjashtimet nga tarifatat, të ndara sipas gjinisë dhe moshës, vendndodhjes rurale/urbane, përkatësisë etnike, përfituesve të asistencës sociale, të mbijetuarve të dhunës me bazë gjinore, nënave vetëshqyese dhe aftësisë së kufizuar, tek ASK për publikim të menjëhershëm përmes ndërveprueshmërisë.</li> <li>• Vendosni ulje të tarifave për regjistrimin e parë të pronës për të gjitha gratë, me qëllim rritjen e përqindjes së pronës</li> </ul>

Koncepti/dokumenti/akti ligjor	Qëllimi i politikës	Relevanca për barazinë gjinore	Analiza gjinore: Situata e grupeve të prekura	Analiza gjinore: Si duhet të avancohet barazinë gjinore	Si do të ndikojë në barazinë gjinore	Rekomandimet për eliminimin e ndikimeve negative dhe përmirësimin e atyre pozitive
		tyre pronësore në rastet e dhunës në familje, divorcit dhe trashëgimisë.	mund të përballen me vështirësi në sigurimin e dëshmive për statusin e tyre.			<p>së regjistruar në emër të grave.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Zgjeroni përjashtimet nga tarifat për të përfshirë të mbijetuarit e të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore dhe jo vetëm të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës dhe dhunës në familje</li> <li>Përmirësoni ndërveprueshmërinë dhe zbatimin e parimit “vetëm një herë”, në mënyrë që aplikuesit të mos kenë nevojë të dorëzojnë dëshmi shtesë që tashmë mbahen nga shteti, si p.sh. dëshmi për përfitimin e asistencës sociale.</li> <li>Rregulloni më qartë që informacioni mbi përjashtimet të specifikohet qartë për aplikantët.</li> </ul>
<b>UA (MMPHI) Nr. 06/2024 për Dhënie të Lejeve për Kompani të Gjeodezisë dhe Licencimin e Gjeodetëve</b>	Për të rregulluar procedurat, standardet dhe tarifat për lejet për kompanitë gjeodezike dhe licencimin e gjeodetëve.	Është i rëndësishëm nga perspektiva gjinore pasi rregullon qasjen në një profesion të licencuar dhe përmban kërkesa procedurale dhe financiare që kanë ndikime të tërthorta gjinore.	Afatet e rrepta të aplikimit, numri i kufizuar i aplikimeve të përpunuara në vit, mbështetja në dokumentacion në kopje fizike dhe tarifat e larta të licencimit ndikojnë në mënyrë disproporcionale tek gratë, veçanërisht ato me ndërprerje në karrierë, përgjigjësi kujdestarie, punë më pak fleksibile dhe qasje të kufizuara në financa.	Ai lejon pezullimin e licencës për pushim të lehonisë, por duhet t'i lejojë gratë të përcaktojnë kohëzgjatjen e pezullimit. Duhet të zvogëlojë tarifat për grupe të caktuara dhe të mundësojë aplikimin online për të reduktuar barrën kohore dhe financiare.	Me masa të përgjegjshme gjinore mund të promovojë barazinë gjinore duke përmirësuar qasjen, qëndrueshmërinë dhe vazhdimësinë e grave në sektor.	<ul style="list-style-type: none"> <li>Të ndryshohet procesi i aplikimit për të pasur më shumë fleksibilitet në kohën e aplikimeve, siç është përpunimi i vazhdueshëm i kërkesave. Ofroni mundësinë për të ngarkuar dokumentet e kërkuara përmes eKosova ose një sistemi elektronik.</li> <li>Ulni tarifat ose ofroni masa afirmative për grupe të caktuara që kanë qasje të kufizuara në financa, duke përfshirë gratë.</li> <li>Ndryshoni nenin 22 (par. 2) në mënyrë që gjeodetët e licencuar të mund të përcaktojnë kohëzgjatjen e pezullimit për pushimin e lehonisë.</li> </ul>
<b>UA (MINT) Nr. xx/2025 për Procedurat për</b>	Rregullon procedurat për regjistrimin e të dhënave në	Ka relevancë të ulët për barazinë gjinore për shkak, të	Ndërsa më shumë burra kanë tendencë të jenë pronarë të bizneseve, gratë janë të përfaqësuara	Regjistri duhet të mbledhë të dhëna të ndara sipas gjinisë dhe faktorëve të	Futja e gjuhës së ndjeshme gjinore dhe të dhënave të ndara	<ul style="list-style-type: none"> <li>Kërkoni që regjistri të mbledhë dhe raportojë rregullisht përmes sistemeve të ndërveprueshme tek ASK të dhëna mbi pronarët dhe grupet përkatëse, të ndara sipas gjinisë dhe moshës,</li> </ul>

Koncepti/dokument/akti/ligjor	Qëllimi i politikës	Relevanca për barazi gjinore	Analiza gjinore: Situata e grupeve të prekura	Analiza gjinore: Si duhet të avancohet barazia gjinore	Si do të ndikojë në barazinë gjinore	Rekomandimet për eliminimin e ndikimeve negative dhe përmirësimin e atyre pozitive
<b>Futjen e të Dhënave në Regjistrin e Pronarëve Përfitues</b>	Regjistrin e Pronarëve Përfitues nga Regjistri i Bizneseve dhe Organizatave Jofitimprurëse	natyrës së tij teknike.	mirë në mesin e udhëheqësve të organizatave jofitimprurëse. Disa gra dhe grupe të caktuara socio-demografike mund të kenë nevojë për mbështetje gjatë regjistrimit.	tjerë socio-demografikë. Duhet të përdorë gjuhë gjinore neutrale për të shmangur promovimin e stereotipeve gjinore.	sipas gjinisë mund të ketë ndikim pozitiv duke zbërthyer stereotipet gjinore lidhur me pronësinë e bizneseve.	përkatësisë etnike, vendndodhjes rurale/urbane, aftësisë së kufizuar dhe/ose faktorëve të tjerë socio-demografikë. <ul style="list-style-type: none"> <li>• Siguroni përdorimin e gjuhës neutrale gjinore për të mos promovuar stereotipe gjinore.</li> <li>• Ofroni mbështetje fizike për organizatat joqeveritare të udhëhequra nga gra për të mundësuar qasje më të lehtë.</li> </ul>
<b>Vlerësimi i ndikimit për qëndrimin dhe vendbanimin</b>	Vlerësoni kornizën legjislative lidhur me qëndrimin për të vendbanimin në Kosovë, duke identifikuar boshllëqet ligjore që do të mundësojnë një regjistrim gjithëpërfshirës të adresave për qëndrim dhe vendbanim.	Është shumë i rëndësishëm nga perspektiva gjinore pasi rregullon qasjen në lejet e qëndrimit dhe vendbanimit, të cilat mund të jenë më sfiduese për gratë, veçanërisht për gratë migrante dhe grupet e marginalizuara. Megjithatë, dokumenti është neutral ndaj gjinisë.	Gratë, veçanërisht gratë migrante dhe grupet e marginalizuara, mund të përballen me pengesa në aplikim që lidhen me nivelin e arsimit, moshën, mjetet financiare, (pa)punësinë ose punën joformale, varësinë ekonomike nga të tjerët dhe mosmarrëveshjet familjare, ndër të tjera.	Duhet të përdorë VNBGGJ për të vlerësuar të drejtat dhe qasjen në shërbime. Kjo mund të zbulojë se si proceset duhet të reduktojnë pengesat për gratë, veçanërisht për gratë migrante.	Nëse bazohet në analizë gjinore, Ligji do të kontribuojë në hartimin e politikave të bazuara në dëshmi dhe do të adresojë siç duhet pengesat me të cilat përballen gratë, duke mundësuar qasje më të barabartë të tyre në qëndrim.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kryeni një VNBGGJ për të siguruar që analiza gjinore të informojë për opsionet e propozuara dhe që këto të adresojnë barrierat dhe pabarazitë gjinore të identifikuar në realizimin e të drejtës për qëndrim.</li> <li>• Kërkonte konsultim me ABGGJ-në gjatë hartimit të konceptit dokumenteve dhe siguroni mbledhjen dhe përdorimin e të dhënave të ndara sipas gjinisë për hartim të politikave të bazuar në dëshmi.</li> <li>• Siguroni që grupi punues që përgatit konceptin dokumentin të përfshijë një ekspert të barazisë gjinore ose një zyrtar për barazi gjinore.</li> <li>• Bashkëngjithni të gjitha modelet e VNBGGJ-së si shtojca në dokumentin e publikuar dhe siguroni që analiza gjinore të përfshijë vëmendje ndaj ndërsektorialitetit.</li> <li>• Siguroni që regjistri i ri të kërkojë të dhëna të ndara sipas gjinisë dhe moshës, përkatësisë etnike, shtetësisë, aftësisë së kufizuar dhe faktorëve të tjerë socio-demografikë. Ai duhet të jetë i ndërveprueshëm me ASKNë, duke mundësuar qasje në kohë reale në të dhëna të ndara sipas gjinisë.</li> </ul>
<b>Projekti ligjor për Veterinarinë</b>	Rregullon kornizën ligjore për aktivitetet dhe	Është shumë i rëndësishëm nga perspektiva gjinore,	Gratë janë të përfaqësuara në mënyrë disproporcionale në mesin e punëtorëve	Integrimi i inspektimit dhe përgjegjëshmërisë gjinore për të adresuar informalitetin,	Pa një qasje të përgjegjshme gjinore ose masa	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përfshini në inspektime kërkesën që anëtarët e familjes të angazhohen në bizneset familjare të regjistruar me kontrata pune, pagesë, kontribute</li> </ul>

Koncepti/dokumenti/akti/ligjor	Qëllimi i politikës	Relevanca për barazi gjinore	Analiza gjinore: Situata e grupeve të prekura	Analiza gjinore: Si duhet të avancohet barazia gjinore	Si do të ndikojë në barazinë gjinore	Rekomandimet për eliminimin e ndikimeve negative dhe përmirësimin e atyre pozitive
	shërbimet veterinarë për të mbrojtur shëndetin e kafshëve dhe njerëzve, duke garantuar sigurinë e ushqimit dhe produkteve me origjinë shtazore. Aktivitetet përfshijnë licencimin e veterinarëve, inspektimet, tarifatat dhe raportimin. Ai rregullon Odën e Veterinarëve dhe Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë.	pasi rregullon qasjen në profesione të licencuara dhe ndikon në aktivitetet bujqësore ku gratë marrin pjesë, shpesh në mënyrë joformale.	joformalë dhe janë të angazhuara në punë bujqësore, veçanërisht në fermat e vogla familjare, të rregulluara nga ky Ligj. Gratë mund të kenë më pak mundësi për të paguar tarifatat e kërkuara, por nuk parashihen përjashtime. Projektligji obligon përdorimin e sistemit elektronik për raportimin dhe regjistrimin e të dhënave, për të cilin gratë mund të përballen me pengesa shtesë për shkak të nivelit të kufizuar të arsimit, aftësive digjitale ose qasjes në teknologji.	drejt formalizimit të punësimit të grave dhe përmirësimit të të drejtave të tyre në punë, gjendjes ekonomike dhe pensioneve. Vendosni masa afmative për heqjen e tarifave. Mbështetjet përdorimi i shërbimeve digjitale në mënyrë fizike dhe të zbuten sanksionet fillestare, duke ofruar më shumë kohë dhe mbështetje të përgjegjshme gjinore për përshtatje.	lehtësues, ekziston rreziku i rritjes së informalitetit, rritjes së pengesave në qasje për veterinerët dhe ruajtjes ose përkeqësimin të pjesëmarrjes së grave në fuqinë punëtore (dhe informalitetin), veçanërisht në sektorin bujqësor. Rishikimet e propozuara mund të kontribuojnë në zvogëlimin e angazhimit të grave në punë joformale, duke kontribuar në përmirësimin e barazisë ekonomike.	<p>pensionale dhe të drejta të punës. Kërkonte që inspektorët të trajnohen në qasje të përgjegjshme gjinore në inspektime, duke marrë parasysh pabarazitë gjinore dhe shkeljet e të drejtave brenda familjeve dhe mënyrën e adresimit të tyre në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme gjinore.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Vendosni masa lehtësuese si ulja e sanksioneve dhe tarifave për operatorët në shkallë të vogël.</li> <li>• Vendosni periudha kalimtare dhe asistencë personale për të mbështetur mësimin dhe përdorimin e sistemeve digjitale; siguroni që sportelet e shërbimit të kenë këto shërbime të disponueshme, duke përfshirë kompjuterë dhe mjete digjitale për personat që nuk i posedojnë ato, si dhe burime njerëzore të trajnuara në qasje të përgjegjshme gjinore për të mbështetur përdoruesit e ndryshëm në regjistrim.</li> <li>• Kërkonte mbledhjen e të dhënave të ndara sipas gjinisë dhe moshës, përkatësisë etnike, vendndodhjes rurale/urbane, aftësisë së kufizuar dhe faktorëve të tjerë socio-demografikë, të ndara dhe të shpërndara automatikisht tek ASK përmes sistemeve të ndërveprueshme, duke mundësuar shikim dhe analizë në kohë reale të të dhënave.</li> </ul>
<b>Koncepti/dokumenti për veprimtaritë kërkimore dhe inovacion</b>	Vlerëson ndikimet rregullatore të opsioneve të politikave për përmirësimin e kornizës ligjore	Ka relevancë të lartë gjinore lidhur me përfshirjen e grave në kërkim, veprimtari shkencore dhe inovacion.	Gratë, veçanërisht nga grupet e marginalizuara, mund të përballen me pengesa në pjesëmarrjen në kërkimin shkencor.	Dokumenti duhet të përdorë mjetin VNBGJ 7 të kërkuar nga Manuali për Hartimin e Koncepteve Dokumenteve për të analizuar se si Ligji mund	Duke i trajtuar ndikimet gjinore si neutrale, opsioni i propozuar rrezikon të ruajtje pabarazitë ekzistues	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdorni mjetet e detyrueshme të VNBGJ-së të ofruara në Manualin për Hartimin e Koncepteve Dokumenteve (fq. 115).</li> <li>• Siguroni që grupi punues që zhvillon konceptin dokumentar të përfshijë një ekspert/e të barazisë gjinore ose një zyrtar për barazi gjinore.</li> <li>• Siguroni që VNBGJ të përfshijë vëmendje ndaj</li> </ul>

Koncepti/dokumenti/akti ligjor	Qëllimi i politikës	Relevanca për barazi gjinore	Analiza gjinore: Situata e grupeve të prekura	Analiza gjinore: Si duhet të avancohet barazia gjinore	Si do të ndikojë në barazinë gjinore	Rekomandimet për eliminimin e ndikimeve negative dhe përmirësimin e atyre pozitive
	për veprimtarinë kërkimore, shkencore dhe inovacionin në Kosovë			të ndikojë tek gra dhe burra të ndryshëm, duke shfrytëzuar gjetjet për të dhënë informacion për dizajnin e tij.	e gjinore në kërkim dhe inovacion. Bazuar në VNBGJ, mund të identifikojë se si bashkimi i dy ligjeve mund të reduktojë barrierat strukturorë dhe të stimulojë pjesëmarrjen e grave në kërkimin shkencor.	<p>ndërsektorialitetit. Përdoreni atë për të përfshirë në dokument të dhëna të ndara sipas gjinisë dhe kategorive të tjera socio-demografike, duke dhënë informacion për përmbajtjen e tij.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● Përfshini masa afirmative për të adresuar pabarazitë në kërkim dhe inovacion.</li> </ul>
<b>Koncepti dokumenti për bujqësinë organike</b>	Ka për qëllim të vlerësojë opsionet më të mira të politikave për të rregulluar prodhimin organik, certifikimin, etiketimin dhe sistemet e inspektimit në përputhje me standardet organike të BE-së.	Është relevant në praktikë, pasi procedurat ndikojnë në qasjen në prodhimin organik dhe certifikimin brenda një sektori ku gratë përballen me pabarazi dhe shpesh punojnë në mënyrë joformale.	Gratë fermere, veçanërisht ato të angazhuara në bujqësi në shkallë të vogël dhe familjare, përballen me nivel më të lartë të informalitetit, aftësi të kufizuara digjitale, kufizime kohore dhe mungesë të pronësisë formale të tokës ose kontratave të qirasë.	Duhet të përfshijë mbledhjen e të dhënave ndërsektoriale të ndara sipas gjinisë për procedurat e certifikimit, regjistrimit dhe inspektimit. Duhet të adresojë dallimet e mundshme në qasjen e grave të ndryshme lidhur me pronësinë e tokës, trashëgiminë, mjetet digjitale, njohuritë dhe çështjet e informalitetit.	Pa një vlerësim të duhur, rekomandimet e politikave rrezikojnë të përforcojnë pa dashje pabarazitë gjinore duke përjashtuar gratë nga tregjet formale organike, duke rritur informalitetin dhe shitjet joformale jashtë sistemeve zyrtare të inspektimit. Sigurimi i masave afirmative mund të kontribuojë në barazinë ekonomike.	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Përdorni mjetet e detyrueshme të VNBGJ-së në Manualin për Hartimin e Konceptit Dokumenteve për të vlerësuar dhe adresuar pabarazitë gjinore.</li> <li>● Siguroni që grupi punues i dokumentit të përfshijë një ekspert të barazisë gjinore ose një zyrtar për barazi gjinore.</li> <li>● Siguroni që ligji të kërkojë mbledhjen dhe raportimin në kohë reale të të dhënave të ndara sipas gjinisë për bujqësinë organike, përfituesit e tokës, pronarët e tokës dhe prodhimin organik tek ASK përmes sistemeve të ndërveprueshme.</li> <li>● Adresoni çështjet e qasjes digjitale duke ofruar asistencë fizike për të lehtësuar regjistrimin.</li> </ul>

Koncepti/dokument/akti/ligjor	Qëllimi i politikës	Relevanca për barazi gjinore	Analiza gjinore: Situata e grupeve të prekura	Analiza gjinore: Si duhet të avancohet barazia gjinore	Si do të ndikojë në barazinë gjinore	Rekomandimet për eliminimin e ndikimeve negative dhe përmirësimin e atyre pozitive
<b>Projekt UA për Procedurën e Dhënies, Rinovimit, Pezullimit dhe Revokimit të Licencave për Ofruesit e Shërbimeve Sociale dhe Familjare</b>	Rregullon procedurat për licencim, rinovim, pezullim, revokim, ankesa dhe tarifa për ofruesit e shërbimeve sociale dhe familjare.	Ka relevancë të lartë gjinore pasi shërbimet sociale dhe familjare ofrohen kryesisht nga gratë dhe përdoren kryesisht nga gratë, duke përfshirë të mbijetuara të dhunës me bazë gjinore, gratë e moshuara, nënat vetushqyese dhe personat me aftësi të kufizuara, ndër të tjera.	OJQ-të e udhëhequra nga gratë, strehimoret dhe ofruesit e shërbimeve në zonat rurale mund të përballen me pengesa disproporcionale e për shkak të kërkesave rigoroze dhe ndalimit gjashtëmujor të riaplikimit nëse kërkesa refuzohet. Përfitueset gra mund të përballen me ndërprerje të shërbimeve nëse licencat pezullohen ose revokohen pa qenë të disponueshme shërbime alternative.	Duhet të vendosen kërkesa proporcionale për licencim bazuar në zonën e themelimit, madhësinë dhe kapacitetin. Ofroni mbështetje për aplikim elektronik për gratë me aftësi të kufizuara digjitale ose qasje të kufizuara. Hiqni kufizimet kohore për riaplikim. Siguroni vazhdimësinë e shërbimeve gjatë pezullimit të licencës për të shmangur dëmtimin e përfituesve (p.sh., të mbijetuara të dhunës).	Pa këto masa të përgjegjshme gjinore, dispozitat rrezikojnë të përforcojnë pabarazitë strukturale dhe kufizuar shërbimet e udhëhequra nga gratë dhe duke reduktuar qasjen në këto shërbime për gratë e cenueshme. Sigurimi i shërbimeve të përgjegjshme gjinore mund të përmirësojë qasjen e grave të ndryshme në ofrimin e shërbimeve, të sigurojë vazhdimësinë e shërbimeve cilësore dhe të kontribuojë në barazinë gjinore në përgjithësi përmes ofrimit të duhur të shërbimeve.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ofroni mundësi të asistuar për aplikim dhe udhëzime për aplikantët me aftësi të kufizuara digjitale.</li> <li>• Vendosni kërkesa të përgjegjshme gjinore për licencim, proporcionale me zonën e themelimit, madhësinë, kapacitetin dhe shërbimin e ofruar.</li> <li>• Rregulloni procedurat për aplikimet elektronike të paplota (njoftoni aplikantin) dhe hiqni ndalimin gjashtëmujor për riaplikim në rastet e gabimeve teknike ose mungesës së dokumentacionit.</li> <li>• Parashihni një periudhë lehtësuese për përmirësimin e çështjeve të identifikuar para pezullimit. Shtoni dispozita për të siguruar vazhdimësinë e shërbimeve në rast të revokimit ose pezullimit të licencave.</li> <li>• Kërkoni që regjistri i të dhënave për ofruesit e shërbimeve sociale dhe familjare të përfshijë të dhëna të ndara sipas gjinisë në mënyrë ndërsektoriale, në përputhje me kërkesat për mbrojtjen e të dhënave dhe të ndahen me ASK-në në kohë reale përmes ndërveprueshmërisë.</li> <li>• Hiqni kufizimet mbi numrin maksimal të viteve për të cilat licencat mund të rinovohen, pasi ofruesit e kualifikuar duhet të jenë në gjendje të rinovojnë licencat në mënyrë të vazhdueshme.</li> </ul>

Koncepti/dokumenti/akti/ligjori	Qëllimi i politikës	Relevanca për barazi gjinore	Analiza gjinore: Situata e grupeve të prekura	Analiza gjinore: Si duhet të avancohet barazia gjinore	Si do të ndikojë në barazinë gjinore	Rekomandimet për eliminimin e ndikimeve negative dhe përmirësimin e atyre pozitive
<b>UA Nr. 03/2024 për Bashkë pagesat për Shërbimet Shëndetësore</b>	Për të rregulluar bashkëpagesat, përjashtimet, përfituesit e përjashtimeve dhe procedurat e pagesës dhe rimbursimit brenda sektorit publik shëndetësor në Kosovë.	Është shumë i rëndësishëm nga perspektiva gjinore veçanërisht ato nga komunitetet pakicë dhe zonat rurale, kanë më pak qasje në shërbimet publike shëndetësore.	Gratë preken në veçanti, sidomos nënat vetushqyese, gratë me të ardhura të ulëta, gratë e moshuara, të mbijetuarat e dhunës dhe gratë që marrin asistencë sociale. Përjashtimi njëvjeçar për viktimat mund të jetë i pamjaftueshëm që ato të arrijnë stabilitet financiar. Procedurat e verifikimit janë të paqarta, gjë që mund të krijojë barrë shtesë. Strehimoret nuk janë të përfshira në mënyrë eksplicite.	UA duhet të përshtatë afatet e përjashtimit për viktimat e dhunës në përputhje me realitetin dhe kohën e nevojshme. Qartësoni dhe thjeshtoni procedurat e verifikimit.	Pa këto masa, bashkëpagesat mund të përforcojnë cenueshërinë ekonomike të grave nga grupet e marginalizuara, duke penguar qasjen e tyre në shërbimet thelbësore e shëndetësore, gjë që mund të kontribuojë në rezultate më të dobëta shëndetësore për gratë në veçanti. Ndërmarrja e masave të përmendura mund të kontribuojë në përmirësimin e rezultateve shëndetësore për gratë e ndryshme.	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ndryshoni periudhën njëvjeçare të përjashtimit për viktimat e dhunës në familje dhe trafikimit, duke e ndërlidhur përjashtimin me rezultatet e riintegritimit në planet e menaxhimit të rasteve, siç është stabiliteti ekonomik.</li> <li>Specifikoni mënyrën se si individët që i përkasin kategorive të përjashtuara verifikojnë statusin e tyre duke përdorur parimin "vetëm një herë", duke shmangur barrën administrative që mund të pengojë qasjen.</li> <li>Përfshini në mënyrë eksplicite strehimoret për gratë dhe institucionet e tjera specifike për mbrojtje gjinore në listën e institucioneve shtetërore të përjashtuara në nenin 5.</li> <li>Kërkoni mbledhjen e të dhënave të ndara sipas gjinisë dhe moshës, përkatësisë etnike, vendndodhjes rurale/urbane, aftësisë së kufizuar dhe kategorisë së përjashtimit për përfituesit, frekuencën e përdorimit të shërbimeve dhe ndikimin financiar.</li> </ul>
<b>Koncepti/dokumenti për qeverisjen dhe menaxhimin e</b>	Dokumenti vlerëson ndikimet e pritshme ekonomike,	Është shumë i rëndësishëm nga perspektiva gjinore pasi AAP ndikon në	Grupet e prekura përfshijnë gratë, veçanërisht gratë që rikthehen në tregun e punës, nënat, si dhe	Duhet të zbatohet një qasje të përgjegjshme gjinore bazuar në një VNBGJ të plotë, e cila	Pa analizë gjinore, opsionet e politikave rrezikojnë të	<ul style="list-style-type: none"> <li>Kryeni VNBGJ-në e detyrueshme për të identifikuar pabarazitë gjinore të mundshme në qasjen në AAP dhe përdorni gjetjet për të ofruar informacion për dokumentin dhe projektligjin.</li> </ul>

Koncepti/dokumenti/akti/ligjori	Qëllimi i politikës	Relevanca për barazinë gjinore	Analiza gjinore: Situata e grupeve të prekura	Analiza gjinore: Si duhet të avancohet barazia gjinore	Si do të ndikojë në barazinë gjinore	Rekomandimet për eliminimin e ndikimeve negative dhe përmirësimin e atyre pozitive
<b>arsimit dhe aftësimin profesional</b>	sociale, administrative dhe institucionale të opsioneve të politikave që lidhen me AAP, duke përfshirë efektet në punësim, qasjen në trajnim, mësimin gjatë gjithë jetës dhe zhvillimin e fuqisë punëtore; rekomandoni një opsion të politikave .	qasjen në tregun e punës, mundësitë e punësimit dhe normat e pjesëmarrjes së grave. Normat e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës janë jashtëzakonisht të ulëta krahasuar me ato të burrave.	gratë nga zonat rurale, të reja, nga komunitetet pakicë dhe gratë me aftësi të kufizuara. Ato përballen me më shumë pengesa për shkak të përgjegjësisë të kujdesit, mjeteve të kufizuara financiare, kufizimeve në siguri dhe transport, punës së papaguar dhe pabarazive të shumëfishta.	duhet të vlerësojë se si procedurat e regjistrimit, dokumentacioni, fushatat e ndërgjegjësimit dhe oraret e trajnimit mund të ndikojnë në mënyrë disproporcionale në angazhimin e grave.	përforcojnë pabarazitë ekzistuese gjinore në qasjen në AFP dhe në tregun e punës, përfshirë stereotipet gjinore profesionale. Sigurimi që ligjet bazohen në VNBGJ mund të kontribuojë në rritjen e pjesëmarrjes së grave në fuqinë punëtore dhe në zhbërjen e stereotipeve gjinore profesionale.	<ul style="list-style-type: none"> <li>Kërkoni mbledhjen e të dhënave të ndara sipas gjinisë dhe faktorëve të tjerë socio-demografikë, si mosha, përkatësia etnike, zona rurale/urbane, gjuha, përgjegjësitë e kujdesit, mjetet financiare dhe sfidat e transportit për grupet e synuara dhe përfituesit e AAP-së, duke mundësuar hartimin e masave afirmative. Raportoni në kohë reale në ASK përmes sistemeve të ndërveprueshme.</li> <li>Vlerësoni procedurat e regjistrimit, fushatat e ndërgjegjësimit, oraret e trajnimeve dhe elementet e tjera të ndërlidhura me dokumentet për të analizuar se si ato mund të ndikojnë në mënyrë disproporcionale tek gratë e ndryshme, veçanërisht nga grupet e marginalizuara. Përfshini masa afirmative për të adresuar këto çështje.</li> </ul>
<b>Koncepti/dokumenti për përmirësimin digjital, shërbimet digjitale dhe shitjen e mallrave</b>	Për të vlerësuar ndikimet ekonomike, sociale dhe administrative dhe për të rekomanduar transpozimin e Direktivave të BE-së 2019/770 dhe 2019/771 për të forcuar mbrojtjen e	Ka relevancë të ulët gjinore pasi opsioni i propozuar i politikës zbatohet njësoj për të gjithë konsumatoret dhe bizneset, dhe nuk janë identifikuar rreziqe për ndikime të diferencuara gjinore. Qasja në	Nuk janë identifikuar pengesa specifike të diferencuara gjinore. Mungesa e të dhënave të ndara sipas gjinisë kufizon kuptimin e pjesëmarrjes së grave në ndërmarrësinë digjitale, NVM dhe shitjen online. Gratë dhe burrat mund të kenë mënyra dhe mjete të ndryshme për qasje në	Reformat duhet të sigurojnë ndërgjegjësimit të përgjegjshëm gjinor, udhëzime dhe procedura të thjeshtuara për konsumatorët dhe bizneset. Mblidhni të dhëna të ndara sipas gjinisë për të monitoruar pjesëmarrjen në tregjet digjitale dhe mekanizmat e zbatimit.	Masa nuk ka gjasa të ndryshojë drejtpërdrejt marrëdhëniet gjinore. Mbledhja e të dhënave është e rëndësishme për të monitoruar dhe adresuar çdo pabarazi të tërthortë të	<ul style="list-style-type: none"> <li>Parashihni fushata ndërgjegjësuese dhe udhëzuese të përgjegjshme gjinore, thjeshtim dhe masa mbështetëse që synojnë gratë dhe burrat e ndryshëm, duke lehtësuar zbatimin.</li> <li>Mblidhni të dhëna të ndara sipas gjinisë dhe treguesve të tjerë socio-demografikë lidhur me ankesat, mbikëqyrjen e tregut, produktet dhe shërbimet për të kuptuar më mirë pabarazitë e mundshme gjinore në treg. Siguroni ndarjen e të dhënave në kohë reale me ASK-në për publikim përmes sistemeve të ndërveprueshme.</li> </ul>

Koncepti/dokumenti/akti ligjor	Qëllimi i politikës	Relevanca për barazi gjinore	Analiza gjinore: Situata e grupeve të prekura	Analiza gjinore: Si duhet të avancohet barazia gjinore	Si do të ndikojë në barazinë gjinore	Rekomandimet për eliminimin e ndikimeve negative dhe përmirësimin e atyre pozitive
	konsumatorit dhe për të harmonizuar rregulloret e tregut digjital të Kosovës me standardet e BE-së.	informata për gratë dhe burrat e ndryshëm të prekur mund të jetë relevante për zbatimin.	informata rreth reformave, gjë që mund të ndikojë në zbatim.		identifikuar.	

## Shtojca 5. Treguesit e propozuar

Kjo shtojcë paraqet një grup të strukturuar të treguesve potencialë që mund të merren në konsideratë gjatë zhvillimit të ZBA-së së re. Treguesit synojnë të shërbejnë si një kornizë referuese nga e cila mund të përzgjidhen treguesit relevantë, varësisht nga objektivat dhe prioritetet e përcaktuara në Program. Disa nga treguesit e propozuar janë të harmonizuar me qasjet e BE-së për cilësinë e shërbimeve, qasjen dhe kënaqshmërinë e përdoruesve. Gjatë hartimit të Programit të ardhshëm, pasi të jenë përcaktuar objektivat e përgjegjshme gjinore bazuar në analizë gjinore, indikatorët relevantë mund të përzgjidhen nga kjo listë për të matur progresin dhe ndryshimet me kalimin e kohës. Veçanërisht, disa tregues nuk matin vetëm barazinë gjinore, por matin reforma më të gjera të ZBA-së duke ofruar mundësinë për të analizuar dallimet bazuar në gjini dhe kategori të tjera demografike. Një analizë e tillë mund të zbulojë trende të cilat më pas mund të hulumtohen dhe adresohen në veprime të ardhshme.

Fusha e ndikimit	Treguesi	Justifikimi: Si do të kontribuojë në barazinë gjinore	Si të matet	Kur	Nga kush
<b>Ndikimi në kohë</b>	Koha mesatare e kursyer në përfundimin e shërbimeve me prioritet krahasuar me procesin para-digjital (duke përfshirë shmangien e udhëtimeve), e ndarë sipas gjinisë dhe moshës, përkatësisë etnike, vendbanimit rural/urban dhe aftësisë së kufizuar.	Gratë shpesh përballen me mungesë më të madhe të kohës për shkak të përgjegjësive të papaguara të kujdesit. Matja e kohës së kursyer tregon nëse digjitalizimi redukton barrën kohore administrative dhe u mundëson grave të kenë qasje më efektive në shërbime.	Anketa e përdoruesve të shërbimeve; anketa në nivel të Kosovës (përzgjedhja e rastësishme e mostrës)	Baza, çdo vit për anketën e përdoruesve; çdo katër vjet për anketën në nivel të Kosovës	ASHI & ASK
<b>Ndikimi në mobilitet</b>	Reduktimi i numrit të vizitave fizike të nevojshme për të përfunduar një shërbim, i ndarë sipas gjinisë dhe moshës, përkatësisë etnike, vendbanimit rural/urban dhe aftësisë së kufizuar.	Gratë, veçanërisht kujdestaret, gratë e moshuara dhe gratë në zonat rurale, mund të përballen me kufizime më të mëdha në lëvizshmëri. Ky tregues mat nëse shërbimet digjitale reduktojnë nevojën për udhëtim dhe i bëjnë shërbimet më të qasshme.	Anketa e përdoruesve të shërbimeve; anketa në nivel të Kosovës (përzgjedhja e rastësishme e mostrës)	Baza, çdo vit për anketën e përdoruesve; çdo katër vjet për anketën në nivel të Kosovës	ASHI & ASK
<b>Barra kujdesit</b>	Reduktimi i nevojës për të organizuar kujdesin për fëmijët ose për të përshtatur përgjegjësitë e kujdesit për të përfunduar procedurat, i ndarë sipas gjinisë.	Gratë mbajnë në mënyrë disproporcionale përgjegjësitë e kujdesit. Ky tregues mat nëse shërbimet digjitale reduktojnë ndërprerjet në detyrat e kujdesit gjatë qasjes në shërbimet publike.	Anketa në nivel të Kosovës (përzgjedhja e rastësishme e mostrës)	Baza; çdo katër vjet	ASK
<b>Autonomia</b>	Përqindja e përdoruesve që përfundojnë shërbimet në mënyrë të pavarur pa ndihmë, e ndarë sipas gjinisë dhe moshës, përkatësisë	Gratë mund të mbështeten më shpesh tek anëtarët e familjes ose ndërmjetësit për të përfunduar procedurat administrative. Ky tregues mat nëse digjitalizimi rrit aftësinë e	Anketa në nivel të Kosovës (përzgjedhja e rastësishme e	Baza; të dhëna administrative rregullisht; anketa	ASK; ASHI?; institucionet që ofrojnë

Fusha e ndikimit	Treguesi	Justifikimi: Si do të kontribuojë në barazinë gjinore	Si të matet	Kur	Nga kush
	etnike dhe aftësisë së kufizuar.	grave për të pasur qasje të pavarur në shërbime.	mostrës); të dhënat administrative?	çdo katër vjet	shërbi me?
<b>Barra hibride</b>	Reduktimi i përqindjes së rasteve që kërkojnë veprime pasuese fizike pas dorëzimit online, i ndarë sipas gjinisë dhe moshës, përkatësisë etnike dhe aftësisë së kufizuar.	Nëse procedurat online ende kërkojnë veprime pasuese fizike, kjo mund të ndikojë në mënyrë disproporcionale tek gratë me kufizime në lëvizshmëri ose përgjegjësi kujdestarie. Ky tregues mat nëse digjitalizimi në të vërtetë redukton barrën administrative.	Të dhëna administrative	Baza + çdo vit	Institucionet përgjegjëse për shërbimet
<b>Pjesëmarrja në punë</b>	Përqindja e përdoruesve që raportojnë nevojë të reduktuar për të marrë pushim nga puna për të përfunduar procedurat, e ndarë sipas gjinisë.	Procedurat administrative mund të ndërhyjnë në punën e paguar, veçanërisht për gratë që balancojnë punën dhe përgjegjësitë e kujdesit. Ky tregues mat nëse shërbimet digjitale reduktojnë ndërprerjet në punësim.	Anketa e përdoruesve; anketa në nivel të Kosovës	Baza + çdo vit; çdo katër vjet	ASHI; ASK
<b>Qasja në të drejta</b>	Koha nga kërkesa deri në marrjen e përfitimeve/aprovimeve e reduktuar për gra dhe burra, e ndarë sipas gjinisë dhe moshës, përkatësisë etnike dhe aftësisë së kufizuar.	Vonesat në qasjen në përfitime ose aprovime administrative mund të ndikojnë në mënyrë disproporcionale tek gratë, veçanërisht ato me të ardhura më të ulëta. Ky indikator mat nëse digjitalizimi përmirëson qasjen në kohë në të drejta dhe shërbime. Për shembull, përpunimi më i shpejtë i aplikimeve për asistencë sociale mund të lehtësojë hyrjen në tregun e punës pasi personat nuk kanë frikë nga pritjet afatgjata për t'u qasur në asistencë gjatë punësimit afatshkurtër ose sezonal, gjë që mund të ndikojë në mënyrë disproporcionale tek gratë si ndër më pak të punësuarat.	CCS		
<b>Pjesëmarrja ekonomike</b>	Përqindja e përdoruesve që raportojnë përmirësim në aftësinë për të përfunduar procedura ekonomike ose administrative pa vonesa, e ndarë sipas gjinisë dhe moshës, përkatësisë etnike dhe aftësisë së kufizuar.	Pengesat administrative mund të kufizojnë pjesëmarrjen ekonomike të grave. Ky tregues mat nëse digjitalizimi lehtëson pjesëmarrjen e grave në aktivitetet ekonomike.	Anketë e përdoruesve	Baza + çdo vit	ASHI
<b>Besimi digjital</b>	Përqindja e përdoruesve që raportojnë besim se dorëzimi online është i mjaftueshëm pa dokumente shtesë në letër ose vizita fizike, e	Besimi më i ulët në proceset digjitale mund të dekurajojë gratë e ndryshme nga përdorimi i shërbimeve online. Ky tregues mat nëse digjitalizimi ndërton besim dhe përdorshmëri në të gjitha gjinitë.	Anketë e përdoruesve	Baza + çdo vit	ASHI

Fusha e ndikimit	Treguesi	Justifikimi: Si do të kontribuojë në barazinë gjinore	Si të matet	Kur	Nga kush
	ndarë sipas gjinisë dhe moshës, përkatësisë etnike dhe aftësisë së kufizuar.				
<b>Kënaqësia e përdoruesve</b> <sup>62</sup>	Rezultati mesatar i kënaqshmërisë së përdoruesve pas përfundimit të shërbimit, i ndarë sipas gjinisë dhe moshës, përkatësisë etnike dhe aftësisë së kufizuar.	Kënaqshmëria pasqyron përdorshmërinë e përgjithshme, qasjen dhe drejtësinë e shërbimeve. Dallimet gjinore mund të zbulojnë pengesa që nuk kapen nga indikatorët e efikasitetit.	Anketa e përdoruesve pas shërbimit (e integruar në platformë)	Në vazhdimësi	ASHI
